


DITURIA ISLAME

REVISTË MUJORE FETARE, SHKENCORE E KULTURORE
NUMËR 368/369 • VITI 35 • KORRIK-GUSHT 2021 • DHUL HIXHXHE-MUHARREM 1442/1443 • ÇMIMI 1 €



Hytbeja e Myftiut të Kosovës, Naim ef. Tërnavë, e mbajtur në Xhaminë e Madhe
në Prishtinë me rastin e festës së Kurban-Bajramit

Urimi i Myftiut të Kosovës, Naim ef. Tërnavë, me rastin e festës së Kurban-Bajramit

Festa e Kurban-Bajramit në themelet e saj ka sakrificën, barazinë, solidaritetin dhe mirësinë

Të nderuar besimtarë!

Vëllezër e motra!

Të nderuar qytetarë të Kosovës!

Kam nderin dhe kënaqësinë, që sot, në këtë ditë të madhe për besimtarët myslimanë, në Ditën e Arafatit, kur prej festës së Kurban-Bajramit na ndajnë edhe pak orë, në emrin e Bashkësisë Islame të Kosovës, institucioneve të saja dhe në emrin tim, t'ju drejtohem me këtë mesazh urimi të gjithë besimtarëve myslimanë, me urimet dhe përgëzimet më të ngrohta e më të sinqerta, duke e lutur Zotin e Madhërishëm që ta përfjoshë Mëshirën e Ditës së Arafatit, dhe kënaqësinë e festës së Kurban-Bajramit.

Vëllezër të nderuar,

Festat e Bajramit si për nga karakteri ashtu edhe për nga ndikimi, janë festat më popullore të besimtarët myslimanë, ngase në këto festa besimtarët si në asnjë rast tjetër, përfjoshin shpirtërisht e emocionalisht afërsinë me Krijuesin, ngrohtësinë e familjes e farefisit, respektin e mirëkuptimit për tjetrin, ndihmën dhe përkrahjen për vëllain, e për atë që ka nevojë.

Festat fetare të popullit ynë, në vazhdimësi kanë kultivuar begatitë shpirtërore para atyre materiale, urtësinë para euforisë, drejtësinë para zullumit, paqen para konfliktit e dhunës, dhe solidaritetin e bamirësinë para koprracisë.

Kjo qëndron edhe te festa e Kurban-Bajramit, ngase në themelet e saj ka sakrificën, barazinë, solidaritetin dhe mirësinë, vlera këto që si askush tjetër, kjo festë i sjell për besimtarët dhe për njerëzimin.

Festa e Kurban-Bajramit është një ndër momentet më të rëndësishme të vitit për besimtarët myslimanë, të cilën e karakterizon therja e kurbanit që është ibadet i rëndësishëm për besimtarët, si dhe kryerja e haxhit si kusht i Islamit.

Zoti xh.sh. në Kuran thotë: *"Andaj, ti falu për hir të Zotit tënd dhe ther kurban."*

Përmes therjes së kurbanit, besimtarët myslimanë vazhdojnë traditën e pejgamberit Ibrahim a.s., derisa haxhi reflekton bazat e drejtësisë, si në tavaf, në Arafat, në Muzdelife, në namaz në Qabe, në veshje e në lutje, ngase të gjithë janë të barabartë. Këtu nuk ka dallim ndërmjet të pasurit e të varfrit, në moshë a gjini, dallim në etni a gjuhë, por të gjithë janë në një mision të përbashkët për të fituar mirësitë e Krijuesit Fuqiplotë përmes lutjeve, ibadeteve e pendimit të sinqertë.

Fatkeqësisht, edhe këtë vit, besimtarëve tanë për shkak të gjendjes pandemike nuk u është mundur që të udhëtojnë drejt vendeve të bekuara të Mekës e Medinës,

mirëpo shpirtërisht e ndiejmë aromën e atyre vendeve dhe mbetemi me shpresë që vitin tjetër të jemi atje për t'ju lutur Krijuesit të gjithësisë.

Vëllezër të nderuar,

Nimet i rëndësishëm i kësaj feste është edhe sofa e Bajramit e cila na bashkon me më të dashurit tanë, na bën të reflektojmë për familjen e të afërmit tonë, dhe na ndërgjegjëson për ata që kanë nevojë për kujdesin e përkrahjen tonë.

T'i shijojmë nimetet e sofrës së Bajramit me dashuri e respekt, pranë familjeve tona, pranë farefisit tonë, sepse s'ka gjë më të rëndësishme në këtë dynja sesa ruajtja e familjes dhe edukimi i drejtë i saj. E kemi për obligim fetar, por edhe traditë kombëtare që ta ruajmë familjen, ta kultivojmë, kujdesemi, ta mbrojmë e të sakrifikojmë për të.

Në këtë ditë të madhe kujtojmë sakrificën e nënave dhe baballarëve tanë që kanë bërë për ruajtjen e familjes së shëndoshë. Çdo pretendim për të cenuar familjen është në kundërshtim me natyrën e njeriut, në kundërshtim me mësimet hyjnore dhe traditën pozitive të popullit tonë. Familja është e shenjtë dhe duhet ta ruajmë atë.

Edhe më madhështore festën e Kurban-Bajramit të sivjetmë e bën lirimi i masave anti-covid, e në veçanti prania e mërgatës sonë që e begaton festën dhe e forcon institucionin e familjes.

Vëllezër të nderuar,

Më lejoni që në prag të festës së Kurban-Bajramit, në Ditën e Arafatit, të shpreh dhembshurinë time të thellë për viktimat që humbën jetën nga përmytjet në shtetet mike: Gjermani, Belgjikë, Austri e Turqi, si dhe solidaritetin tonë me familjarët e tyre, duke lutur Zotin e Madhërishëm që sa më parë të stabilizohet gjendja e krijuar.

Ju ftoj të gjithëve që ta festojmë Bajramin, të shijojmë nimetet e kësaj feste, por njëkohësisht të kemi kujdes që të respektojmë masat anti-covid, sepse virusi është ende në mesin tonë.

Në këtë ditë feste, edhe njëherë e lusim Zotin që t'i mëshirojë të gjithë ata që pësuan nga Covid, të prekurve t'u japë shërim të shpejtë me shpresë se Zoti se jemi në prag të kalimit të kësaj sfide globale.

Vëllezër e motra

Duke ju uruar për festën e madhe të Bajramit, lus Zotin për shëndet, mbarësi, begati, dashuri e harmoni në familjet tuaja.


Me hair e mbarësi festa e Kurban-Bajramit!

Prishtinë, 19 korrik 2021

Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë

Në këtë numër:

Urimi i Myftiut me rastin e Kurban-Bajramit	2
Editorial	4
Hydbeja e Myftiut me rastin e Kurban-Bajramit	5
Ligjërata e Kurban-Bajramit	7
Duhet që të jemi bashkë, të jemi unik e të kemi unitet	10
Sabri Bajgora Komentimi i kaptinës El-Ahkaf – (4)	13
Resul Rexhepi Besimi dhe puna në dritën e fesë islame	17
Gary Miller Kurani i mrekullueshëm (2)	20
Shpjegimi shkencor i ngjarjes së Jusufit nga kaptina "Jusuf"	23
Dr. Sedat Islami Durimi si degë e besimit	24
Prof. ass. dr. Rexhep Suma Shkallët e ndikimit në misionin e daves	28
Haki Sahitaj Sfida për t'i kuptuar sfidat e myslimanëve	33
S'duhet të lejohet krijimi i bashkësive të tjera fetare me prefiks islam	37
LL.M. Argjent Xheladini Pengesat martesore (2)	39
Mr. Jasir Krasniqi Qasje kuranore mbi raportin prindër-fëmijë	42
Nexhmi Hoxha Madhështia e durimit në Kuranin fisnik (1)	44
Mr. Artan Musliu Roli ynë karshi thirrjes	47
Edehem Sherkawi Mospajtimet ndërmjet bashkëshortëve	49
Agron M. Rexhepi, MD, PhD Morfologjia e kokës (1)	50
Rekomandime nga Konferenca	53
Aktivitetet	56

**DITURIA ISLAME**REVISTË MUJORE FETARE, SHKENCORE
E KULTURORE

Boton:

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës,
Prishtinë.**Kryeredaktor:**

Dr. Ajni Sinani

Redaksia:Prof. Sabri Bajgora, mr. Ramadan Shkodra,
dr. Fahrush Rexhepi, dr. Orhan Bislimaj,
dr. Faruk Sinani, mr. Muzaqete Kosumi,
mr. Besir Neziri dhe mr. Driton Arifi.**Sekretar në redaksi:**

Dr. Rexhep Suma

Lektor & korrektor:

Bajram Zeqiri

Redaktor artistik & teknik:

Bashkim Mehani

Adresa:Dituria Islame, rr. "Bajram Kelmendi" nr. 84,
10000 Prishtinë.

Tel & Fax: +383 38 224 024

email: dituriaislame@hotmail.com

dituriaislame@yahoo.com

www.dituriaislame.com

Parapagimi:

Evropë 25 €

Amerikë 40 USA \$

Shtypi:

Shtypshkronja "Printing press", Prishtinë

Të drejtat e Pejgamberit a.s. mbi këtë ymet



“Çfarëdo që t’ju japë i Dërguari, merreni atë, e çfarëdo që t’ju ndalojë, hiqni dorë prej saj.”

(El-Hashër, 7)

Nga këto të drejta të Pejgamberit a.s. mbi këtë ymet është që ne ta besojmë Muhamedin a.s., sepse askush nuk mund të jetë mysliman nëse nuk e pranon dhe e beson atë pa mëdyshje: “Prandaj besoni Allahun, të Dërguarin e Tij dhe dritën (Kuranin) që ju kemi zbritur.” (Et-Tegabun, 8)

Besimi dhe bindja në pejgamberin e Muhamedit a.s. nënkupton pasimin e plotë të tij nga ana e myslimanëve. Kjo është veçanti e Pejgamberit a.s.. Kjo bindje kërkon ndjekjen duke iu bindur në atë që ai ka urdhëruar dhe duke iu shmangur asaj që ka ndaluar: “Çfarëdo që t’ju japë i Dërguari, merreni atë, e çfarëdo që t’ju ndalojë, hiqni dorë prej saj.” (El-Hashër, 7).

Allahu e ka lidhur bindjen ndaj të Dërguarit të Tij me bindjen ndaj Tij në shumë ajete kuranore. Ka kërkuar nga ne që ta marrim atë si shembull dhe model: “Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë që shpreson tek Allahu dhe Dita e Fundit dhe e përmend shumë Allahun.” (El-Ahzab, 21).

Vetë Pejgamberi a.s. ka thënë: “Përmbajuni sunetit tim dhe të halifëve të drejtë.” Pasimi i vërtetë i Pejgamberit arrihet vetëm përmes braktisjes së pasionit dhe të nepsit, dhe ndjekjes së praktikës së tij duke iu kthyer së vërtetës me sinqeritet dhe besim të mirëfilltë. Prej të drejtave të Pejgamberit a.s. është dashuria ndaj tij nga ana e myslimanëve. Pejgamberi a.s. në hadithin që e transmeton Buhariu, thotë: “Pasha Atë në duart e të Cilit është shpirti im, nuk ka besuar asnjëri nga ju derisa të mos jem unë për të më i dashur se babai, djali dhe të gjithë njerëzit.”

Sahabët e donin Pejgamberin a.s. më shumë se veten dhe familjet e tyre. Nuk i ngopnin sytë e tyre duke e shikuar atë. E mbronin me trupat dhe gjokset e tyre. Dashuria e tyre ndaj tij nuk ishte dashuri e thatë dhe e zhveshur, por ishte dashuri e shoqëruar me besnikëri dhe bindje, dashuri e pastër qiellore, që kishte për qëllim zbatimin e urdhrave të Zotit dhe të Dërguarit të Tij.

Prej të drejtave të Pejgamberit është respekti dhe mos ngritja e zërit. Allahu i Plotfuqishëm ka thënë: “O ju që keni besuar! Mos e ngrini zërin tuaj mbi zërin e Pejgamberit dhe mos i flisni atij me zë të lartë, siç bëni me njëri-tjetrin, në mënyrë që të mos ju humbin veprat tuaja pa e kuptuar fare.” (El-Huxhurat, 2).

Ky ajet ndalon ngritjen e zërit lart ndaj tij, dhe ndalon që ta thërrasim atë vetëm me emër. Allahu i Plotfuqishëm ka thënë: “Mos ia drejtoni thirrjen të Dërguarit, njësoj si thirrjen që ia bëni njëri-tjetrit...” (En-Nur, 63).

Pra, mos thuaj ‘O Muhamed’, por thuaj: ‘O i Dërguari i Allahut’, ‘O Pejgamberi i Allahut’. Në qoftë se vetëm ngritja e zërit i humb veprat e mira, atëherë si qëndron puna me mospërfilljen ndaj të Dërguarit apo të dhënit përparësi mendimeve tona ndaj fjalëve të tij?!

Prej të drejtave të Pejgamberit është mbrojtja e tij: “Prandaj, ata që do ta besojnë, përkrahin dhe nderojnë atë, duke ndjekur dritën që është zbritur me të, pikërisht ata janë të fituarit.” (El-Araf, 157). Allahu e ka kërçënuar me dënim të dhembshëm atë që nuk e ndihmon.

Ndihma e Pejgamberit gjatë jetës së tij dhe pas saj, duke përfshirë edhe mbrojtjen e fesë islame është obligim dhe detyrim. Kjo ndihmë nënkupton mbrojtjen e fesë islame dhe të sunetit të tij. Prej të drejtave të tij ndaj ymetit është edhe ruajtja e familjes së tij dhe e bashkëshorteve, të cilat Allahu i ka fisnikëruar dhe i ka pastruar: “Allahu ka si qëllim që nga ju, o familje e shtëpisë (së Pejgamberit) të largojë ndyrësinë e mëkateve dhe t’ju pastrojë deri në skaj...” (El-Ahzab, 33).

E kemi për obligim t’i dërgojmë salavate Pejgambetit a.s. dhe kur dëgjojmë ezanin t’i dërgojmë lutje.

O Allahu, na dhuro ndërmjetësimin e tij, na bëj ta shoqërojmë atë në Xhenet dhe na ndihmo t’i kryejmë obligimet tona ndaj Pejgamberit a.s.!

Dr. Ajni Sinani

Hytbeja e Myfiut të Kosovës, Naim ef. Tërnavë, e mbajtur në Xhaminë e Madhe në Prishtinë me rastin e festës së Kurban-Bajramit

E kemi për obligim fetar, por edhe traditë kombëtare që ta ruajmë familjen



Falënderimet dhe lavdërimet i takojnë Allahut të Gjithëmëshirshëm. Salavatet dhe selamet qofshin për Muhamedin a.s., familjen e tij fisnike, dhe për ata që ndoqën dhe vazhdojnë të ndjekin rrugën e tij të ndritshme.

Të nderuar besimtarë!

Vëllezër dhe motra!

Të nderuar qytetarë!

Falënderojmë Zotin e Madhëruar që, sot, bashkërisht po e falim namazin e Kurban-Bajramit, pas të cilit do të kremtojmë dhe festojmë me familjet tona, komunitetin dhe shoqërinë në përgjithësi.

Festa e Kurban-Bajramit është një ndër momentet më të rëndësishme për besimtarët myslimanë, sepse vjen pas përfundimit të haxhit në vendet e bekuara dhe therjes së kurbanit.

Haxhi është ndër kushtet themelore të fesë islame, i cili kryhet në kohë të caktuar, në vend të bekuar me kushte të veçanta, ku në mënyrën

**Ne duhet të kemi
babë e nënë
biologjike ashtu
siç na ka krijuar
Zoti, të kemi
gjysh e gjyshe,
axhë e dajë, halle e
teze, farefis e
miqësi, fqinjë e
shoqëri për të
krijuar familje e
shoqëri të
shëndoshë, në
përputhje me
misionin që na ka
caktuar Krijuesi i
Gjithësisë**

më të mirë manifestohet barazia, drejtësia, uniteti, pendimi e reflektimi për punë e vepra të mira. Qëndrimi në Arafat shënon një ndër momentet më të veçanta për besimtarët myslimanë, ngase në atë vend, kuptimi i lutjes dhe ibadetit ka vlerë dhe peshë të veçantë.

Tavafi së bashku me Arafatin, Muzdelife me sa'jin, përveç anës shpirtërore, në praktikë manifestojnë më së miri barazinë mes besimtarëve ngado qofshin ata, të çfarëdo moshe apo gjinie, të çfarëdo etnie apo statusi shoqërorë, që të gjithë të veshur me petka të bardha kërkojnë mëshirën e Krijuesit, qetësinë shpirtërore dhe dashurinë për peygamberët, sepse ata që kryejnë haxhin në mënyrën më të mirë kujtojnë Ibrahimin a.s. dhe kujtojnë devotshmërinë, sabrin dhe lutjet e tij, si dhe çojmë në vend urdhrin e të Madhit Zot xh.sh. i cili thotë: "...Vërtet namazi im, sakrifica ime, jeta dhe vdekja ime janë vetëm

për Allahun - Zotin e botëve.” (El-En’am, 162).

Në Arafat, të gjithë besimtarët me përkushtim e devocion kujtojnë porosinë që dha pikërisht në këtë vend pejgamberi ynë Muhamedi a.s. në hytben e lamtumirës.

Fatkeqësisht, edhe këtë vit, për shkak të gjendjes pandemike nuk na është mundur që të udhëtojmë drejt vendeve të bekuara të Mekës e Medinës, mirëpo shpirtërisht e ndiejmë aromën e atyre vendeve dhe mbetemi me shpresë që vitin tjetër të jemi atje për t’ju lutur Krijuesit të gjithësisë.

Therja e kurbanit nuk është thjesht derdhje gjaku, por mbi të gjitha është përkushtim, është bindje e sakrificë dhe dëshmi e devotshmërisë së besimtarit, sepse Allahu xh.sh. në Kuran thotë: “Nuk është as mishi e as gjaku i kurbaneve që arrin tek Allahu, por është përkushtimi dhe devotshmëria juaj që arrin tek Ai...” (El-Haxh, 37).

Pra, therja e kurbanit është obligim-vaxhib për të gjithë ata që kanë mundësi, në shenjë afrie dhe devotshmërie për Krijuesin, dhe për të rikujtuar Ibrahimin a.s., i cili ishte në gjendje të sakrifikojë edhe birin e tij - Ismailin për hir të Zotit xh.sh..

Të nderuar besimtarë!

Begati e rëndësishme e kësaj feste është edhe sofa e Bajramit, e cila na bashkon me më të dashurit tanë, na bën të reflektojmë për familjen e të afërmit tanë, dhe na ndërgjegjëson për ata që kanë nevojë për kujdesin dhe përkrahjen tonë.

T’i shijojmë mirësitë e sofrës së Bajramit me dashuri e respekt, pranë familjeve tona, pranë farefisit tonë, sepse s’ka gjë më të rëndësishme në këtë botë sesa ruajtja e familjes dhe edukimi i drejtë i saj.

E kemi për obligim fetar, por edhe traditë kombëtare që ta ruajmë familjen, ta kultivojmë, kujdesemi, ta mbrojmë e të sakrifikojmë për të.

Për ne familja është e shenjtë, prej së cilës varet edhe vazhdimësia e jetës dhe e llojit njerëzor mbi tokë.

Familje ose fole familjare është vetëm ajo e cila është ngritur nga

martesa e një burri dhe një gruaje, dhe kjo përbën një prej shtyllave më të rëndësishme të shoqërisë së shëndoshë islame dhe humane. Fortësia dhe qëndrueshmëria e saj është edhe fortësia dhe qëndrueshmëria e kombit dhe e shtetit.

Nismat dhe qëndrimet për ta goditur familjen, janë në kundërshtim të plotë me misionin e njeriut në këtë botë, janë kundër vullnetit të Krijuesit të gjithësisë dhe kundër natyrshmërisë së njeriut.

Ne duhet të kemi babë e nënë biologjike ashtu siç na ka krijuar Zoti, të kemi gjysh e gjyshe, axhë e dajë, halle e teze, farefis e miqësi, fqinjë e shoqëri për të krijuar familje e shoqëri të shëndoshë, në përputhje me misionin që na ka caktuar Krijuesi i Gjithësisë, i Cili e ka krijuar njeriun në formën më të mirë dhe me mision të qartë si mëkëmbës në Tokë.

Si shoqëri, kemi traditën shumë shekullore në kultivimin dhe ruajtjen e vlerave familjare që e kemi të trasuar

nga të parët tanë. Mbështetja në familje na ka bërë të mundur që të përballemi me stuhi nga më të ndryshmet por ja kemi dalë gjithherë faqebardhë.

Andaj, në këto kohë, nuk duhet tunduar pas nismave gjoja moderne për të dëmtuar familjen, aq më tepër kur gjatë historisë është dëshmuar se shoqëria jonë nuk është shoqëri diskriminuese. Por, kur bëhet fjalë për të ardhmen e brezave, për familjen dhe për natyrshmërinë e njeriut, nuk mund të heshtim e të tregohemi indiferent ndaj diçkaje që shkon kundër thelbit të jetës sonë dhe kundër vullnetit të Zotit.

Në këtë ditë të madhe kujtojmë sakrificën e nënave dhe baballarëve tanë që kanë bërë për ruajtjen e familjes së shëndoshë. Çdo pretendim për të cenuar familjen është në kundërshtim me natyrën e njeriut, në kundërshtim me mësimet hyjnore dhe traditën pozitive të popullit tonë. Familja është e shenjtë dhe si të tillë duhet ta ruajmë atë.

Zoti xh.sh. në Kuranin fisnik thotë: “O ju që keni besuar, ruajeni veten dhe familjen tuaj prej një zjarri, lëndë djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët ...”. (Et-Tahrim, 6)

Vëllezër dhe motra!

Ju ftoj të gjithëve që ta festojmë Bajramin, t’i shijojmë begatitë e kësaj feste, të përfitojmë nga porosinë e haxhit dhe kurbanit, të jemi pranë njëri-tjetrit në të mirë e në vështirësi, t’i kujtojmë ata që kanë kaluar në Ahiret, të kujdesemi për ta ruajtur shëndetin publik, sepse virusi Covid-19 është ende në mesin tonë.

Të nderuar besimtarë!

Më lejoni që nga ky vend, në këtë ditë të madhe të gjithëve kudo që jeni, që në emër të Bashkësisë Islame të Kosovës dhe institucioneve të saja t’ju uroj festën e Kurban-Bajramit, duke lutur Zotin e Madhërisëm që ta ruaj atdheun tonë, ta bashkojë kombin tonë dhe ta udhëzojë e ta edukojë rininë tonë.

Me fat ju qoftë Kurban Bajrami!

Prishtinë, 20 korrik 2021

Myfitiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë



*Ligjëratë nga dr. Valon Myrtaj, e mbajtur
në Xhaminë e Madhe në Prishtinë, me rastin e festës së Kurban-Bajramit*

Tri ëndërrat për katër liritë

Në Kuran, ka tri ëndrra të përmendura për tre profetë të veçantë:
Ibrahimi a.s. duke therur djalin e tij; Jusufi a.s. duke iu përlurur atij me respekt
prindërit dhe vëllezërit; Muhamedi a.s. duke parë veten duke kryer haxhin.

*Me emrin e Allahut,
Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!
Të dashur besimtarë të pranishëm!
Të nderuar bashkatdhetarë, brenda
dhe jashtë vendit!*

Kam nderin dhe kënaqësinë e
veçantë, që në këtë mëngjes
të bukur, nga ky vend i
bekuar dhe para kësaj mase të madhe
besimtarësh, t'ju drejtohem me këtë
fjalë rasti, me urimet më të sinqerta
që së bashku ta përjetojmë më
thellësisht kënaqësinë e festës së
Kurban-Bajramit.

Vëllezër e motra!

Siç e dini, festat te ne nuk janë
thjesht festa që kremtojnë vetëm një
mësim moral, por edhe momente të
rëndësishme reflektimi. Së këndejmi,
më lejoni që fillimisht të flasim për
trashëgiminë që mbartë në vete festa
e Kurban-Bajramit, e më pas nëpër-
mjet kësaj trashëgimie të reflektojmë
mbi të ardhmen.

Kur bëhet fjalë për trashëgiminë e
lidhur me festën e Kurban-Bajramit,
leximi i Kuranit për momentin më
sjell në mendje vetëm dy gjëra,
gëzimin dhe ëndrrat e tre profetëve.

Të fillojmë me gëzimin:

Sot jemi zgjuar në një ditë gëzimi
që simbolizon harenë pas të arri-
turave. Argëtimi, si në çdo kulturë,
edhe te ne zë një vend të posaçëm. I
Dërguari i Zotit, paqja dhe mëshira
e Zotit qofshin me të, duke i kujtuar
Ebu Bekrit vendin e argëtimit në
jetën e njeriut i pati thënë: “Çdo
shoqëri ka festën e vet dhe kjo është
festa jonë.”¹

Festat e Bajramit si për nga natyra,
ashtu edhe për nga ndikimi, janë
festat më popullore në mesin tonë.
Në to, besimtarët përjetojnë afërsinë
me Krijuesin, ngrohtësinë e familjes,
respektin për tjetrin dhe përkrahjen
për atë që ka nevojë. Prandaj, festat te
ne dallojnë, jo vetëm për shkak të
ambientit dhe natyrës festive, por

edhe për shkak të mësimave, këshi-
llave dhe mesazheve përmbajtësore
që përcjellin. Nëse simbolikisht, festa
e Fitër-Bajramit lidhet me shpalljen e
Kuranit, atëherë festa e Kurban-
Bajramit lidhet me përmbylljen e
kësaj shpallje. Si sot, mbi njëmij-
ekatërqind vjet më parë, Allahu i
Madhëruar i shpalli Pejgamberit
Muhamed, paqja dhe mëshira e
Zotit qofshin me të, në rrafshnaltën
e Arafatit citatin që konsiderohet të
jetë përmbyllës i shpalljes: “...Sot
përsosa për ju fenë tuaj, plotësova
ndaj jush dhuntinë Time, zgjodha
për ju Islamin fe...”²

Kështu që, gëzimi i përbashkët
në këto ditë, rrit ndjenjën e
përkatësisë dhe kontribuon në
mbrojtjen e identitetit. Prandaj,
edhe thuhet: “Më trego ç'të gëzon,
të tregojë kush je”. Në këtë kontekst
është shprehur edhe thënia
profetike: “Atë që e gëzon e mira që
bën dhe e mërzit e keqja kur e
vepron, ai është besimtar.”³





Në këtë rast, sigurisht se vlen të theksohet edhe fjala e Zotit: “Thuaj: Me dhuntinë e Allahut dhe mëshirën e Tij, le të gëzohen, kjo është më e mirë se ajo që grumbullojnë.” (Junus, 58)

Përderisa grumbullimi i pasurisë na gëzon, atëherë është e udhës që urtësia e Kuranit dhe e shembullit të Pejgamberit të na gëzojë edhe më fort.

Vëllezër e motra!

Më lejoni që në vazhdim, edhe pse të zgjuar, të ëndërrojmë më tre profetët ëndërrimtarë. Në Kuran, ka tri ëndrra të përmendura për tre profetë të veçantë:

- Ibrahim a.s. duke therur djalin e tij;
- Jusuf a.s. duke iu përlur atij me respekt prindërit dhe vëllezërit;
- Muhamedi a.s. duke parë veten duke kryer haxhin.

Interesante në këtë mes është se të tria këto ëndrra janë të ndër-lidhura. Njëra ëndërr është e pasardhësit të Ismailit a.s., Muhamedit a.s.. Ëndrra tjetër është e pasardhësit të Is'hakut a.s., Jusufit a.s., dhe një ëndërr është e Ibrahimit a.s. duke qenë babai i të dy peygamberëve dhe i dy popujve të tyre.

E, lidhur me Ibrahimin, ftesa e Kuranit në suren e Haxhit për besimtarët është: "O besimtarë! Bëni ruku, bëni sexhde, adhurojeni Zotin tuaj, dhe punoni vepra të mira për të

arritur shpëtimin. Dhe, përpikuni (luftoni) në rrugën e Allahut, ashtu si duhet përpjekur (luftuar). Ai, ju ka zgjedhë dhe nuk ju ka bërë juve në fe kurrfarë vështirësie – ashtu si (ka qenë) në fenë e babait tuaj, Ibrahimit. Ai (Perëndia), ju ka quajtur myslimanë – qysh më parë, por edhe në këtë (Kuran)."⁴

Ajo që është më e rëndësishmja të theksohet këtu, është se këta profetë erdhën shekuj pas njëri-tjetrit, megjithatë ëndrrat që kishin të gjithë, lidhen së bashku dhe kompletojnë njëra-tjetrën. Shtrohet pyetja, si?

Të fillojmë me ëndrrën përfundimtare të të gjitha këtyre ëndrrave, me ëndrrën kulmore, atë që pa Profeti Muhamed a.s. duke kryer haxhin. Profeti e sheh veten sikur kthehet i sigurt në Qabe me të gjithë shokët, duke qenë me kokë të rruara dhe flokë të shkurtuara siç e kërkon rituali i haxhit. Këtë e përshkruan ajeti 27 i sures El Fet'h ku thuhet: "Allahu sendërttoi ëndrrën e Pejgamberit të vet me të vërtetën: "Me siguri, ju do të hyni në Mesxhidil-Haram, nëse jep Allahu, (dhe këtë) të sigurt, kokë-rruar dhe flokë-shkurtuar, pa kurrfarë frike."

Të gjithë ju e dini se gjatë haxhit rruajtja e kokës ndodhë vetëm pasi që haxhitë të therin kurbanet. Sikurse e dini, gjithashtu, se therja e kafshës për kurban lidhet me ëndrrën e profetit Ibrahim a.s.. Kështu që, i tërë

haxhi, si institucion themelor i fesë, bazohet në trashëgiminë e këtij profeti. Ëndrra e Muhamedit a.s. në të vërtetë e përsosë dhe përfundon misionin dhe ëndrrën e Ibrahimit a.s. e cila realisht është përmbushur në plotni të një rituali për herë të parë në haxhin e lamtumirës.

Ka mbetur edhe një ëndërr pa e komentuar, është ëndrra e Jusufit a.s., që pa diellin, hënën dhe yjet që përlulen me respekt para tij. Interpretimi i kësaj ëndrre të veçantë ishte që, në fund të fundit, vëllezërit e Jusufit a.s. që e hodhën në pus sa ishte fëmijë, përfundimisht do të përlulen para Jusufit a.s. kur të bashkohen me të dekada më vonë. Kur vëllezërit u ribashkuan pas shumë viteve, Jusufi a.s. nuk u hakmor për atë që i bënë atij, përkundrazi, ai vetëm i siguroi ata se: "Asnjë e keqe nuk do t'ju vijë sot."⁵

Ishin saktësisht këto fjalë, ato që i tha shumë shekuj më vonë Profeti Muhamed a.s. kur e përmbushi lutjen e Ibrahimit a.s. dhe pastroi Qabënë nga putat pasi u rikthye fitimtar në Mekë. Adhuruesit e idhujve që pritshin jashtë Qabesë, farefisi i Profetit dhe gjaku i tij kurejsh, ndjeheshin të pambrojtur dhe pritshin që do të përballeshin me pasojat e krimeve të veta për persekutimin e myslimanëve. Megjithatë, Profeti a.s. nuk tha tjetër për bijtë e vendit, veçse fjalët e Jusufit që ai ua

tha vëllezërve të tij: “Asnjë e keqe nuk do t’ju vijë sot.”

Sa e çuditshme është e gjithë kjo! Dy ëndrrat e Ibrahimit dhe Jusufit a.s. kulmojnë përsosmërisht në ëndrrën që iu dha Profetit Muhamed a.s., e cila nënkuptonte përmbushjen e misionit të pejgamberëve.

Vëllezër e Motra!

Nga sa u tha, mjafton për të reflektuar për ardhmërinë tonë, për liritë themelore të njeriut që garantojnë të drejtat tona, të cilat i përkasin çdo njeriu që nga lindja, pasi që pa liri nuk mund të festojmë për gëzime, e as t’i realizojmë ëndrrat.

Liria, si një aftësi për të vepruar sipas asaj që përcakton vullneti i njeriut, është një dhuratë e Zotit. Njerëzimi ka nevojë ta shfrytëzojë plotësisht këtë dhuratë hyjnore pa dëmtuar dikë dhe pa u dëmtuar nga të tjerët.

Liria është një nevojë e çdo individi për të identifikuar individualitetin e vet, për të shprehur çfarë i thotë mendja dhe zemra e tij, për të përcjellë idetë dhe besimet e tij për të mirën e njerëzimit dhe për t’i shërbyer shoqërisë në një mënyrë të drejtë. Dhe si e tillë, liria është baza dhe themeli i besimit, mendimit dhe veprimit.

Në përgjithësi, të gjithë kanë të drejtë në katër liri:

Liria e fjalës; 2. liria e adhurimit; 3. liria nga skamja dhe 4. liria nga frika.

Meqenëse dy të parat janë të lehta

për t’u kuptuar, në lidhje me dy liritë e tjera mund të themi se:

Liria nga skamja kërkon vëmendje ndaj çështjeve të korrupsionit në nivelin zyrtar ose ndaj grupeve të caktuara, që i garantojnë vetes qasje në më shumë burime të vendit të tyre sesa të tjerët. Duke pasur parasysh mënyrën e funksionimit të botës, gjithmonë do të ketë njerëz që kanë më shumë dhe njerëz që kanë më pak, mirëpo ajo që duhet të kërkojmë të mos ndodhë është që mbi njerëzit të mos ushtrohet presion dhe të mos u mohohen nevojat themelore.

Liria nga frika do të thotë që askush nuk duhet të ketë frikë nga qeveria e tyre, forcat e tyre të armatosura ose policia, apo edhe nga fqinjët e tyre. Kjo do të thotë se ju mund të shkoni në shtëpia për të festuar pa pasur frikë nëse shtëpia juaj do të jetë akoma në ditën tjetër. Gjithashtu do të thotë që ju mund të planifikoni mjaft gjatë për të mbjellë korret e ardhshme.

Është shumë më rëndësi të lirohemi nga frika sidomos në këtë kohë pandemie të stërzgatur, sepse ata që jetojnë me frikë humbin mundësi të panumërta dhe nuk do të jenë në gjendje të rimarrin ato humbje. Prandaj, t’i mbështetemi Zotit, të kemi besim te profesionalizmi i institucioneve përkatëse, përndryshe frika e përhapur mund të paralizojë shpresën dhe t’i largojë brezat nga vendi.

Për fund, mund të themi se të lirë janë ata që drejtojnë sjelljen dhe punët e tyre sipas asaj që ua dikton ndërgjegjja. Sa për ata që ndjekin tekat e tyre dhe pasionet e pakontrolluara, ata qeverisen nga teket dhe pasionet, kështu që varësia ndaj tyre i humb kontrollin arsyes dhe në këtë gjendje njeriu humb mundësinë për të gjykuar i pavarur. Devotshmëria e çon njeriun drejt së mirës, prandaj edhe ky virtyt është qëllimi i të gjitha adhurimeve që i kushtohen dhe na ndërlidhin me Zotin.

T’i shijojmë pra nimetet e sofrës së Bajramit me dashuri e respekt, pranë më të dashurve tanë, sepse nuk ka gjë më të rëndësishme se dashuria ndërmjet atyre që duhen, që kujdesen dhe sakrifikojnë në rast nevojë për të mbrojtur lirinë e njëri-tjetrit për t’u shprehur, për të adhuruar, për të pasur dhe për të qenë të sigurt.

E përfundojmë këtë fjalim duke e falënderuar Zotin për gjithë të mirat që kemi para nesh, për njëri-tjetrin që e kemi përkrah nesh dhe për dashurinë që ka vënë midis nesh!

E pritshim dhe e festofshim për shumë mot të gëzuar!

Ju faleminderit!

1. Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi. 2. El-Maide, 3. 3. Transmeton Tirmidhiu. 4. El-Haxh, 77-78. 5. Jusuf, 92.



Fjala e Myftiu Naim ef. Tërnavë në manifestim e përrurimit të hfz. Etem Etemi në Shtëpinë e Kulturës në Preshevë, më 29 korrik 2021

Duhet që të jemi bashkë, të jemi unik e të kemi unitet

Të nderuar pari e Këshillit të BI-së në Preshevë, kryetar Ademi,

Të nderuar përfaqësues të subjekteve politike,

E nderuara familje Etemi,

I nderuari hafëz Etem që sot po përrurohet,

I nderuari muhafiz, hfz. Orhan Ademi,

Të dashur e të respektuar qytetarë të Preshevës me rrethinë,

Vëllezër dhe motra!

Kam nderin e veçantë që sot gjendem në mesin tuaj, me një sebeb të rëndësishëm së veçantë për besimtarët myslimanë - mësimi i Kuranit përmendsh apo bërja (kryerja) e hifzit, që është një dhunti nga Krijuesi i gjithësisë, andaj më lejoni që në emër të Bashkësisë Islame të Kosovës, në emër të institucioneve të saja dhe në emrin

tim personal t'ju përshëndes e të shpreh kënaqësinë time që sot jemi këtu bashkërisht për të përjetuar këto momente të veçanta për ne dhe jo vetëm.

E ritheksoj, urim të veçantë për hafëzin e ri Etem Etemi, i cili me vullnet e përkushtim ka arritur që ta mësojë Kuranin përmendsh e t'u bashkohet radhëve të hafëzëve përgjatë shekujve.

Vëllezër dhe motra,

Siç ua kanë shpjeguar edhe ulematë para meje, Kurani famëlartë është "Vula e Librave" të zbritur qiellorë, muxhizet (mrekullitë) e të cilit nuk kanë fund. Kjo u dëshmuar gjatë gjithë historisë së tij, dhe do të vazhdojë deri në kiamet, sepse që nga koha kur filloi të zbriste e deri më sot, ata që e lexuan dhe e mësuan përmendsh Kuranin, gjithmonë e

mbajtën të gjallë dritën e tij. Sado që e përsëritën, as e shteruan dhe as që e vjetruan, por përkundrazi e rinuan, e duke e rinuar atë, më shumë e rinuan dhe e freskuan veten e tyre. Kjo sepse leximi dhe mësimi i Kuranit është një dritë (nur) dhe mëshirë (rahmet) që s'ka të sosur dhe që shndrit gjithandej rruzullit, e edhe në trojet tona. Drita e Kuranit i përfshiu shqiptarët që kur ata e njohën atë, që nga kur filluan leximin dhe mësimin përmendsh të tij, traditë kjo që sa erdhi e u intensifikua dhe u praktikua ku më shumë e ku më pak, po gjithsesi në shtëpitë, mejtepet, medresetë tona, e ku jo. Me një fjalë, Kurani u bë pjesë e pandashme e jetës së shqiptarëve myslimanë.

Dhe jo rastësisht, Allahu xh.sh. e fillon edhe ajetin e parë të shpalljes së fundit me fjalën: "Ikre - Lexo", për të



vazhduar e bërë me dije njeriut se është Ai i Cili njeriut i fali mundësi e veçori të cilat e veçojnë nga krijesat e tjera, se Ai i mësoi atë që nuk diti, se Ai i mësoi përdorimin e lapsit. Allahu xh.sh. thotë: “Lexo me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi (çdo gjë). Krijoi njeriun prej një gjaku të ngjizur (në mitrën e nënës). Lexo! Se Zoti yt është më bujari!. Ai që e mësoi (njeriun) të shkruajë me penë”. (El-Alek, 1-4).

Siç e dini nga historia, tradita e hifzit të Kuranit daton që nga koha e Resulullahut, apo thënë edhe më qartë që kur filloi t’i zbriste vahji Pejgamberit Muhamed a.s., ku vetë Allahu xh.sh. i mësoi Muhamedit a.s. Kuranin dhe ia memorizoi atë në mendjen e tij, duke na e bërë me dije këtë përmes këtij ajeti kuranor: “Ti (Muhamed) mos e shqipto atë (Kuranin) me gjuhën tënde për ta nxënë atë me të shpejtë. Sepse Ne e kemi për detyrë tubimin dhe leximin e tij!” (El-kijameh, 16):

Kishte nga sahabët që mësonin përmendësh Kuranin ngase Muhamedi a.s. kishte kërkuar nga shokët e tij, madje jo vetëm ta mësonin Kuranin, por t’ua mësonin edhe të tjerëve.

Pejgamberi a.s. thotë: “Më i miri prej jush është ai që mëson Kuranin dhe ua mëson atë të tjerëve”

Që në të gjallë të Muhamedit a.s. ka pasur nga sahabët që kanë qenë hafëzë të Kuranit, i pari hafëz i Kuranit - i pakrahasueshëm në asnjë aspekt me të tjerët - ka qenë vetë Muhamedi a.s., i cili ka ditur përmendësh tërë Kuranin dhe për çdo Ramazan e ka përsëritur para Xhibrilit a.s., d.m.th. para melekut, që nga Allahu i pati sjellë të gjitha shpalljet, e edhe Kuranin.

Lirisht mund të thuhet se sot nuk ka vend në botë ku jetojnë myslimanë e të mos ketë hafëzë të Kuranit. Edhe në trojet tona, krahas përhapjes së Islamit, pati filluar të mësohej Kurani. Me kohë numri i hafëzëve edhe te ne është rritur. Sa më i madh

që ishte një vend dhe sa më shumë institucione fetare arsimore që kishte (mejtepe, medrese, etj.), aq më i madh ishte edhe numri i atyre që e mësonin Kuranin.

Gjatë historisë sonë, në institucionet tona edukative-arsimore duke nisur nga xhamitë, mejtepet, medresetë, në vazhdimësi i është kushtuar kujdes i veçantë mësimi të drejtë, të saktë dhe të bukur të leximit të Kuranit. Në këtë drejtim ulemaja jonë përveç që kanë përgatitur talebet që kanë lexuar mirë Kuranin, kanë nxjerrë edhe hafëzë.

Tradita e mësimi dhe leximit të drejtë e të saktë të Kuranit ka ekzistuar te ne në mënyrë të organizuar e institucionale dhe ajo ka vazhduar dhe vazhdon deri më sot dhe do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Këtë e garanton, përveç të tjerash, edhe respekti që lexuesve të mirë të Kuranit u ka dhënë shoqëria jonë, ata kanë një vend të merituar në shoqëri.

Vëllezër dhe motra,

Një ndër vatrat shqiptare që u shqua dhe vazhdon të shquhet për kontributin e dhënë nëpër breza në leximin dhe mësimin përmendsh të Kurani Kerimit, është Presheva me muhafizët dhe myderrizët e njohur të saj. Këtu, për shekuj me radhë është kultivuar mësimi përmendsh i Kuranit, përkatësisht hafëzllëkut, jo vetëm brenda Preshevës, por kontributi i tyre tejkalon kufijtë e qytetit dhe rrethinës së tij. Rrethi juaj përgjatë historisë është njohur për ulema, myderriz e muhafizë të njohur, këtë traditë e kanë kultivuar me shekuj në këto troje, pavarësisht furtunave me të cilat janë përballur.

Presheva ka qenë një ndër qendrat tona ku i është kushtuar rëndësi meritore mësimi të Kuranit, mësimi të fjalës së Allahut xh.sh. Të kthehemi pak mbrapa, ulemaja e Preshevës gjatë shekullit të shkruar megjithëqë qe përballuar me sistemin monist-ateist, kishte arritur që me sukses të kultivojë traditën e hifzit. Muhafizët

e luginës së Preshevës ishin shembulli më i mirë në këtë fushë. Traditën e mirë të mësimi të Kuranit përmendsh hafizllëkut, tani po e ndjek edhe kursi i Kuranit “El- Hidaje” me në krye hzf. Orhan ef. Ademi, të cilin duhet mbështetur në misionin e tij të shenjtë. Mbështetja më e mirë për të është dërgimi i fëmijëve te muhafizi që të mësojnë Kuranin, të vazhdohet tradita që ka nisur që nga Pejgamberi a.s., të vazhdohet tradita e të parëve tanë, pra të vazhdohet me edukim e arsimim fetarë.

Ne si Bashkësi Islame, e edhe Këshilli vendor këtu në Preshevë, do të bëjmë më të mirën që shkolla e Kuranit të funksionojë pa pengesa dhe do të përpiqemi që të sigurojmë kushtet e mbështetjen e duhur.

Në këtë manifestim të sotëm me respekt kujtojmë të gjithë ata muhafizë që kontribuuan ndër vite në mësimin e Kuranit përmendsh-hafizllëkut. Po ashtu kujtojmë me respekt e pietet të gjithë ata myderriz që nxorën kuadër të përgatitur mirë, imamë ixhazetli që bartën mbi vete me shumë sakrifica - por me sukses të plotë mision e respektuar të imamit e prijësit fetarë në kohë e ditë të vështira. Tek ulemaja e Luginës së Preshevës kanë marrë mësim jo vetëm nxënësit e kësaj ane, por edhe të rrethëve, e para së gjitha nga rrethi i Kamenicës dhe Gjilanit.

Është detyrë e jona që kontributin e ulemasë së kësaj ane ta nxjerrim në dritë, e ulematë e kësaj ane kanë dhënë kontribut të çmuar në shumë fusha, si në atë fetare, po edhe në ruajtjen e etnisë, gjuhës, e mbi të gjitha kontribut të çmuar kanë dhënë në ruajtjen e pranisë së popullatës sonë në këto anë, andaj këtu kujtojmë kontributin e hzf. Nexhatisë, hzf. Zihnisë, myderriz Hysenit, hzf. Rizahit, Mullah Fejzës, mulla Fehmiut e shumë të tjerë, më falni nëse nuk i përmendi të gjithë.

Të nderuar vëllezër dhe motra,

Sot, kam ardhur te ju me kënaqësinë më të madhe, sepse patëm



hafëzin e ri, këtij Zoti i dhëntë shëndet e mbarësi, e inshalla presim e përurojmë këtu e gjetiu edhe shumë hafëzë të rinj.

Gjatë qëndrimit tonë sot këtu, pata rastin të takoj edhe udhëheqësit tuaj politikë e fetarë, nga të cilët jam informuar për sfidat, problemet, projektet e sukseset që keni. Të gjithë i falënderoj për punën e angazhimit që bëjnë për të mirën e qytetarëve të kësaj ane, çdo sfidë e juaja është sfidë edhe për ne, çdo problem i juaj është problem edhe për ne, çdo të arritje tuaj i gëzohemi dhe e përkrahim edhe ne.

E dimë mirë pozitën dhe gjendjen tuaj, nga ne kërkohet që të angazhohemi maksimalisht që të bëjmë më të mirën për popullin tonë, për njerëzit tanë. Kjo trevë merr peshën e vet, merr rëndësinë e vet vetëm nëse ne arrijmë që të jemi këtu, ta zhvillojmë këtë trevë, ta bëjmë vend ku mund të jetohet e punohet me dinjitet.

Për të pasur sukses, duhet që të jemi bashkë, të jemi unik e të kemi unitet. Jemi angazhuar gjatë që të kemi sistem plural, shqyrr Zotit sot e kemi, mirëpo mendimi ndryshe nuk guxon të na çojë në armiqësi ndër ne, në barikadime kundër njëri-tjetrit, mendimi ndryshe është pasuri, mirëpo ne na duhet unitet veprues

në të mirë të popullit tonë.

Përsëritës unitetin që ka treguar spektri politik i Luginës gjatë zgjedhjeve që keni pasur për parlamentin republikan, kërkoj që të forcohet ky unitet në të mirë të popullit, gjithsesi duke e ruajtur subjektivitetin dhe filozofinë e vet çdo subjekt. Kërkoj një unitet të tillë edhe në nivel lokal, në tri komunat, Preshevë, Bujanoc e Medvegje, jemi pak të jemi të përçarë, jemi pak të jemi njëri-kundër tjetrit e të mbajmë inat e mëri.

Vëllezër e motra,

Organizimi i Bashkësisë Islame në këto troje është shekullor, me kontribut të njohur gjatë historisë. Jemi përballur me sfida të ndryshme, por gjithherë kemi ditë të orientohemi drejt e t'i ruajmë institucionet e organizimin e jetës fetare islame.

Mirëpo, për shkak të rrethanave që i dini të gjithë, këshillat e BI në Luginë, pas Luftës së Kosovës janë gjendur në një situatë të vështirë.

Këtë gjendje e ka krijuar shteti serb duke manovruar me masa administrative. Si rezultat i kësaj gjendje, tani e sa kohë në Luginë funksionojnë dy apo tri organizime të jetës fetare islame gjë që ka dëmtuar organizimin tradicional të BI, ka sjellë huti te besimtarët, ka hapur debat të pa nevojë dhe ka krijuar tabore. Pa

dashur që të gjej fajtorin, ne si BIK jemi angazhuar në vazhdimësi që ulemaja e tanishme e Luginës të jenë të bashkuar, të jenë unik dhe të jenë në krye të misionit të tyre.

Me gjithë angazhimin tonë nuk kemi arritur që të kemi rezultate të dëshiruara, por me shpesë se në një të ardhme të afërt të kemi unitet të plotë ndërmjet prijësve fetar të Luginës. Bashkësia Islame e Kosovës mbështet me çdo kusht unitetin e subjektivitetin e qartë të prijësve fetarë të Luginës. Kërkojmë unitet, mbështesim unitetin, na duhet uniteti, në të mirë e në të keq do të jemi bashkë. Ne kemi një platformë për daljen nga kjo situatë. Bashkësia Islame e Kosovës është e përkushtuar që të jetë pranë popullit të Luginës, me popullin e Luginës, ne jemi një, na kanë ndarë pa vullnetin tonë administrativisht, por shpirtërisht jemi e duhet e do të jemi bashkë. Pres kontributin e të gjithëve dhe pres reflektimin e të gjithëve, Ne gjithmonë do të jemi pranë jush e me ju.

Duke ju falënderuar, ju uroj e përgëzoj edhe njëherë.

Ves selamu alejkum ve rahmetullah.

Preshevë, 29 korrik 2021

Myftiu i Kosovës

Naim ef. Tërnavë

Sabri Bajgora

Komentimi i kaptinës El-Ahkaf – (4)

Shpifjet e jobesimtarëve dhe shpërblimi për besimtarët

وَقَالَ الَّذِينَ كَفَرُوا لِلَّذِينَ آمَنُوا لَوْ كَانَ خَيْرًا مَّا سَبَقُونَا إِلَيْهِ وَإِذْ لَمْ يَهْتَدُوا بِهِ فَسَيَقُولُونَ هَذَا إِنْكَادِيمٌ ﴿١١﴾ وَمِنْ قَبْلِهِ كِتَابُ مُوسَى إِمَامًا وَرَحْمَةً وَهَذَا كِتَابٌ مُصَدِّقٌ لِّسَانًا عَرَبِيًّا لِّيُنذِرَ الَّذِينَ ظَلَمُوا وَبُشْرَى لِّلْمُحْسِنِينَ ﴿١٢﴾ إِنَّ الَّذِينَ قَالُوا رَبُّنَا اللَّهُ ثُمَّ اسْتَقَامُوا فَلَا خَوْفٌ عَلَيْهِمْ وَلَا هُمْ يَحْزَنُونَ ﴿١٣﴾ أُولَئِكَ أَصْحَابُ الْجَنَّةِ خَالِدِينَ فِيهَا جَزَاءً بِمَا كَانُوا يَعْمَلُونَ ﴿١٤﴾

“Jobesimtarët thonë për besimtarët: “Nëse (Feja-Kurani) do të ishte ndonjë gjë e mirë, ata nuk do të na kishin paraprirë në të!” E pënderisa ata nuk e pranojnë udhëzimin e tij, do të thonë: “Ky është një trillim i lashtë”. Edhe para tij (Kuranit) ishte Libri i Musait, një udhërrëfyes dhe mëshirë, e edhe ky (Kurani) është Libër që vërteton (Tevratin), është në gjuhën arabe për t’ia tërhequr vërejtjen atyre që bëjnë të këqija dhe për t’i përgëzuar vepërmirët. Pa dyshim, ata që thonë: “Zoti ynë është Allahu!” dhe pastaj qëndrojnë vendosmërisht në rrugën e drejtë, për ta nuk ka frikë dhe nuk do të pikëllohen (kur t’u vjen vdekja). Të tillët janë banorë të Xhenetit, aty do të jenë përgjithmonë, si shpërblim për atë që kanë punuar.” - (El-Ahkaf, 11-14)

Shkaku i zbritjes së ajetit 11

Transmeton Taberaniu nga Katadeja të ketë thënë: Kanë thënë disa nga idhujtarët: “Ne jemi më të vlefshmit, Ne..., Ne..., dhe po të ishte diçka e mirë (shpallja që i besuan) nuk do të na kishin paraprirë në këtë filani e filani.” Për këtë arsye zbriti ajeti i 11.¹

- Ibn Mundhiri transmeton nga Avn bin Ebi Sheddad të ketë thënë: Omeri ibnul Hattabi kishte një robëreshë e cila e kishte përqafuar Islamin, para tij. Emri i saj ishte Zinnin ose Zinnire, ndërsa Omeri r.a. e rrihte atë deri sa edhe vetë dërmohej. Jobesimtarët nga kurejshët thoshin me ironi: Po të ishte diçka e mirë (shpallja që i besuan) nuk do të na kishte paraprirë Zinninja.²

Të njëjtin transmetim nga Ibn Sa’di e përcjellin edhe Dahhaku dhe Haseni.³

- Ibn Abasi, Kelbiu dhe Zuxhaxhi thonë se: “Ata që mohuan janë fiset: Benu Amir, Gatafan, Temim, Esed, Handhale dhe Eshxh’aë, kurse për

ata që kishin pranuar Islamin nga fiset: Gafar, Eslem, Xhuhejne, Muzejne dhe Huza’ah, thoshin: “Po të ishte e mirë ajo me të cilën ka ardhur Muhamedi, nuk do të na kishin paraprirë në të çobanët e kafshëve, sepse ne jemi më të vlefshëm se ata”.⁴

- Ndërkohë, shumica e mufessirëve thonë se jobesimtarët nga radhët e hebrenjve u thoshin atyre që i besuan shpalljes së Muhamedit a.s., si Abdullah ibn Selamit e të tjerët, se po të ishte feja e Muhamedit e vërtetë, nuk do të na paraprinin këta në të.⁵

Allahu xh.sh. në këto ajete, ua bën me dije qoftë idhujtarëve, qoftë hebrenjve se për vërtetësinë e kësaj shpalljeje, dëshmon edhe vetë Tevrati, të cilin e lexojnë hebrenjtë

Lidhja e këtyre ajeteve me ato paraprake

Këto ajete ndërlidhen kuptimisht me ajetet paraprake, duke treguar se dyshimet, talljet, përbuzjet dhe ironitë e jobesimtarëve, karshi Shpalljes hyjnore dhe myslimanëve nuk kishin të ndalur. Ata haptazi po i nënçmonin të dobëtit, robërit dhe të varfrit, të cilët i kishin besuar Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Prandaj, aristokracia kurejshite, kur i shikonin të varfrit si Amar bin Jasirin, Suhejbin dhe Ibn Mesudin, me ironi e përbuzje thoshin se po të ishte kjo feja e Muhamedit e mirë, nuk do të na paraprinin këta varfanjakë në të. Ndërkohë edhe hebrenjtë kur kishin parë Abdullah Ibn Selamin tek kishte përqafuar Islamin, e ai më parë ishte njëri prej prijësve të tyre fetarë, dhe meqë nuk po mund ta kapërdinin dot këtë veprim, thoshin, po të ishte feja e Muhamedit e mirë, nuk do të na paraprinin në këtë, lloji i Ibn Selamit.⁶ Por Allahu xh.sh. në këto ajete, ua bën

me dije qoftë idhujtarëve, qoftë hebrenjve se për vërtetësinë e kësaj shpalljeje, dëshmon edhe vetë Tevrat, të cilin e lexojnë hebrenjtë, andaj vetëm ata që i besojnë Allahut dhe i qëndrojnë besnikë të kësaj rruge të drejtë, do të jenë banorë të Xhenetit, përgjithmonë.

Koment:

11. *Jobesimtarët thonë për besimtarët: “Nëse (Feja-Kurani) do të ishte ndonjë gjë e mirë, ata nuk do të na kishin paraprirë në të!” E përderisa ata nuk e pranojnë udhëzimin e tij, do të thonë: “Ky është një trillim i lashtë”.*

Ky ajet është vazhdimësi e atyre ajeteve paraprake, të cilat flisnin për dyshimet, talljet dhe shpifjet e idhujtarëve, ndaj shpalljes. I Madhërishmi e ka përdorur termin “jobesimtarë”, e jo idhujtarë, sepse ky term është më gjithëpërfshirës dhe ka të bëjë me të gjithë mohuesit, e ndër ta edhe çifutët. Dihet se kur idhujtarët mekas dëshironin ta vënin në siklet Pejgamberin a.s. me ndonjë pyetje provokatore, gjithmonë konsultoheshin me çifutët. Çifutët e Gadishullit Arabik, nuk e pasuan këtë pejgamber të fundit, të cilin e gjenin të përshkruar edhe në Tevratin e tyre, të shtyrë nga mendjemadhësia dhe egoizmi, e në këtë mendjemadhësi ata i ndoqën edhe idhujtarët mekas. Këta të fundit, duke parë se fenë e Muhamedit a.s. e kishin përqaftuar kryesisht të varfrit dhe robërit, thoshin me përçmim e përbuzje: “po të ishte kjo fe e mirë, kurrë nuk do të na kishin paraprirë në të njerëzit më të përbuzur nga ne”. Kjo shprehje e tyre, shpreh arrogancën dhe vrazhdësinë që mbanin zemrat e tyre të prishura, sepse ata nuk kishin mëshirë ndaj të varfërve e as ndaj robërve. Kjo kategori njerëzish, për ta simbolizonte vetëm frymorë që ecin mbi tokë dhe për të qenë në shërbim të tyre. Por, a thua kush janë këta paraprijës (sabikun)? Këta, pa dyshim, janë njerëzit më të mëdhenj të këtij ymeti, të cilët ndër të parët

Edhe brezi i idhujtarëve të cilët ishin dëshmitarë të zbritjes së Kuranit, siç ishin Ebu Xhehli dhe shumë të tjerë, e dinin mirë se Muhamedi a.s., ishte i dërguar nga Allahu, por nga inati dhe xhelozia nuk i besonin.

hapën gjokset e tyre për fenë e Allahut. Të tillët i ka përmendur Allahu në Kuranin famëlartë: “Dhe ata që kanë paraprirë (në besim) e që do të paraprijnë (edhe në Xhenet). Ata janë të afërtit (tek Allahu), në kopshtet e kënaqësisë. Shumica e tyre janë prej të parëve, ndërsa një pakicë prej të mëvonshmëve.” - (El-Vakiu, 10-14).

Nën këtë emërtim hyjnë edhe të gjithë sahabët, ensarët dhe muhaxhirët, të cilët të parët u rreshtuan në rrugën e dritës, për hir të lartësimit të Fjalës së Allahut, ashtu siç i përshkruan edhe Kurani famëlartë: “Kurse ata që

erdhën pas tyre (gjeneratat pas ensarëve dhe muhaxhirëve) thonë: Zoti ynë! Falna neve dhe vëllezërit tanë, të cilët kanë besuar para nesh dhe mos lejo që në zemrat tona të ketë urrejtje ndaj atyre që besuan. Zoti ynë! Ti je vërtet i Butë dhe Mëshirëplotë!” - (El-Hashr, 10).

Fundi i këtij ajeti: “E përderisa ata nuk e pranojnë udhëzimin e tij, do të thonë: “Ky është një trillim i lashtë”, konfirmon edhe njëherë se, përderisa idhujtarët dhe jobesimtarët në përgjithësi, nuk e pranojnë këtë udhëzim hyjnor, nga mendjemadhësia, ndonëse e dinin se ky udhëzim ishte prej Allahut, ata do të vazhdojnë të shpifin e të thonë se ky Kuran është trillim i lashtë dhe i kahershëm, të shtyrë nga arroganca dhe sëmundja që kishin në zemra. Pra nga tërë kjo kuptohet se ekziston një hendek i madh në mes diturisë dhe udhëzimit, sikur që ekziston dallimi në mes njohjes së të vërtetës dhe besimit në të vërtetën.⁷ Edhe brezi i idhujtarëve të cilët ishin dëshmitarë të zbritjes së Kuranit, siç ishin Ebu Xhehli dhe shumë të tjerë, e dinin mirë se Muhamedi a.s., ishte i dërguar nga Allahu, por nga inati dhe xhelozia nuk i besonin. Të tillë ishin edhe shumica e çifutëve në Gadishullin Arabik. Ata nuk i besonin nga inati, pse i dërguari i



fundit nuk ishte nga radhët e tyre. Prandaj, duke qenë të pafuqishëm të demantonin fjalën e Allahut, thoshin se kjo është gënjeshtër, shpifje dhe trillim i të moçmëve.

12. Edhe para tij (Kuranit) ishte Libri i Musait, një udhërrëfyes dhe mëshirë, e edhe ky (Kurani) është Libër që vërteton (Tevratin), është në gjuhën arabe për t'ia tërhequr vërejtjen atyre që bëjnë të këqija dhe për t'i përgëzuar vepërmirët.

Ky ajet kuranor i kundërshton fuqishëm fjalët e idhujtarëve të thëna në ajetin paraprak: “Nëse (Kurani) do të ishte ndonjë gjë e mirë, ata nuk do të na kishin paraprirë në të!...” dhe: “Ky është një trillim i lashtë!” Arsyeja e përmendjes së Librit të Musait (Tevratit), të përshkruar si udhërrëfyes dhe mëshirë, është se Ai si libër vërtet ishte i tillë, para se të deformatohej e shtrembërohej nga duart e çifutëve. Këtë e vërteton katërçipërisht edhe Kurani famëlartë,⁸ madje në disa vende, sa për t'ua bërë me dije jo vetëm çifutëve, por edhe tërë popujve të botës, se si Tevratit ashtu edhe Kurani, janë prej të njëjtit burim drite, pra janë Fjalë e Allahut xh.sh.. Dallimi i vetëm është se Kurani famëlartë, është Shpallja e fundit drejtuar njerëzimit, dhe Allahu e garantoi mbrojtjen e tij nga duart e shtrembëruesve, gjë që nuk ndodhi me librat e tjerë para tij: “Ne të kemi zbritur ty (o Muhamed) Librin me të vërtetën, si vërtetues i Librave të mëparshëm dhe mbrojtës (garantues) të tyre.” – (El-Maide, 48).

Idhujtarët, kur u lexoheshin ajetet kuranore, ishin të vetëdijshëm se ato nuk ishin diçka tokësore, siç ishte poezia e tyre në të cilën shkencë tashmë pothuajse kishin arritur kulmin, por çuditëshin se si vallë mund t'i zbriste një njeriu nga mesi i tyre një Shpallje e tillë, kur dihet se atëbotë ata njihnin vetëm çifutët të kishin libra qiellorë. Por i Madhërrishmi iu tregon qartë, se ky Kuran ka ardhur pikërisht në gjuhën e pastër arabe, për t'ua tërhequr vërejtjen nga dënimi i Allahut, por njëkohësisht edhe për t'i përgëzuar

me Xhenet ata që e pasojnë fenë e Allahut.

13. Pa dyshim, ata që thonë: “Zoti ynë është Allahu!” dhe pastaj qëndrojnë vendosmërisht në rrugën e drejtë, për ta nuk ka frikë dhe nuk do të pikëllohen (kur t'u vjen vdekja).

14. Të tillët janë banorë të Xhenetit, aty do të jenë përgjithmonë, si shpërblim për atë që kanë punuar.”

Ajeti paraprak përfundoi me përgëzimin e vepërmirëve, duke u ndërlidhur fuqimisht tash me këto dy ajete pasuese, të cilat flasin për besimtarët e sinqertë, të cilët i besuan Allahut dhe nuk u zmbropsën për asnjë pëllëmbë nga parimet e tyre të pastra. Ata pasi u përdhën, në asnjë mënyrë dhe me asnjë çmim, nuk u larguan nga kjo dritë e udhëzimit, por dëshmuuan për vërtetësinë e shpalljes dhe i besuan peygamberisë së Muhamedit a.s., pa marrë parasysh konsekuencat që mund të kishin. Shumë prej tyre edhe u torturuan, e shumë edhe ranë dëshmor në mbrojtjen e besimit të tyre të pastër. Për këtë arsye, Allahu xh.sh. në nderim të tyre i përmend këta njerëz si besimtarë vepërmirë që thanë se Zoti ynë është Allahu, dhe pastaj qëndruan të palëkundur në rrugën e hakut. Për të tillët as nuk ka frikë nga trishtimi dhe llahtaria e Kiametit, e as nuk do të pikëllohen, sepse të tillët i ka përshkruar mëshira e Allahut fuqiplotë, e shpërblimi për ta është Xheneti.

Dijetari i madh, Sejid Kutbi, gjatë komentimit të këtij ajeti, sjell margaritarë fjalësh ku ndër të tjera thotë: “Fjala e të Lartmadhërrishmit: “Zoti ynë është Allahu!” - nuk është thjesht vetëm një fjalë goje që thuhet, por është besim i ngulitur në ndërgjegje dhe është program i përsosur i jetës, i cili përfshin çdo pore të jetës së njeriut, në çdo sferë...; “Zoti ynë është Allahu!” - nënkupton se vetëm Allahut i takon adhurimi, vetëm tek Ai duhet të drejtohem, Atij duhet t'ia kemi dronë dhe vetëm tek Ai duhet të mbështetemi;

“Zoti ynë është Allahu!” - nënkupton se vetëm para Tij është llogaria...;

“Zoti ynë është Allahu!” – nënkupton se çdo aktivitet, çdo mendim dhe çdo vlerësim i drejtohet vetëm Atij, në kërkim të kënaqësisë së Tij;

“Zoti ynë është Allahu!” - nënkupton se nuk ka gjykim tjetër pos gjykimit të Tij, as ligj përveç Sheriatit të Tij, e as udhëzim pos udhëzimit të Tij;


“Zoti ynë është Allahu!” - nënkupton se çdo gjë në këtë ekzistencë është e ndërlidhur me ne, e ne takohemi bashkërisht me të gjithë në lidhjen tonë me Zotin...”, e pastaj:

“qëndrojnë vendosmërisht në rrugën e drejtë” - nënkupton paluhatshmërinë e tyre në këtë rrugëtim hyjnor me shpirt të pastër e me zemër të qetë..., pa u ndikuar aspak nga shqetësimet dhe lëkundjet e ashpra në rrugën e jetës, rrugë e cila është plot pengesa e plot tatëpjeta...!”

Se ajetet kuranore kanë ndërlidhje dhe ndërthurje të mahnitshme ndërmjet vete, mund të bindemi edhe tash, duke sjell një ajet të ngjashëm me këtë, atë të 30 nga surja Fussilet, ku Allahu thotë: “Pa dyshim, atyre që thonë: “Zoti ynë është Allahu”, dhe pastaj qëndrojnë vendosmërisht në rrugën e drejtë, do t'u zbresin engjëjt (në prag të vdekjes e do t'u thonë): “Mos u frikësoni dhe mos u pikëlloni! Dhe gëzojuni Xhenetit që ju është premtuar!”

Në Kuran, janë vetëm këto dy ajete, që kanë ardhur në të njëjtën formë, së pari në suren Fussilet, dhe tash në El-Ahkaf, 13, por ajo që meriton t'i kushtohet vëmendje, është ndërlidhja tejet madhështore e këtyre dy ajeteve me ata paraprakë nëpër suret përkatëse që i përmeindëm. Përderisa në suren Fussilet, këtij ajeti i kanë paraprirë ajetet prej: 26, për të përfunduar me ajetin e 29: “Dhe jobesimtarët do të thonë: “O Zoti ynë, na i trego ata xhind dhe njerëz, që na kanë shpënë në humbje, që t'i shkelim me këmbët tona e t'i poshtërojmë!”. Pas këtyre ajeteve (26-29) në të cilët shohim kulminacionin e poshtërimit të jobesimtarëve në sketërrat e Xhehenemit, vjen ajeti që flet për besimtarët e

Të gjitha Shpalljet hyjnore kanë të njëjtin burim. Si Tevrati, Zeburi dhe Inxhili, ashtu edhe Kurani, janë libra të zbritur nga Allahu nëpër kohë të ndryshme.



vërtetë të cilët thonë se Zoti ynë është Allahu dhe pastaj përqendrohen vendosmërisht në rrugën e së vërtetës. Njësoj ka ndodhur edhe në suren El-Ahkaf, kur në ajetin 7 të saj thuhet: “për të vërtetën (Kuranin) që u erdhi, thanë: “Kjo është magji e qartë!”, ndërsa në ajetin e 11, për Kuranin thonë “Ky është një trillim i lashtë”, prandaj, pas tërheqjes së vërejtjes ndaj jobesimtarëve me ndëshkim në zjarr të Xhehenemit, tash natyrshëm vjen biseda për vepërmirët, të cilët thanë Zoti ynë është Allahu për të përfunduar me shpërblimin për të cilin flet ajeti i 14 i kësaj sureje. Të tillët janë banorë të Xhenetit, aty do të jenë përgjithmonë, si shpërblim për atë që kanë punuar”.

Kur jemi te ky ajet, dijetarët kanë pyetur, nëse shpërblimi me Xhenet është meritë e rob-it, apo vlerësim dhe dhunti e Allahut për të? Përgjigja është se kjo është veçse dhunti e Allahut për robin, sepse puna jonë e mirë në këtë dynja është vetëm shkak, e jo çmim i hyrjes sonë në Xhenet. Kur Allahu na përcaktoi ligjet dhe rregullat e fesë e të jetës, këtë e bëri për hir të mirëqenies sonë në këtë botë, dhe ne, jemi ata që korrim frytin e punës sonë të mirë e të veshme duke qenë të lumtur me të në këtë botë, e përveç kësaj, Allahu na shpërblen për të në Ahiret, duke

na bërë banorë të Xhenetit.¹⁰ Ja, ky pra është shpërblimi meritës, për ata që bartën lart flamurin e Njeshmërisë, pa u përkulur e pa u ligështuar, por duke qenë ballëhapur e krenarë dhe të kënaqur me Allahun Fuqiplotë për dhuntinë e besimit, në të cilin i kishte udhëzuar.

Porosia e ajeteve - (11-14)

- Mendjemadhësia është cilësi djallëzore, e cila e verbon njeriun që të mos shohë askënd para vetes. I tillë ishte edhe qëndrimi i idhujtarëve ndaj të varfërve prej radhës së myslimanëve. Ata duke u munduar ta nënvlerësojnë edhe vetë shpalljen hyjnore, thoshin me ironi e sarkazëm, që po të ishte ndonjë e mirë në këtë fe apo në këtë Kuran, nuk do të na paraprinin në këtë më të ulët, të varfrit dhe robërit. Sa për ta arsyetuar veten, thoshin se ky Kuran është trillim dhe gënjeshtëri e moçme! Të tilla ishin edhe qëndrimet e çifutëve ndaj Muhamedit a.s. dhe shpalljes hyjnore, sepse nuk mund ta imagjinonin faktin se pejgamberia ishte transferuar prej tyre tek arabët.

- Të gjitha Shpalljet hyjnore kanë të njëjtin burim. Si Tevrati, Zeburi dhe Inxhili, ashtu edhe Kurani, janë libra të zbritur nga Allahu nëpër kohë të ndryshme. Ashtu siç Kurani vërteton librat e mëhershëm, po ashtu edhe në këto libra, është paralajmëruar ardhja e vulës së krejt pejgamberëve, por duart e Ehli Kitab-it, u zgjatën drejt tyre, duke ndryshuar dhe shtrembëruar Fjalët e Allahut. Megjithatë, Kurani si shpallja e fundit hyjnore, na sqaroi për ligësitë e tyre duke qenë i vetmi Libër që askush nuk arriti të ndryshonte diçka në të, sepse Allahu xh.sh. garantoi për ruajtjen e tij.

- Ata që merituan epitetin “besimtar”, duke i qëndruar besnik besimit të tyre të paluhatshëm në Zotin xh.sh., dhe duke pasuar Muhamedin a.s., në këshillat e tij, do të jenë banorë të Xhenetit, duke përjetuar kënaqësitë e Allahut, pandërprerë dhe përgjithmonë. (vijon).

1. Imam Sujutiu, Lubabu-n-Nukul fi esbabi-n-nuzul, f. 232. 2. Po aty, ff. 232-233. 3. Po aty, f. 233. 4. Et-Tefsiru-l Munir, vëll. 26, f. 341. 5. Po aty, vëll. 26, f. 341. 6. Et-Tes 'hil li te 'vili-t-tenzil- tefsir Xhuz 'u Ahkaf fi sualin ve xhevabin, f. 34. 7. Ale Ha-mim - El-Xhathije vel Ahkaf, dirasetun fi esrari-l bejan, f. 382. 8. Et-Tefsir el mevdul li suveri-l Kuran, vëll. VII, f. 192. 9. Sejid Kutb, Fi Dhilali-l Kuran, vëll. VI, f. 3259. 10. Tefsir esh-Sharavi-Havatiri havle-l Kurani-l Kerim, vëll. 23, f. 14180.

Resul Rexhepi

Besimi dhe puna në dritën e fesë islame

“Nuk ka dyshim se ata që besuan Allahun dhe bënë vepra të mira, do të kenë kopshte të Xhenetit Firdeus për kënaqësinë e tyre!” (El-Kehf, 107)

Hyrje

Feja islame që në zanafillën e saj e gjithashtu edhe gjatë rrugëtimit të saj shumë shekullor, vazhdimisht u përqendrua në dy komponentë të rëndësishëm: në besimin e sinqertë në Allahun e Gjithëmëshirshëm dhe në punën e angazhimin e ndershmë.

Në të vërtetë, para se të shkëlqente drita e Kuranit, tek arabët dominonin parime e vese të gabuara. Jeta e ndershme kishte humbur kuptimin e saj. Ajo më s'kishte ndonjë peshë dhe për të kishin ndryshuar edhe mendimet e edhe qëllimet. Atëbotë, lidhjet dhe marrëdhëniet shoqërore ishin ngritur mbi dominimin e shtresës së lartë (të pasurit dhe të fortët) ndaj shtresës së ulët (të varfrit dhe të dobët). Pikërisht në këtë kohë të pa kohë dhe shumë të vështirë, kur shpresat e njerëzve tashmë ishin venitur skajshmërisht dhe në kulmin e këtyre kundërthënies, Allahu e dërgoi Muhamedin a.s. dhe përmes tij edhe Kuranin, për të thirrur njerëzit për të besuar në Zotin Një dhe për të ndryshuar këtë gjendje. Dëshira për këtë ndryshim njëherësh që edhe pikënisja për ndryshimin e një populli të tërë, duke mbjellë në zemrat e njerëzve besimin në një Zot-Krijuesin e Gjithësisë. Ai i tregoi njerëzisë se adhurimi i gjërave që s'të sjellin as dëm dhe as dobi është gjë e kotë, ndaj dhe adhurim meritor vetëm Krijuesi Fuqiptotë:

“Ky është Allahu - Zoti juaj! Nuk ka të adhuruar tjetër meritor përveç

Tij, Krijuesi i çdo sendi, prandaj adhuroni Atë. Ai është Mbikëqyrës ndaj çdo sendi!”¹

Armikutë, të cilët u munduan që në çfarëdo mënyre të pengonin përhapjen e fesë islame, nuk u dorëzuan lehtë, por, përkundrazi, ndërmorën të gjithë llojet e pengesave deri te përdorimi edhe i torturave kundër atyre pak myslimanëve të parë. Për më tepër, ata i shpallen luftë Pejgamberit a.s. dhe besnikëve të tij, madje edhe i bojkotuan, i lëcitën dhe bënë premtime e betime për t'i ndërprerë të gjitha lidhjet në mes tyre dhe palës myslimane. Dhuna e tyre bëri që të shkruanin “Proklamtën” e njohur, të cilën e varën në mes të Qabesë. Myslimanët qëndruan në këtë gjendje të vështirë të bojkotuar afro tri vjet me radhë, ushqimi u sillej vetëm fshehtëzi, e nga uria e madhe shumë herë u detyruan të hanin edhe gjethet të pemëve.

Besimi dhe puna në dritën e Kuranit

Me gjithë këto tortura e mundime, myslimanët nuk iu dorëzuan thirrësve injorantë e gabimtarë. Sepse, besimi i drejtë e i vërtetë kishte zbuluar zemrat e tyre dhe ai u jepte guxim e kurajë për t'iu bërë ballë të gjitha vështirësive. Ishte pikërisht besimi ai që i bënte që të forcoheshin në baza të forta gjerë sa t'ua bëjë Zoti të mundur fenë në tokë, t'i ndryshoj: pas dobësisë - fuqi, pas frikës - siguri, pas vështirësive - lehtësi, qetësi e paqe.

Në suren “En-Nur”, Zoti xh. sh. ka thënë: “Zoti u ka premtuar atyre nga mesi juaj që besojnë dhe punojnë (vepra) të dobishme se do t'i bëjë sundimtarë në tokë, sikurse që i ka bërë ata para tyre, dhe që do t'ua forcojë fenë e tyre me të cilën Ai është i kënaqur (të është fe për ata), dhe që frikën do t'ua zëvendësoj me siguri (qetësi). Ata më adhurojnë Mua e nuk më bëjnë shok asgjë. E, kush edhe pas kësaj mohon, të tillët janë të prishurit.”²

Kur e shfletojmë Kuranin, vërejmë se Allahu i Madhëruar, sa herë që e përmend besimin në Zot, gjithmonë atij ia bashkon edhe veprimin e punëve të mira e të vlefshme. Kur i lavdëron besimtarët e ndershmë, për ta thotë: “...ata që besojnë dhe që punojnë vepra të mira...”.

Kjo përsëritet shumë herë në Kuran, gjë që vërteton peshën dhe rëndësinë që ka. Jo vetëm kaq. Për të tillët besimtarë, Allahu do të dhurojë dashuri në zemrat e besimtarëve të tjerë. Ja si e përshkruan këtë Ebu Hurejra: “I Dërguari i Allahut a.s. ka thënë: “Nëse Allahu e do një njeri, Ai e thërret Xhibrilin duke i thënë “Allahu e do filanin! O Xhibril duaje atë!” Xhibrili do ta dojë atë, pastaj Xhibrili do të bëjë thirrje ndër banorët e qiellit, “Allahu e do filanin, kështu që edhe ju duhet ta doni atë.” Kështu të gjithë banorët e qiellit do ta duan atë njeri dhe pastaj atij i sigurohet kënaqësia e njerëzve të Tokës!”³

Ngjashëm me këtë, nga ana tjetër, kur Allahu i përmend njerëzit

besimtarë të shpëtuar nga zjarri i Xhehenemit, nuk e ndanë punën e dobishme nga besimi i sinqertë: “Përveç atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira...”³

Feja islame nuk e konsideron të vetëmjaftueshme për pjesëtarët e saj që të synojnë vetëm imanin-besim duke u përqendruar vetëm në të e asgjë tjetër, por, vrojtuesi i sinqertë vëren se si ajo, krahas besimit, kërkon edhe punën prej ithtarëve të saj, e vërteton vlerën e madhe të saj, bile atë e llogaritë edhe lutje: me punë dallohen njerëzit dhe sipas saj edhe shpërblehen: “Nuk do të shpërbleheni” (me asgjë tjetër) përveç (me atë) që keni punuar.”⁴

Në një ajet tjetër, Zoti xh.sh., thotë: “Dhe se njeriut nuk i takon tjetër përveç ajo që ka punuar, dhe se angazhimi i tij në të ardhmen do të duket, e pastaj do të shpërbehet me shpërblim më të drejtë!”⁵

Puna në dritën e fesë islame konsiderohet e drejtë e çdokujt dhe, mbi të gjitha, nder, detyrë dhe jetë njëkohësisht. Kjo në një anë, e në anën tjetër, Islami e urren pamasë parazitin, atë që jeton në kurriz të tjetërkujt duke shfrytëzuar djersën e tij. Pejgamberi a.s. i kushtoi respekt të posaçëm djersës së punëtorit, ndërsa për dorën e tij të vyshkur nga puna, pos tjerash, tha: “Këtë dorë kurrë nuk do e prekë zjarri i Xhehenemit.”

Me këtë, Pejgamberi a.s. e tregoi gradën e lartë që gëzon puna në fenë islame.

Për vlerën e punës në tokë duke kërkuar furnizim, Zoti xh.sh., në Kuran, urdhëron e thotë: “...Andaj, ecni gjithandej nëpër anë të Tokës dhe ushqehuni nga begatitë e saj, dhe se tek Allahu do të jetë Ringjallja!”⁶

Nga ky ajet i Kuranit qartazi kuptohet se Islami nuk e kufizon aktivitetin e njeriut, nuk e përcakton vetëm një fushë të caktuar, përkundrazi, rrethin e tij e le të lirë që të zgjerohet për t'i përfshirë të gjitha llojet e punës.

Nga praktika e Pejgamberit a.s.

Transmetohet se Muhamedi a.s. një ditë që ulur me disa shokë të tij, dhe rastësisht pranë tyre kaloi një djalosh i ri e i fuqishëm, i cili që zgjuar herët në agim dhe shkonte në punë. Shokët e Pejgamberit a.s. thanë: “Ah! Për këtë të gjorin! Sikur të ishte rinia dhe trupi i tij në rrugën e Zotit!”

- “Mos thoni ashtu, se ai nëse ka dalë për të punuar për fëmijët e tij të vegjël, ai është në rrugën e Zotit; nëse ka dalë të punojë për prindërit e tij të shtyrë në moshë, ai është në rrugën e Zotit; nëse ka dalë të punojë për veten e vet që të ndalet nga gjërat e ndaluara (haramet), ai është në rrugën e Zotit, e nëse ka dalë të punojë veç sa për sy e faqe e për mendjemadhësi, ai është në rrugën e djallit!” - iu përgjigj atyre Pejgamberi a.s..⁷

Duke parë Pejgamberi a.s. se çfarë pasojash kishte lënë përtacia nëpër popuj të ndryshëm, e ndaloi atë dhe e urreji skajshmërisht duke thënë: “Për ymetin tim më së tepërmi kam frikë: rritjen e barkut dhe dhënien pas gjumit e përtacisë!”.

Në një rast tjetër, Pejgamberi a.s. e lavdëroi punën me thënien e tij të mirënjohur: “Të merrte ndonjëri prej jush konopin e të bartte me të dru në shpinë, kishte me qenë më mirë për të se sa t'ia zgjaste dorën ndokujt, pavarësisht nëse i japin ose jo!”

Pejgamberi a.s. gjithmonë është kujdesur që ymetit të tij t'i mbjellë dashurinë për punën. Ai shumë herë e ka lavdëruar ngrënien e ushqimit si rezultat i punës së dorës vetanake, sepse kjo është më e mirë, dhe jo duke pritur e shikuar se kush po e zgjatë dorën për t'i ndihmuar. Lidhur me këtë, ai një herë tjetër kishte thënë: “Nuk ka ngrënë ndonjëri prej jush ushqim më të mirë se sa me ngrënë nga puna e dorës së vet, dhe se pejgamberi i Zotit, Davudi a.s., ushqehet nga puna e dorës së tij!”⁸

Për më tepër, Pejgamberi kishte njoftuar se Zekerijai a.s. kishte punuar si zdrukthëtar:

Transmeton Ebu Hurejreja se Pejgamberi a.s. kishte thënë: “Zeke-rijai a.s. kishte qenë zdrukthëtar!”

Prandaj, me zotëruar njeriu një zanat ose më shumë, natyrisht që është mirë. Fundja, njeriu sa më shumë që di dhe bën, aq më i vlerësuar dhe i dobishëm do të jetë.



Zoti xh.sh. e ka krijuar këtë gjithësi për njerëzinë dhe e ka nënshtruar që të shfrytëzojnë çdo gjë në të. Atë, Allahu nuk e krijoi për vetveten, I Lartësuar qoftë Allahu nga kjo me lartësim të lartë! As nuk e ka krijuar atë për melaqet, ngase melaqet nuk kanë nevojë të pinë ujë për të shuar etjen, nuk kanë nevojë për të veshur petk të bukur për ta mbuluar e zbukuruar trupin e tyre. As nuk e krijoi Zoti gjithësinë për gjallesat e tjera, se ato nuk kuptojnë – mendojnë çka bëjnë. Mu për këtë, Fuqiploti thotë në Kuranin famëlartë:

“Allahu është Ai, I Cili ka krijuar qiejt dhe Tokën, dhe (I Cili) çon shiun nga qielli duke nxjerrë fruta (begati) ushqim për ju; (Allahu është Ai) I Cili i ka bërë anijet të jenë të nënshtruara ndaj jush që të mund të lundrojnë nëpër det me leje të Tij; po ashtu Ai i ka bërë edhe lumenjtë të ju nënshtrohen juve. Ai ka bërë që Dielli dhe Hëna të ju nënshtrohen dhe për të mirën tuaj të qarkullojnë pandërprerë, dhe ua ka nënshtruar juve natën dhe ditën. Dhe ju ka dhënë gjithçka që I keni kërkuar, e nëse i numëroni Begatitë e Zotit, nuk do të mund t'i numëroni (nuk ka numër sa ka begati të Zotit). Vërtet, njeriu është tiran dhe mosmirënjohës!”⁹

Shembuj nga praktika e sahabëve

Të gjithë këto të mira që Zoti i Gjithëmëshirshëm i dha njerëzisë, Kurani në një vend i përmbledh shkurtimisht e thotë: “Ai është Zoti i Cili krijoi për juve gjithçka që ka në tokë.” Mu për këto begati, të cilat ia dhuroi Zoti xh.sh. njeriut, nuk i mbetet gjë tjetër atij, vetëm të aktivizohet në tokë duke punuar drejt që të ushqehet nga munda dhe djersa e tij. Në të vërtetë, njeriu me këtë ia arrin qëllimit të tij final-mbërrin kënaqësinë e Zotit, kënaqësi të cilën Ai e dëshiroi për robërit e vet besimtarë. Sa për ilustrim, po e cekim një shembull të gjeneratës së hershme

të sahabëve, të cilët ishin shembull për mbarë njerëzinë me pajisjen e tyre me këtë veti.

Transmeton Ebu Hasani se në një rast Osman bin Afvani kishte dëgjuar se shoku i tij, Eba Dherr el-Giffariu, kishte rënë në gjendje jo të mirë ekonomike. Për këtë arsye, ai ia kishte dërguar një sasi të hollash përmes robit të tij, duke e porositur: nëse e pranon ai këtë, ti do të jesh i lirë. Robi i dërgoi Eba Dherrit dhuratën, por u befusua kur ai nuk e pranoi dhe i tha: “Pranoje këtë, të mëshiroftë Zoti, se në pranimin e kësaj është liria ime!” Eba Dherr iu përgjigj: “Nëse në të është liria juaj, njëkohësisht në të është robëria ime!”, dhe kështu refuzoi pranimin e dhuratës, vetëm e vetëm për nder të shpirtit të tij.

Puna, kërkimi i furnizimit, të ndërruarit e vendit për këtë qëllim nuk është në kundërshtim me mbështetjen e besimtarit të Zoti xh.sh.. Këtë më së miri e shpjegon rasti i një personi i cili hyri në xhami e devenë e tij nuk e kishte lidhur, pastaj pyeti Pejgamberin: “A të lidhi devenë time, apo ta lë të lirë e të mbështetëm të Zoti xh.sh.?”

Pejgamberi iu përgjigj: “Lidhe devenë e pastaj mbështetu te Zoti!”

Kurse Hakimi transmeton nga Muaviu, i biri Kurrës, e thotë:

“Njëherë Omer bin Hattabi takoi disa njerëz të papunë dhe i kishte pyetur se kush jeni ju?

- “Të mbështeturit të Zotit!”-i kishin thënë ata.

- “I mbështetur është ai i cili e mbjellë një kokërr bereqet në tokë, e punon mirë e mirë, e pastaj mbështetet te Zoti xh.sh.”- iu kishte thënë Omeri.

Ja se ç’ju tha një ditë Muhamedi a.s. shokëve të vet lidhur me një person i cili i kishte kushtuar rëndësi të madhe anës shpirtërore, kurse anën fizike e kishte lënë pas dore krejtësisht. Ndërsa Pejgamberi a.s. ishte ulur në mesin e shokëve të tij, ata në bisedë e sipër po lavdëronin një shok të tyre duke thënë: “Me të vërtetë filani agjëron ditën, lutet tërë natën dhe gjithmonë përmend Zotin”.

- “Kush e furnizon atë?” – i pyeti Pejgamberi a.s.

- “Ne të gjithë e furnizojmë, ja Resulallah”.

- “Po të gjithë ju jeni më të mirë se ai!” – iu tha Pejgamberi a.s.

Kur dëgjuan shokët e Pejgamberit këtë konstatim nga ai, menjëherë u aktivizuan në fusha të ndryshme jetësore me qëllim që të furnizoheshin nga punët me duart e tyre dhe të fitonin një gradë të lartë tek Allahu xh.sh., sepse Allahu punëtorët e vyeshëm i krahason me luftëtarët që luftojnë për hir të Tij:

“...dhe të tjerët të cilët punojnë në tokë duke kërkuar nga begatitë e Zotit dhe të tjerët të cilët luftojnë në rrugën e Zotit.”¹⁰

Si përfundim

Kështu duhet të kuptohet feja islame, bazat dhe qëllimet e kësaj feje të ndritshme, besimi në të vetmin Zot xh.sh. dhe përforcimi i këtij besimi me punë dhe veprime të mira e të dobishme. Me këtë, në të vërtetë, njeriu i garanton vetes harmoni në këtë jetë e njëherësh arrin kënaqësinë e Zotit në botën e përtejme.

Myslimani, gjithashtu, me këtë i ndihmon – i kontribuon edhe bashkësisë së tij, e cila është dhe duhet të jetë simbol për çdo bashkësi tjetër shoqërore. Sepse në një hadith, të cilin e gjejmë si përmbyllja më e mirë për gjithë atë që u tha më sipër, Pejgamberi a.s. thotë:

“Imani – besimi nuk është vetëm me të dëshiruar (shpresuar), por çka zë vend në zemër dhe vërtetohet me punë. Në të vërtetë, një popull e kishte tradhtuar shpresa imagjinative, kishin lënë punën dhe qenë ulur duke thënë: ‘Ne kemi mendim të mirë në Zotin!’ Ata, me këtë u mashtruan rëndë, sepse po të kishin menduar mirë do të kishin punuar mirë!”¹¹

1. El-En'am, 102. 2. En-Nur, 55. 3. Transmeton Buhariu. 4. Jasni, 54. 5. En-Nexhm, 39-41. 6. El-Mulk, 15. 7. Transmeton Taberani. 8. Transmeton Buhariu. 9. Ibrahim, 32-34. 10. Ez-Zumer, 20. 11. Transmeton Dejlamiu nga “Musnedi” i Firdesiu.

Gary Miller

Kurani i mrekullueshëm (2)

Një fakt thelbësor, i cili s'mund të ripërsëritet mjaftueshëm, duke u shqetësuar për vërtetësinë e Kuranit është se paaftësia e dikujt për të shpjeguar një fenomen vetë, nuk e bën të domosdoshme pranimin e tij për ekzistencën e fenomenit, ose shpjegimin e dikujt tjetër mbi të.

Unë kam pasur kënaqësinë të intervistoj dr. Kith Mur për një prezantim televiziv dhe folëm gjerësisht rreth kësaj teme, e cila ishte e ilustruar me foto e kështu me radhë. Ai përmendi se disa nga gjërat që Kurani i përmend rreth zhvillimit të qenies njerëzore ishin të panjohura deri para 30 vjetësh.

Në fakt, ai tha se njëra nga gjërat në veçanti, përshkrimi i njeriut në Kuran, si një ushunjëz (copë mishi) (alakah) në njëren fazë ishte diçka e re për të; por kur ai kontrolloi për të, gjeti se ajo ishte e vërtetë dhe kështu e shtoi atë në librin e tij. Ai tha: “Unë kurrë nuk e kisha menduar këtë me parë.” Dhe kështu shkoi në departamentin zoologjik dhe kërkoi një foto të një ushunjëze. Kur mësoi se ajo i ngjante embrionit njerëzor, ai vendosi t’i përfshinte të dyja figurat në një nga librat e tij.

Dr. Mur gjithashtu shkroi një libër mbi embriologjinë klinike dhe kur e paraqiti këtë informacion në Toronto shkaktoi mjaft trazim në të gjithë Kanadanë dhe disa nga titujt kryesorë ishin me të vërtetë të lezetshëm. Për shembull, njëri nga titujt thoshte: “Diçka befasisëse e gjetur në një libër antik!” Është e qartë nga ky shembull, se njerëzit nuk e kuptojnë mirë se për çfarë bëhet fjalë. Faktikisht një gazetar e pyeti dr. Mur: “A nuk mendoni, se ndoshta arabët mund të kenë pasur dijeni rreth këtyre gjërave - përshkrimit të embrionit, pamjen, dhe se si ndryshon ai gjatë rritjes? Ndoshta ata s’kanë pasur shkencëtarë, por ndoshta ata bënë diçka si analizë

**Kurani ka thënë
të qarta dhe
koncize rreth
temave të
ndryshme dhe
njëkohësisht e
këshillon lexuesin
të vërtetojë
saktësinë e këtyre
thënieve
nëpërmjet
kërkimeve nga
studiuesit për këto
tema.**

anatomike e ruajtur nga njerëzit dhe i shqyrtuan këto gjëra.”

Profesori menjëherë i tregoi atij (gazetarit), se ka humbur një pikë shumë të rëndësishme, të gjitha fotot e embrionit që u shfaqën dhe u projektuan në film burojnë nga fotot e marra nëpërmjet një mikroskopi. Ai tha: “Nuk ka rëndësi nëse dikush është munduar të zbulojë embriologjinë 14 shekuj më parë, sepse ata nuk mund ta shikonin atë.” Të gjitha përshkrimet në Kuran mbi pamjen e embrionit janë kur ai është akoma shumë i vogël për t’u parë me sy, kështu që kujtdo i duhet mikroskop për ta parë atë. Përderisa një pajisje e tillë është gjendur vetëm para 200 vjetësh, dr. Mur e ironizoi: “Ndoshta

14 shekuj më parë dikush fshehurazi ka pasur mikroskop dhe e bëri këtë kërkim, pa bërë asnjë gabim gjëkund. Më pas kush e di se si e mësoi Muhamedin dhe e bindi atë ta vendoste këtë informacion në librin e tij. Më pas ai i prishi pajisjet dhe për ta ruajtur sekretin përgjithmonë. A mund ta besoni këtë? Me të vërtetë nuk duhet, vetëm në qoftë se sillni prova, pasi kjo është një teori kaq qesharake.” Kur u pyet se: “Si e shpjegoni këtë informacion në Kuran?” Përgjigja e dr. Mur ishte: “Nuk ka mundësi tjetër vetëm se të jetë Shpallje Hyjnore.”

Ndonëse shembulli i sipërpërmendur për njeriun që kërkon informacion që gjendet në Kuran ka të bëjë me një jomysliman, ai gjithsesi është i vlefshëm, sepse ai është një nga ata njerëz që është i ditur në lëndën e kërkuar. Ka disa njerëz laikë që thonë se çfarë thotë Kurani rreth embriologjisë mund të jetë e vërtetë, por kjo s’do të thotë se dikush duhet të pranojë patjetër fjalën e tij. Sidoqoftë, për shkak të pozitës së lartë, respektit dhe vlerës që njeriu i jep studiuesve (dijetarëve), natyrisht ndokush pranon që nëse ata kërkojnë rreth një teme të caktuar dhe arrijnë në një përfundim duke u bazuar në atë kërkim, atëherë përfundimi është i vlefshëm. Një nga kolegët e profesor Murit, Marshall Xhonson merret gjerësisht me fushën e gjeologjisë në Universitetin e Torontos.

Ai u tregua shumë i interesuar mbi faktin se thëniet e Kuranit rreth embriologjisë ishin të sakta dhe kështu ai kërkoi nga myslimanët që

t'i mblihdnin çdo gjë që në Kuran ka lidhje me specialitetin e tij. Sërisht njerëzit mbetën shumë të befasuar nga zbulimet. Përderisa ka një numër shumë të madh temash për të cilat flitet në Kuran, do të duhej patjetër një kohë shumë e gjatë për të shpjeguar çdo temë. Është e mjaft-tueshme për qëllimin e diskutimit tonë të thuash se, Kurani ka thënë të qarta dhe koncize rreth temave të ndryshme dhe njëkohësisht e kështjellon lexuesin të vërtetojë saktësinë e këtyre thënieve nëpërmjet kërkimeve nga studiuesit për këto tema. Dhe ashtu siç na e sqaron Kurani, ashtu ka dalë shumë qartë në pah saktësia. Pa dyshim qëndrimi që gjendet në Kuran nuk gjendet asgjëkund. Është shumë interesante sesi kur Kurani ofron informacion, ai shpesh i thotë lexuesit: "Ju nuk e keni ditur këtë gjë më parë". Realisht nuk ekzistojnë shkrime të vjetra që e pretendojnë një gjë të tillë. Të gjitha shkrimet dhe tekstet antike që njerëzit kanë në dispozicion ofrojnë shumë informacione, por gjithmonë tregojnë se nga vjen ky informacion.

Për shembull, kur Bibla rrëfen për historinë antike, shprehet se ky mbret jetoi këtu, ky luftoi në atë betejë, një tjetër ka pasur shumë djem etj. Ajo gjithnjë e kushtëzon se nëse ti dëshiron më shumë informacion, ti duhet të lexosh librin e këtij apo atij, sepse nga atje është marrë informacioni. Në kontrast me këtë koncept, Kurani u jep lexuesve informacion dhe thotë që ky informacion është diçka e re. Natyrisht është e vazhdueshme këshilla për të hulumtuar për informacionin që kemi dhe të kontrollojmë vërtetësinë e tij. Është interesante që një koncept i tillë nuk është sfiduar nga jomyslimanët 14 shekuj më parë. Në të vërtetë, mekasit që i urrenin myslimanët dhe që vazhdimisht dëgjonin këso shpalljesh që pretendonin të sillnin informacione të reja, për më tepër ata asnjëherë nuk e ngritën zërin dhe të thoshin: "Ky nuk është lajm i ri. Ne e dimë ku e ka marrë Muhamedi këtë informacion. Ne e kemi mësuar këtë në shkollë."

Ato nuk mundën të sfidonin vërtetësinë e tij, sepse ai me të vërtetë ishte i ri. Në përputhje me këshillat e dhëna në Kuran për të hulumtuar informacionin (edhe nëse është i ri), kur Omeri u bë kalif, ai zgjodhi një grup burrash dhe i dërgoi ata të gjejnë murin e Dhulkarnejn. Përpara shpalljes së Kuranit, arabët nuk kishin dëgjuar kurrë për këtë mur, por për shkak se Kurani e përshkroi atë, ata qenë në gjendje ta zbulonin atë. Në fakt ai tani gjendet në Durbend, në ish-republikat e Bashkimit Sovjetik.

Për shembull, libri telefonik është i saktë, por kjo s'do të thotë që është shpallje hyjnore. Problemi real shtrihet në faktin se dikush duhet të gjejë disa prova mbi burimet e informacionit në Kuran. Theksimi bie mbi lexuesin. Askush nuk mund të mohojë vërtetësinë e Kuranit pa prova të mjaftueshme. Në qoftë se me të vërtetë dikush gjen një gabim, atëherë ai ka të drejtë mos ta pranojë atë si të vërtetë. Kjo është pikërisht ajo çfarë na nxit Kurani. Një herë një burrë erdhi tek unë mbas një ligjërate që unë dhashë në Afrikën e Jugut. Ai ishte shumë i mërëzitur rreth asaj që kisha thënë dhe më tha: "Unë do të shkoj sonte në shtëpi dhe do të gjej

një gabim në Kuran." Natyrisht unë i thashë: "Urime. Kjo është gjëja më e zgjuar që ke thënë." Patjetër që kjo është përqasja, që myslimanët duhet të kenë me ata që kanë dyshime mbi vërtetësinë e Kuranit, sepse Kurani vetë e ofron të njëjtën sfidë. E pashmangshme pas pranimit të sfidës së tij dhe zbulimit se ai është i vërtetë, është se këta njerëz do të besojnë atë, sepse ata s'mundën ta hidhnin poshtë atë. Në thelb Kurani e fiton këtë respekt, sepse atyre vetë iu desh të saktësonin vërtetësinë e tij. Një fakt thelbësor, i cili s'mund të ripërsëritet mjaftueshëm, duke u shqetësuar për vërtetësinë e Kuranit është se paafësia e dikujt për të shpjeguar një fenomen vetë, nuk e bën të domosdoshme pranimin e tij për ekzistencën e fenomenit, ose shpjegimin e dikujt tjetër mbi të.

Sa për saktësim, vetëm sepse dikush s'mund të shpjegojë diçka, kjo s'do të thotë se dikush duhet të pranojë patjetër shpjegimin e dikujt tjetër. Gjithsesi refuzimi i personit mbi shpjegimet e të tjerëve e kthen barrën e provave mbrapsht mbi veten e tij për të gjetur një përgjigje të mundshme. Kjo teori përgjithësuese zbatohet për shumë koncepte në jetë, por i përshtatet shumë mrekullisht



sfidës së Kuranit dhe për këtë arsye krijon një vështirësi për atë që thotë: “Unë nuk e besoj atë.” Pas presionit të kundërshtimit, çdokush e ka menjëherë obligim të gjejë një shpjegim nga vetja e tij nëse ai e ndjen që përgjigjet e të tjerëve janë të papërshtatshme. Faktikisht në një ajet kuranor në veçanti, të cilin unë gjithmonë e kam parë të përkthyer keq në anglisht, Allahu përmend një njeri, i cili e dëgjon të vërtetën t’i shpjegohet atij. Aty thuhet se ai është i mjerë, sepse pasi e dëgjoji lajmin, ai u tërhoq pa e kontrolluar vërtetësinë e asaj që dëgjoji. Me fjalë të tjera, dikush është fajtor në qoftë se dëgjon diçka, nuk kërkon rreth saj dhe kontrollon për të parë nëse është e vërtetë apo jo. Supozohet se dikush duhet të përpunojë të gjithë informacionin që merr dhe duhet të vendosë çfarë është e pavlerë për t’u hedhur, dhe çfarë vlen, në mënyrë që informacioni të ruhet dhe të përfitohet prej tij më vonë. Askush s’mund ta lë atë thjesht, që të rrotullohet kot në kokën e vet. Ai duhet të vendoset në kategorinë e duhur dhe duhet t’i qasemi nga ajo pikë shikimi. Për shembull, në qoftë se informacioni është akoma hipotezë, atëherë dikush duhet të dallojë në qoftë se është më afër të vërtetës apo të pavërtetës. Por në qoftë se të gjitha faktet janë paraqitur, atëherë dikush duhet të vendosë mes këtyre dy zgjedhjeve. Edhe nëse ndonjëra s’del pozitiv rreth vërtetësisë së këtij informacioni, njeriut pra-pëseparë i kërkohet të kontrollojë të gjithë informacionin dhe të pranojë pastaj, se ai nuk e di me siguri. Edhe pse kjo e fundit mund të duket të jetë e kotë, në aktualitet është e dobishme në arritjen e një përfundimi pozitiv në një kohë të mëvonshme, që mund ta shtyjë personin të paktën ta njohë, ta kërkojë edhe ta rishikojë atë fakt. Kjo njohje me informacionin i jep personit një anë, kur zbulimet e ardhshme janë bërë dhe informacioni shtesë është prezantuar. E rëndësishme është se dikush ka të bëjë me faktet dhe nuk i hedh poshtë nga mirëkuptimi dhe mosinteresimi.

E vërteta mbi vërtetësinë e Kuranit është e qartë në sigurinë e brendshme, e cila mbizotëron kudo tek ai; dhe kjo siguri vjen nga një qasje e ndryshme - “Shteroji alternativat”. Në thelb Kurani thotë: “Ky libër është një shpallje hyjnore, në qoftë se ju nuk e besoni, atëherë çfarë është ai?” Me fjalë të tjera lexuesi sfidohet që të sjellë shpjegime të tjera.

Ja ku e keni këtë libër të bërë nga letra dhe boja. Nga erdhi? Ai thotë se është shpallje hyjnore; në qoftë se nuk është atëherë nga e ka burimin? Është i rëndësishëm fakti se askush nuk ka asnjë shpjegim të vlefshëm për këtë gjë. Në fakt të gjitha alternativat e mundshme janë shteruar. Ashtu sikurse kanë vërejtur vetë jomyslimanët këto alternativa janë reduktuar në dy shkolla ekskluzive mendimi, që këmbëngulin në njërin ose në tjetrën. Në njërin anë, ekziston një grup i madh njerëzish, të cilët kanë bërë kërkime mbi Kuranin mbi 100 vjet dhe thonë: “Një gjë e dimë me siguri - Muhamedi mendonte se ishte profet, ai ishte i çmendur.” Janë të bindur se Muhamedi a.s. ishte budalla në njëfarë mënyre. Pastaj nga ana tjetër, qëndron një grup tjetër që pohon: “Për shkak të këtij fakti, një gjë që e dimë me siguri është, se ai burrë, Muhamedi ishte gënjeshtar!” Ironike se si këto dy grupe s’mund të bëhen të dyja bashkë pa u kundërshtuar mes tyre. Në fakt shumë veta mbi Islamin zakonisht pretendojnë për të dyja teoritë. Ata e fillojnë duke thënë se Muhamedi ishte i çmendur dhe përfundojnë duke thënë se ishte gënjeshtar. Du-ket që ata kurrë s’kanë për të kuptuar, se ai s’mund të ketë qenë, edhe i çmendur, edhe gënjeshtar.

Për shembull, në qoftë se dikush është zhgënjyer dhe me të vërtetë mendon se ai është profet, atëherë ai nuk ulet vonë në darkë të planifikojë: “Si duhet t’i marros njerëzit nesër, që ata të mendojnë se unë jam profet?” Ai me të vërtetë besonte se ai është profet dhe ai besonte se përgjigja do t’i jepej nga shpallja. Faktikisht një pjesë e madhe e Kuranit erdhi si përgjigje për këtë pyetje. Dikush do

ta pyeste Muhamedin dhe shpallja do t’i vinte si përgjigje ndaj saj. Sigurisht, në qoftë se ndonjëri është i krisur dhe beson se engjëlli do të pëshpëriste fjalët në veshët e tij, atëherë kur dikush i bën atij një pyetje, ai do të mendonte se engjëlli do t’i jepte atij përgjigjen, sepse ai është i çmendur, kështu që me të vërtetë e mendon këtë. Ai s’i thotë kujt të presë pak dhe të vrapojë më pas te shokët për t’i pyetur: a e di ndokush këtë përgjigje? Kjo lloj sjelljeje është karakteristike e dikujt që s’beson se ai është profet. Ose je i gënjyeri, ose mund të jesh gënjeshtari. Ai mund të jetë një nga këto të dyja, por jo të dyja.

Skenari i mëposhtëm është një shembull i mirë i rrethit vicioz, që jomyslimanët i shkojnë pas. Nëse pyesni ndonjërin nga ata: “Cila është origjina e Kuranit?” Ai do të përgjigjet se buron nga mendja e një të çmenduri. Pastaj ju e pyesni atë: “Nëse vjen nga mendja e tij, nga e mori ai atë informacion që përmbahet në të? Natyrisht Kurani përmend shumë gjëra me të cilat arabët s’ishin të njohur.”

Kështu, me qëllim që t’ju shpjegojë faktin që ju po i jepni, ai e ndryshon pozicionin e vet dhe thotë: “Ndoshta ai nuk ishte i çmendur. Ndoshta disa të huaj ia sollën atij ato informacione. Kështu ai i gënjeu dhe u tha njerëzve, se ai ishte profet.” Në këtë pikë ju duhet ta pyesni atë: “Nëse Muhamedi ishte një gënjeshtar, ku e gjeti besimin e tij? Përse ai sillej sikur me të vërtetë e mendonte që ishte profet?” Më në fund e keni futur në një qoshe dhe ai do të përgjigjet me fjalët e para që do t’i vijnë ndërmend. Duke harruar që e ka djegur atë mundësi tashmë ai pretendon: “Epo, ndoshta nuk ishte gënjeshtar. Ai ndoshta ka qenë i marrë dhe mendonte me të vërtetë që ka qenë profet.” Dhe kështu nis edhe një herë nga fillimi në një rreth vicioz të kotë.

Përkthyer: Eni Tahiri dhe Roald A. Hysa.

Shpjegimi shkencor i ngjarjes së Jusufit nga kaptina “Jusuf”

“E kur ajo dëgjoi për ato pëshpëritjet e tyre, dërgoi t'i thërrasë ato, u përgatiti vend mbështetje dhe secilës prej tyre i dha nga një thikë e tha: “Dil para tyre!” Kur e panë atë, ato u tronditën dhe i prenë duart e tyre e thanë: “Allabut i qofshim falë! Ky nuk është njeri, ky nuk është tjetër vetëm se ndonjë engjell i lartë!” (Jusuf, 31)

Shumica e dijetarëve pajtohen që pejgamberi Jusuf a.s. nuk ka pasur rival në pamjen e bukur dhe qëndrimin e tij deri në atë masë sa që grupi i grave që ishin ftuar nga gruaja e ministrit, harruan që i kanë thikat në duart e tyre dhe në vend që t'i qëronin frutat, i prenë duart e tyre pa i ndier fare.

Tregimi ndoshta do të jetë i pabesueshëm dhe jo bindës për jobesimtarët, por dituria me ndihmën e metodave shkencore dhe anatomisë ka qëndrim krejt tjetër, e i cili është kompatibil me versetin e lartpërmendur.

Distraksioni apo kthimi i vëmendjes për t'i lehtësuar dhembjet

Ndryshimi i koncentritimit vëzhgues i shkaktuar me çfarëdo qoftë që e orienton mendimin, sot është fakt të cilin shkenca e vërteton. Në këtë proces, nën ndikimin e disa distraktorëve fillon të harrosh, gjegjësisht je i izoluar nga dhembjet tua.


Ëndrrat gjatë ditës dhe shikimi i TV-së janë shembulli i mirë, së pari procesi i brendshëm, ndërsa tjetri procesi i jashtëm për shkak të cilit koncentrimi i ndonjë personi është i penguar në skajshmëri dhe në

Ndryshimi i koncentritimit vëzhgues i shkaktuar me çfarëdo qoftë që e orienton mendimin, sot është fakt të cilin shkenca e vërteton. Në këtë proces, nën ndikimin e disa distraktorëve fillon të harrosh, gjegjësisht je i izoluar nga dhembjet tua.

tërësi orientohehet në shfaqje tjetër (distraktor).

Nuk ka dyshim, siç thotë shkenca, distraktori më efikas i cili do të mbizotërojë me trupin është ai i cili tërheq vëmendjen e qendrave për dëgjim, shikim, aromë, shije dhe ndjenja.

Në eksperimentin që e kanë bërë hulumtuesit në spitalin edukues, disa njerëz gjatë operimit kanë qenë të ekspozuar ndaj imazheve fascionante, përpos ilaçeve të përshkruara dhe rezultatet kanë qenë të jashtëzakonshme, në krahasim me rezultatet e disa njerëzve që nuk e kanë konsumuar ilaçin për ndryshimin e koncentritimit vëzhgues.



Ky studim për të cilin mjekët rekomandojnë që pos ilaçeve tradicionale të përshkruara, të shfrytëzohen mënyrat shtesë për të zvogëluar dhembjet, është botuar në revistën “Chest”.

Në faqen e internetit të BBC-së është shpallur hulumtimi me emërtimin “The return to nature”, në të cilin dr. Geel Hopkins thotë: “Ne kemi arritur sukses të lehtësojmë dhembjet e pacientëve tanë duke i ekspozuar ndaj imazheve të bukura dhe muzikës. Kjo ka ndihmuar shumë në minimizimin e efektit psikologjik dhe tendosjes fizike.”

Me përdorimin e rrezeve funksionale të trurit që paraqesin absorbimin e gjakut dhe ushqimit në qelizat nervore është treguar se kur personi është i ekspozuar çfarëdo qoftë një gjëje që shkakton distraksionin e koncentritimit, niveli i aktivitetit në disa regjione të trurit është i zvogëluar, siç është hipotalamusi, gyrus cingulatus, korteksi sensor dhe gyrus postcentralis, përgjegjës për marrjen e ndjenjës (përjetimit) të dhembjes. Aktiviteti në disa regjione të trurit rrit tajitjen e endorfinës, e cila vepron në receptorët e dhembjes si opiat.

Burimi: www.saff.ba

Përktheu dhe përshtati:

Prim.dr.med.sc. Ali F. Iljazi

Dr. Sedat Islami

Durimi si degë e besimit

Degë tjetër e besimit është edhe durimi. Ibën Haxheri madje e ka radhitur këtë në kuadër të veprave të zemrës, të cilat, siç dihet, kanë një vlerë dhe rëndësi më të madhe se veprat e tjera. Kjo na shtyn që durimin ta hulumtojmë së pari nga ky aspekt e pastaj të shohim se si mund ta shfrytëzojmë për gësitje edukimi.

Esenca e durimit

Në Kuran, durimi është përmendur rreth nëntëdhjetë herë.¹ Siç ka shpjeguar Imam Gazaliu, durimi është tipar që e karakterizon njeriun dhe natyrën e tij. Nuk imagjinohet te kafshët, për shkak të mangësisë së tyre, dhe as tek engjëjt, për shkak të përsosmërisë së tyre.² Durimi është vlerë, virtyt, pjekuri, largpamësi. Ibën Hibani, në mënyrë figurative, e ka përshkruar si prind të mendjes.³ Durimi është vetëdije e lartë dhe lidhje e fuqishme e besimtarit me fenë e vet. Kur është shpjeguar gjuhësisht, durimi (ar. sabr) është thënë se është e kundërta e xhezi't e cila nënkupton shqetësimin, pikëllimin, preokupimin, mërziqjen, frikën, etj.⁴ Besimtari që duron, nuk është se nuk i ka këto ndjenja e përjetime që mund t'i ketë secili njeri, porse lidhja me Allahun xh.sh., llogaritja në shpërblimin e Tij, në zgjidhjen e problemeve nga ana e Tij, e bëjnë që të mos pushtohet prej tyre. Dhimbja nga ndarja me një të afërm është krejtësisht normale, por durimi duke llogaritur në shpërblim dhe duke shpresuar në bashkim në botën tjetër e lehtësojnë dhimbjen. Durimi, siç shpjegon Xhurxhani, është që për fatkeqësitë, sprovat, dhimbjet, t'i ankohesh vetëm Allahut xh.sh.⁵

Për këtë shkak, durimi duhet të manifestohet menjëherë pasi të ndodhë sprovat a fatkeqësia.⁶ Pra, është parapërgatitja e besimtarit, ajo që e bën ta sfidojë fatkeqësinë qysh

Durimi është veprim që vjen si rezultat i bindjeve dhe principeve, për të bërë atë që feja dhe logjika e cilësojnë të mirë, dhe për t'u larguar prej tjetrës që feja dhe logjika na thonë të largohemi prej saj.

në momentin e parë të ndodhjes së saj. Së këndejmi, durimi nuk është dobësi. Allahu xh.sh., thotë: “Dhe për hir të Zotit tënd, duro.” (El-Mudethir, 7)

Durimi nuk është instinkt, por veprim i paramenduar dhe parapërgatitur për të.⁷ Siç shpjegohet, durimi është ndalim, mbyllje, pengim, mbajtje e nefsit për të bërë gjërat që parashihen logjikisht dhe fetarisht, apo për t'u larguar prej të tjerave që parashihen, po kështu logjikisht e fetarisht.⁸ Me fjalë të tjera, durimi është veprim që vjen si rezultat i bindjeve dhe principeve, për të bërë atë që feja dhe logjika e cilësojnë të mirë, dhe për t'u larguar prej tjetrës që feja dhe logjika na thonë të largohemi prej saj. Durimi është kontrolli mbi nefsën që të mos e humb durimin, të mos shfaqë hidhërim e pakënaqësi (me caktimet e Allahut), të mos shfaqë ankësë e as të mos i qahet askujt për hallet dhe dertet që ka. Durimi është veprim i

cili bëhet duke synuar shpërblimin e Zotit. Për këtë shkak mund të thuhet se si sinonim, sabri ka ihtisabin – llogaritjen në shpërblimin e Zotit. Buhariu shënon hadithin kudsij në të cilin Allahu xh.sh. thotë: “Për robin, të cilit ia kam marrë të dashurin e vet (fëmijën, prindin, etj.) dhe ka bërë ihtisab (duruar duke shpresuar në shpërblimin Tim) nuk ka shpërblim tjetër pos Xhenetit.”⁹

Llojet e durimit

Durimi mund të ndahet në mënyra të ndryshme, siç ka përmendur Imam Gazaliu¹⁰, por si forma më të përhapura të tij dhe që dijetarët i nënvizojnë më shumë janë tri:

1. Durim në raport me bindjen dhe dëgjueshmërinë ndaj Allahut xh.sh., respektivisht durimin për t'i kryer obligimet dhe detyrimet fetare,
2. Durim në raport me largimin nga ndalesat e Allahut xh.sh., dhe
3. Durim në raport me caktimet e dhimbshme të Allahut xh.sh.

Reflektimi edukativ i durimit

Se durimi ka rëndësi të madhe për besimtarin flasin tekste të shumta, disa prej të cilave edhe do t'i zbërthejmë në mësim edukativ më poshtë. Ajo që duam të përmendim këtu është një konstatim i Sufjan Theuriut për rëndësinë e durimit: “Besimtari ka më shumë nevojë për durim se që ka nevojë për bukë dhe ujë.” Kjo për faktin se durimi, siç

edhe kemi përmendur më parë, është forcë e brendshme e cila na mundëson të kemi kontroll mbi nefsën tonë.

Në vazhdim, do të mundohemi t'i evidentojmë fushat ku durimi na bën më të virtytshëm e më të plotësuar:

Mendimi i mirë për Allahun xh.sh.

Nëse durimi nënkupton të kundërtën e shqetësimit, mërzitjes, frikës, pikëllimit, kjo është për shkak të mendimit të mirë që ka besimtari për Allahun xh.sh.. E sa ka rëndësi të pasurit mendim të mirë për Allahun xh.sh., mësojmë nga porosia e Pejgamberit Muhamed a.s.. Xhabir bin Abdullahu r.a., transmeton ta ketë dëgjuar të Dërguarin e Allahut duke thënë tre ditë para se të vdiste: “Të mos vdesë askush prej jush ndryshe vetëm se duke ndarë mendim të mirë për Allahun xh.sh..”¹¹

Imazhi i drejtë i besimtarit

Nëpërmjet durimit, besimtari arrin të dëshmojë praktikisht nivelin e lartë të besimit dhe lidhjes me Zotin. Në një prej haditheve të tij, Pejgamberi Muhamed a.s. na e shpjegon këtë. “Çudi me punën e besimtarit dhe vetëm besimtarit, ngado që ta sjellësh, është në dobi të tij: nëse i ndodhë një e mirë, falënderon, kështu që është e mirë për të. Nëse i ndodhë një e keqe, duron, kështu që është e mirë për të.”¹²

Pra, besimtari di ta menaxhojë secilin rast në jetën e tij. Për të mirat, falënderon, sepse falënderimi i ruan dhe i shton ato, ndërsa për të këqijat, bën durim, sepse durimi shpërblehet. Këtu vjen në shprehje esenca e durimit që, siç kemi shpjeguar më lartë, është e kundërta e xhezeit ose shqetësimit, pikëllimit, mërzitjes, humbjes së durimit. Nga këtu, Kurani, kur e përshkruan besimtarin e goditur me fatkeqësi, e vë në pah



këtë element të maturisë dhe lidhjes me Allahun xh.sh..¹³ “Të cilët, kur i godet ndonjë fatkeqësi thonë: Të Allahut jemi dhe vetëm tek Ai do të kthehemi!” (El-Bekare, 156)

Pejgamberi a.s., siç shënuam më lartë, ka konsideruar se durimi, si vlerë dhe virtyt, jetësohet menjëherë pas goditjes nga fatkeqësia. Pra, nëse arrin të durosh në ato momente, konsiderohet se ke fituar shpërblimin e durimit. Imam Kurtubiu duke e shpjeguar këtë, shpjegon se arsyeja e kërkesës profetike që durimi të ndodhë menjëherë pas goditjes nga fatkeqësia qëndron në forcën e zemrës dhe vendosmërinë e saj përballë asaj fatkeqësie.¹⁴ Për këtë shkak, Ibën Abasi r.a., ka thënë: “Durimi është parapërgatitja dhe furnizimi më i mirë për ditët e vështira.”

Përsosja e virtyteve nëpërmjet durimit

Nëpërmjet durimit, besimtari arrin të përsosë virtyte. Duke na e përshkruar në mënyrë figurative durimin, Aliu r.a., ka thënë: “Po të ishte durimi burrë, do të ishte goxha i përsosur!” Kjo për faktin se durimi është mënyrë e mirë për t'i kultivuar

raportet me të tjerët. Jo të gjithë na trajtojnë me butësi dhe sikur ta kthenim çdo të keqe me të keqe nuk do të mbetej njeri në tokë. Për këtë shkak, raportet e mira janë shpjeguar si durim. Hasan Basriu paskësh thënë: “Fqinjësi e mirë nuk është të mos e dëmtosh fqinjin, por të durosh të ligat dhe prapësitë e tij.” Pra është një nivel tjetër i lidhjeve dhe raporteve në të cilin nuk fillohet me të keqen, por as e keqja nuk kthehet me të keqe.

Të parët tanë durimin e kanë trajtuar si mjet të ruajtjes së emrit dhe reputacionit, ata kanë thënë: “Kush bën durim ndaj epshit (e kontrollojnë atë), do ta ruajë burrrërinë.”

Pas Allahut të Madhëruar, për shërimin e shumë veseve të liga, i detyrohemi durimit. Për këtë shkak, durimi është cilësuar si brumi me të cilin bëhen ilaçe e barëra kundër veseve dhe dukurive negative. P.sh., nëse dikush vuan nga tërbimi ose mos përmbajtja epshore, atëherë, siç na ka mësuar feja, ai duhet të agjërojë.¹⁵ Ky i fundit, agjërimi pra, jo që nuk mund të paramendohet pa durim por është vetë durimi, është sinonim i durimit. Për këtë shkak, Ramazani quhet muaj i durimit.¹⁶

Sakrificat për të vërtetën

Nga këtu, durimi është forcë për t'u ballafaquar me sfida e sproveda, forcë për të vazhduar përkundër pengesave, forcë për të mos e braktisur të vërtetën kurrë. Në komentin e ajetit 200 nga kaptina Ali Imran: "O besimtarë! Bëhuni të durueshëm dhe nixiteni njëri-tjetrin të jeni të tillë; bëhuni të vendosur dhe vigjilentë (në vepra të mira dhe në ruajtjen e kufijve) dhe kijeni frikë Allahun, që të shpëtoni!", Hasan Basriu ka thënë: "Besimtarët janë urdhëruar për të duruar për fenë e tyre, për të mos e lënë kurrë atë, pavarësisht gjendjes që kanë a do ta kenë, derisa të vdesin."¹⁷

Sigurisht, kushdo që shfleton për stabilitetin në fe si mësimin më të rëndësishëm do ta gjejë durimin. Disa shokë erdhën te Pejgamberi a.s. dhe u ankuan për gjendjen e rëndë, për sprovat me të cilat ballafaqoheshin. Pejgamberi iu rrëfeu për një besimtar nga gjeneratat e mëhershme i cili që mbytur në mënyrë primitive ndërsa nuk kishte pranuar ta linte fenë. Për këtë shkak, i porosit shokët që të durojnë dhe të mos i përshpejtojnë gjërat sepse premtimi i Allahut për triumfin e kësaj feje do të ndodhë patjetër.¹⁸

Durimi në kohë fatkeqësish

Durimi është forma e duhur e trajtimit të fatkeqësive dhe belave që na godasin. Nëse ajo që na ndodhë nuk mund të ndryshohet, atëherë durimi është mënyra e përfitimit prej saj (përfitimit të shpërblimit) dhe jo vetëm. Është dhe mënyra e dëshpërimit edhe më të madh të armiqve e kureshtarëve. Këta të fundit sprovat dhe fatkeqësitë i shohin si momente gëzimi për ta. Për të mos ua mundësuar një gjë të tillë, urtarët na kanë porositur të durojmë. Ibën Kudame Makdisiu citon një urtar të ketë thënë: "Humbja e durimit (ar. xhezi) nuk mund ta kthejë atë që ka shkuar e ka humbur. E tëra që mund të bëjë, është ta bëjë një përqeshës të kënaqet me fatkeqësinë tonë."¹⁹

Ndjekja e modeleve të përsosura

Durimi është tipar dallues i njerëzve të përzgjedhur të Allahut, pejgamberëve. Në Kuran, i Dërguari i fundit, Muhamedi a.s. dhe ne, udhëzohemi që të durojmë ashtu siç kanë duruar pejgamberët, madje ata më të dalluarit: "Prandaj, ti bëhu i durueshëm (o Muhamed), ashtu siç

kanë duruar me këmbëngulje të dërguarit e vendosur dhe mos kërko shpejtimin e dënimit për ata!..." (El-Ahkaf, 35)

Për besimtarin që Pejgamberin e ka shembull dhe model që e ndjek në çdo gjë, ky fakt, e nxit dhe motivon edhe më shumë të durojë sepse, po të mos ishte durimi i mirë, nuk do të dallohej Pejgamberi Muhamed a.s. dhe as pejgamberët e tjerë. Durimi, duke u thirrur në pejgamberë ka qenë praktikë edhe e vetë pejgamberëve. P.sh., kur dikush i tha një fjalë të rëndë pejgamberit tonë, Muhamedit a.s., ai iu përgjigj: "Allahu e mëshiroftë Musanë, u keqtrajtua edhe më shumë e duroi."²⁰

Durimi në mision

Durimi, nga kjo perspektivë, është mënyrë se si një thirrës duhet t'i trajtojë njerëzit të cilët i thërret në fe. Jo çdoherë do të gjejë pranim, jo çdoherë do të trajtohet me mirësjellje, kështu që, në rastet e tjera, durimin duhet ta ketë armë për të mos lejuar dështimin e misionit që bart mbi supe. Për këtë shkak, në komentin e ajeteve që shënuam sipër, disa dijetarë kanë thënë: "Duroji sjelljet e këqija dhe shqetësimin që disa njerëz (mohues e kundërshtarë të fesë) ta shkaktojnë dhe mos kërko përshpej-



“Prandaj, duro për gjykimin e Zotit tënd...”

(El-Kalem, 48)



tim të dënimit për ta...”²¹ Pra, ajo që kërkohet prej nesh, është vazhdimi i misionit, pavarësisht pengesave që mund të hasim. Këtu qëndron mbase edhe urtësia e porosisë së Pejgamberit Muhamed për të mos u izoluar për kinse ruajtje të fesë në kohën kur lipset angazhimi ynë në terren: “Besimtari që shoqërohet me njerëz dhe i duron fyerjet e lëndimet e tyre është më i mirë se tjetri që nuk i shoqëron njerëzit dhe nuk i duron dot fyerjet e tyre.”²²

Duhet të durojmë sepse ajo që kërkohet prej nesh është kumtimi i fjalës së Zotit, pavarësisht se e pranojnë njerëzit apo jo. Këtë na e mëson edhe Kurani. Allahu xh.sh. thotë: “Prandaj, duro për gjykimin e Zotit tënd...” (El-Kalem, 48)

Në komentin e këtij ajeti është thënë: Duro sepse është detyrë e jotja të kumtosh dhe ta përcjellësh shpalljen. Përgënjeshtrimi i njerëzve mos të të zmbarspi nga kumtimi...²³

Përzgjedhja e shoqërisë

Durimi shprehet edhe në përzgjedhjen e shoqërisë. Ndonjëherë ftesa që shokët e këqij bëjnë për në epshe është tejet joshëse të cilës vetëm një besimtar i fortë mund t'i bëjë ballë. Nga këtu, Allahu xh.sh., na porosit që të mos lejojmë nefsën të na marrë nën kontroll, por të jemi në ata që duke duruar qëndrojmë me njerëzit që e adhurojnë Allahun xh.sh. e nuk e kundërshtojnë: “Dhe qëndro me ata që i luten Zotit të vet në mëngjes dhe mbrëmje, duke

dëshiruar Fytyrën (kënaqësinë) e Tij dhe mos i shmang sytë nga ata (te të tjerët), duke dëshiruar stilitë e shkëlqimin e kësaj jete. Mos dëgjo atë zemrën e të cilit ia kemi lënë mospërfillëse ndaj përmendjes Sonë, e që shkon pas dëshirave të veta, duke shkelur çdo kufi në veprimet e veta.” (El-Kehf, 28)

Ky ajët, siç ka shënuar Abdurrahman Sa'di, është urdhër për përzgjedhje të shokëve të mirë, për ta luftuar nefsën me tërë forcën që mos të të largojë prej shoqërimit të tyre, edhe nëse janë të varfër.²⁴ Vënia e nefsit nën kontroll, që po u synuaka në këtë ajët, është esenca dhe thelbi i durimit.

Durimi është rrugë vetëzhvillimi

Nëse duam të avancojmë, duhet ta kuptojmë se durimi (për të mësuar, hulumtuar, punuar, kaluar kohë larg familjes...) është mënyra se si arrijmë të suksesi. Allahu xh.sh. thotë: “Ne zgjodhëm prej tyre prijës, të cilët udhëzonin me urdhrat Tanë, për sa kohë që ishin të durueshëm dhe besonin bindshëm.” (Es-Sexhde, 24)

Ibën Tejmije ka thënë: “Me durim dhe bindje arrihet imameti (pozita e lartë) në fe.”²⁵ Mejmuni bin Mihrani ka thënë: “Askush, as nga pejgamberët dhe as nga njerëzit e rëndomtë, nuk ka arritur ndonjë të mirë të madhe përveç se me durim.” Disa kanë thënë: Kapërdije durimin sepse nëse të mbytet, shkon shehid, e nëse jo, jeton krenar.²⁶

1. Shih: Ibën Kudame el-Makdisi, Muhtesar minhaxhi el-kasidine, vep. cit., f. 268. 2. Ebu Hamid el-Gazali, Ihjau ulumiddin, vep. cit., 4/61. 3. Ibën Hibbani ka thënë: Mendja i ka dy prindër, njëri është durimi e tjetri është verifikimi. Shih: Reudatu el-ukala, f. 26. 4. Shih: Sulejman Tomçini, Fjalor arabisht-shqip, (Tiranë: Insituti i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam, 2010), f. 117; Muhamed Salih el-Munexhid, A'mal el-kulub: Es-sabru, (Huber : Mexhmuat Zad li en-neshr, 2009), f. 7. 5. Grup autorësh, Meusuatu et-tefsiri el-meuduij, vep. cit., 20/202. Këtë mund ta kuptojmë edhe nga shpjegimi i Sufjan Theuriut i cili duke folur për thelbin e durimit ka thënë: Tri gjëra janë pjesë përbërëse e durimit: të mos flasësh për dhimbjen tënde, të mos flasësh për fatkeqësinë tënde, dhe të mos e shfaqësh (dëlirsh, arsyetosh) veten. Sufjan Theuriu, sipas: Tefsirit të Taberit, 15/585. 6. Pejgamberi a.s. ka thënë: “Durimi është në momentin e parë të goditjes...” Hadithin e shënojnë Buhariu, nr. 1283, dhe Muslimi, nr. 926. 7. Këtë mund ta kuptojmë edhe nga hadithi që e shënojnë Buhariu dhe Muslimi e në të cilin qëndron se Pejgamberi a.s. ka thënë: “...kush shfaq durim, Allahu do t'i dhurojë durim...” Shih: Buhariu, nr. 1469; Muslimi, 1053. Pra, durimi është diçka që fitohet. Durimi është tipar i njerëzve të pjekur dhe të vërtetshëm. Një malësor arab paskësh thënë: Durimi është i hidhur, e shijon veç ai që nuk është i lidhur. Shih: El-besair ve edh-dhehair, 218. 8. Grup autorësh, Meusuatu et-tefsiri el-meuduij, (Rijad: Qendra e Tefsirit për Studime Kuranore), 20/202; Muhamed Salih el-Munexhid, A'mal el-kulub: Es-sabru, vep. cit., f. 7. 9. Hadithin e shënon Buhariu në Sahih, nr. 6424. 10. Ebu Hamid el-Gazali, Ihjau ulumiddin, vep. cit., 4/67-75. 11. Hadithin e shënon Muslimi në Sahih, nr. 2877. 12. Hadithin e shënon Muslimi në Sahih, nr. 2999. 13. Në fakt, kjo është dhe porosi hyjnore. Shih: Kurani: Bekare, 45. 14. Cituar sipas: Muhamed Salih el-Munexhid, A'mal el-kulub: Es-sabru, vep. cit., f. 15. 15. Pejgamberi Muhamed a.s., ka thënë: “Ai që i ka mundësitë, le të martohet, sepse e ka më të lehtë uljen e shikimit dhe ruajtjen e nderit. Ndërkaq, ai që nuk i ka mundësitë, le të agjërojë, sepse ai ia shuan epshin.” Hadithin e shënon Buhariu, nr. 1905. 16. Për Ramazani si muajt të durimit, Pejgamberi a.s., ka thënë: “Agjërimi i muajit të sabrit dhe tre ditëve prej çdo muaji konsiderohet agjërim i tërë kohës (vitit).” Hadithin e shënon Nesai. Shih: Sahihu en-Nesai, 2407. 17. Grup autorësh, Meusuatu et-tefsiri el-meuduij, vep. cit., 20/206. 18. Hadithin e shënon Buhariu në Sahih, nr. 3612. 19. Shih: Ibën Kudame el-Makdisi, Muhtesar minhaxhi el-kasidine, vep. cit., f. 268. 20. Hadithin e shënon Buhariu në Sahih, nr. 3150. 21. Grup autorësh, Meusuatu et-tefsiri el-meuduij, vep. cit., 20/220. 22. Hadithin e shënon Tirmidhiu. Shih: Sahih et-Tirmidhi, nr. 2507. 23. Grup autorësh, Meusuatu et-tefsiri el-meuduij, vep. cit., 20/220. 24. Shih: Sa'di, Tejsir el-Kerimi err-Rrahman fi tefsiri Kelami el-Mennan, vep. cit., f. 639. 25. Cituar sipas: Muhamed Salih el-Munexhid, A'mal el-kulub: Es-sabru, vep. cit., f. 26. 26. Shih: Ibën Kajimi, Medarixh es-salikinë, 2/159.

Prof. ass. dr. Rexhep Suma

Shkallët e ndikimit në misionin e daves

Është e padiskutueshme se njerëzit që ftohen, nuk përgjigjen të gjithë njëllë, nuk kuptojnë njëllë, nuk kanë të njëjtin nivel dijeje dhe feje..., andaj t'u ligjërosh të gjithëve njëllë, nuk është aspak e urtë. Profeti ynë, por edhe profetët e tjerë a.s. para tij ishin të kujdesshëm ndaj gjendjes së njerëzve dhe i trajtonin ata me urtësi dhe me metoda efikase.

Duke u nisur nga fakti se në esencë çfarëdo thirrje apo predikimi nuk e ka shkallën e barabartë për sa i përket intensitetit të ndikimit qoftë në pranim apo refuzim të saj, ashtu edhe metodologjitë e ndjekura përgjatë misionit të thirrjes islame (dave), nuk mund të jenë të njëjta, në sukses apo edhe në vetë forcën e bindjes, miratimit, dëshirave dhe animet.

Në këtë vazhde duhet pasur parasysh fakti se jo të gjithë thirrësit (predikuesit) kanë të njëjtë shkallën e artit të bindjes, artit të sqarimit, mençurisë, ndikimit dhe stërvitjes. Dhe këtu duhet pasur theksin mbi atë se çdo element nga këto elemente kanë shkaqet që do të shtjellohet në vazhdim të tematikave. Pra, secili element ka pjesën e tij të ndikimit në mesin e të ftuarve nga shkalla në shkallë dhe nga forca në forcë.

Andaj njerëzit që ftohen në fe, janë pjesë thelbësore në thirrjen për tek Allahu xh.sh., pasi edhe vetë thirrja është ligjëruar pikërisht për ta dhe profetët u dërguan po për këta njerëz. Është me rëndësi t'u kushtohet vëmendje, të studiohet gjendja e tyre, në mënyrë që të sillemi ashtu siç është më e përshtatshme dhe siç na urdhëron feja jonë e drejtë. Është mungesë serioziteti që fjalët të hidhen kot më kot, me arsyetimin se po u bëjmë të ditur të vërtetën, pa marrë parasysh gjendjen e të ftuarve. Apo të urdhërojmë për të mirë dhe ndalojmë

Është mungesë serioziteti që fjalët të hidhen kot më kot, me arsyetimin se po u bëjmë të ditur të vërtetën, pa marrë parasysh gjendjen e të ftuarve.

nga e keqja – thjesht urdhër ndalim, pa e njohur realitetin në të cilin ata jetojnë. Është gabim i dukshëm në thirrje, ajo që bëjnë disa predikues, që nuk respektojnë gjendjen respektive të të ftuarve. Rastis, që ndonjë nga këta thirrës e ka memorizuar hytbenë e xhumasë, një mësim apo një këshillë, dhe shkon e flet në çdo vend e në çdo kohe me lloj-lloj njerëzish dhe pa marrë parasysh nivelin e tyre të ndryshëm të besimit, të shkollimit dhe të arsyetimit.

Qëllon që ndonjë predikues të mbajë ndonjë leksion apo hytbe, që është mbajtur para shekujsh të tërë. Ai nuk ia ndryshon as fjalët dhe as mënyrën e të shprehurit në raste të përshtatshme apo pa raste hiç! Thua se njerëzit janë njëllë, qofshin këta intelektualë e të ditur apo njerëz të rëndomtë dhe të paditur.¹

Por edhe në fillet e daves gjejmë se kur filloi thirrja të rritet dhe të dëgjojnë njerëzit për të, shohim se thirrja e tij dallonte në udhëzim dhe pranim nga një sahabi te tjetri, pra varësisht nga individi, gjendja dhe thirrësit. Disa sahabë besuan thjesht, vetëm se i thirri i Dërguari a.s. në fenë islame, apo vetëm që kishin dëgjuar për të, e tillë ishte gjendja edhe me gratë dhe me fëmijët.

Sahabët nuk hezituan në përqaftimin e Islamit

Kemi rastin e sahabiut të nderuar, Ebu Bekrit r.a. i cili nuk hezitoi, por menjëherë iu përgjigj thirrjes islame. Transmeton Ibën Is'haku nga Muhamedi a.s., i cili ka thënë: "Nuk e kam ftuar asnjë në Islam vetëm se të ketë pasur një hezitim, pengesë apo vonesë, përveç Ebu Bekrit."²

Pas një periudhe, Islamin e përqaftuan Omeri r.a. dhe të tjerët. Ibën Abasi para çlirimit të Mekës, sikurse Halid ibën Velidi. Më pas besoi Ebu Sufjani etj., e kështu u shtri parametri i përhapjes së mesazhit hyjnor në Gadishullin Arabik dhe më gjerë. Kjo nuk do të thotë se ndikimi ishte kohor dhe nuk kishte shkaqe, e pastaj u shfaq befasi në formën e bindjes së plotë dhe dorëzimit, por kësaj i ka parapri

Një grup i njerëzve nuk shfaqin haptazi ndjenja apo vëmendje për ftesën tonë, porse ata në brendësi të vetës së tyre përmbajnë elemente dhe dashuri ndaj të vërtetës dhe parimeve të saj

mendim i gjatë, andaj u ndikuan nga shkallë dhe situata të ndryshme, që në shumicën e rasteve ishte përshkallëzim drejt majës së vetëndikimit dhe reagimit.

Ky i ftuar (i sapo hyrë në Islam) në këtë thirrje të re, e u zhyt në të, dhe më pas u shndërrua në mbrojtës e ushtar i denjë i këtyre parimeve

hyjnore siç kemi shembullin e Halid ibën Velidit, Osman bin Afanit, Omer ibën Asit etj.³

Duke i konkretizuar shkallët e ndikimit, themi se ato dallojnë varësisht nga gjendja e të ftuarve, pasi që i ftuari apo marrësi i mesazhit kur i arrin ideja e pranon mbi bazën e faktorëve të lartcekur me shkallë të ndryshme të ndikimit, e disa nga to do t'i përmendim në vijim.

1. Ka nga mesi i tyre që arrin shpejtë të kuptoj të drejtën dhe e përqafojnë pa hezitim, duke shprehur besimin mbi parimet e fesë, duke parë mirësi në të dhe duke gjetur prehje shpirti i tij, e sigurisht edhe zemra dhe me këtë hap ai iu bashkohet radhëve të besimtarëve.

2. Një grup i njerëzve nuk shfaqin haptazi ndjenja apo vëmendje për ftesën tonë, porse ata në brendësi të vetës së tyre përmbajnë elemente dhe dashuri ndaj të vërtetës dhe parimeve të saj, duke i kushtuar shumë kujdes kësaj çështje. Kjo kategori kërkon nga ne që të zhvillojmë komunikim të vazhdueshëm me ta dhe të kenë vëmendjen tonë duke mos përtuar që të sqarojmë mesazhet e fesë dhe lumturinë që ofron ajo në këtë dhe në botën tjetër. Kjo përpjekje duhet

të vazhdojë derisa tek ata të zgjohen ndjenjat dhe ky ndikim të dalë në sipërfaqe, e të ngrihen në shkallën e besimtarëve të zellshëm.

3. Një kategori tjetër, e shohin predikuesin, parimet dhe fjalët e tij me dyshim dhe hamendje, duke shfaqur një hezitim nën presionin e traditave të mjedisit mbi të apo edhe zhurmimin e urrejtësve e përgjuesve mbi mendjen e tij. Me këtë kategori duhet të sillemi mirë, mos ta urrejmë, por vazhdimisht e këshillojmë që të mendojë mbi argumentet. “Thuaj: “Unë ju këshilloj vetëm me një gjë: Për hir të Allahut të angazhoheni sinqerisht dy nga dy ose një nga një, e pastaj të mendoni thellë (që ta kuptoni) se shoku juaj (Muhamedi) nuk ka ndonjë çmendje. Ai nuk është tjetër vetëm t’ju tërheqë vërejtjen për një dënim të ashpër (nëse nuk besoni).” (Sebe, 46) Duke komunikuar me këtë në këtë formë, do të shohim se shpirti dhe zemra e tij do të gjejë qetësinë te ne, sepse e vërteta gjithnjë triumfon dhe shpien drejt rrugës së drejtë.

4. Një kategori njerëzish janë ata që vështrojnë thirrjen islame si përfitim material dhe reputacion individual, që me anë të saj synojnë



“Thuaj: “Namazi im, kurban i im dhe vdekja ime janë thjesht për Allahun, Zotin e botëve. Ai nuk ka shok (nuk adhuroj tjetër). Me këtë (thjeshtësi të adhurimit vetëm për Zotin) jam i urdhëruar dhe jam i pari i myslimanëve (i pari që pranoj dhe bindem)!”

(El-En'amë, 162-163)

t'i realizojnë synimet e tyre. Kjo kategori është e rrezikshme, ngase njetit e tyre nuk shfaqen lehtë, por qëllimi i tyre mund të kuptohet vetëm nëse qëndrojmë gjatë me ta, duke i vështruar sjelljet dhe qëndrimet e tyre në situata të caktuara si në dhënie apo marrje, në kohë vështirësie apo qetësie, gëzime e hidhërime dhe këtë më së miri e përshkruan Kurani famëlartë, ku thotë: “Ka nga njerëzit që adhurojnë Allahun me mëdyshje (luhatshëm), nëse e godet ndonjë e mirë ai qetësohet më të, po nëse e godet ndonjë e pakëndshme, ai kthehet në fytyrën e vet të vërtetë (të mëparshme), ai e ka humbur këtë dhe jetën tjetër e ky është ai dështimi i qartë.” (El-Haxh, 11) Po ashtu, në një ajet tjetër kuranor, i Lartësuar thotë: “Ka prej tyre që do të bëjnë vërejtjen në ndarjen e lëmoshës, nëse u jepet nga ajo, ata mbesin të kënaqur, e nëse nuk u jepet, ata hidhërohen. E sikur të kënaqeshin me atë që ua dha Allahu dhe i dërguari i Tij, e të thoshin: “Ne na mjafton Allahu, Allahu do të na furnizojë nga të mirat e Tij, e edhe i dërguari i Tij, dhe se vetëm te Allahu

e mbështesim dëshirën (do të ishte shumë më mirë për ta).” (Et-Tevbe, 58-59). Kjo kategori njerëzish, duhet ta kenë të qartë një gjë, se ky mesazh nuk ndërtohet mbi interesa materiale apo dëshira personale, por krejtësisht e kundërta qëndron pasi që për të arritur kënaqësinë e Allahut xh.sh. duhet sakrificë materiale, kohore, fizike e shpirtërore, ashtu siç shprehet Allahu edhe në këtë ajet: “Thuaj: “Namazi im, kurban i im dhe vdekja ime janë thjesht për Allahun, Zotin e botëve. Ai nuk ka shok (nuk adhuroj tjetër). Me këtë (thjeshtësi të adhurimit vetëm për Zotin) jam i urdhëruar dhe jam i pari i myslimanëve (i pari që pranoj dhe bin-dem)!” (El-En'amë, 162-163). Po ashtu duhet treguar kujdes të shtuar se kësaj kategorie njerëzish nuk duhet besuar udhëheqja apo edukimi i gjeneratave të reja. Por ajo që duhet vepruar me ta është fakti se duhet këshilluar me lexim të vazhdueshëm të ajeteve kuranore, historive të të Dërguarit a.s., sahabëve, e njerëzve të mirë, e veçanërisht atyre dëshmorëve që dhanë jetën e tyre për hir të fesë dhe me dëshirën se do të takohen me Të. Nëse pranojnë mirë, e nëse refuzojnë, atëherë sjellja jonë duhet të jetë në nivelin e mirë karshi tyre në mënyrë që mos të përfitohen nga shejtani i mallkuar.

5. Një kategori tjetër e të ftuarve në Islam është e mbyllur në zemër, ka mendime të plagosura e të gabuara, ego të pa frenuar. Këtë kategori duhet të vazhdojmë ta thërrasim dhe t'ua predikojmë Islamin, të ndiejmë keqardhje dhe mëshirë për ta, t'u bëjmë mirë dhe ta lusim Allahun xh.sh., për udhëzimin e tyre në rrugë të drejtë. Nuk ka asnjë pengesë që ne t'u ofrojmë dashuri, vëllazëri me ta, dhe t'u shtrijmë dorën e ndihmës sonë në atë që është e lejuar, duke u nisur nga parimi kuranor: “E në çështjet e jetës së kësaj bote të kesh mirëkuptim ndaj tyre, e ti ndiqe rrugën e atij që është i kthyer kah Unë.” (Lukman, 15).

6. Po ashtu ekziston edhe një kategori tjetër njerëzish të cilët shfaqin të

kundërtën e asaj që fshehin. Nëse kjo ka të bëjë me përgënjeshttrimin e kushteve të besimit (imanit) kjo është kategori e nifakut. Dyfytërshimynafiku, në terminologjinë islame është ai person që në anën e jashtme shpreh diçka tjetër nga ajo që fsheh në zemër. Andaj ai që e fsheh mosbesimin në zemrën e tij konsiderohet mynafik i kulluar dhe se dispozita e sheriatit ndaj tij në botën tjetër është ajo se, ai konsiderohet jobesimtar dhe këtij i shtohet edhe më tepër dënimi për shkak se i ka mashtruar besimtarët me manifestimin e Islamit në mënyrë të rrejshme. E kur ndodh që personi fsheh në vete ndonjë veprim që është gjynah ndaj Allahut, por që nuk ka të bëjë me mosbesimin, atëherë ky person ka një degë-cilësi të hipokrizisë apo më shumë se një degë.⁴

Bazuar në këtë, hipokrizia nuk gjendet aty ku sundon dhe ka pushtet mosbesimi, ngase aty nuk ka frikë për ta shprehur mosbesimin dhe kundërshtimin e fesë islame. Derisa ishin në Meke, myslimanët para emigrimit, nuk kishte hipokritë, por me rastin e ndërtimit të shtetit dhe qytetit të Medinës, kur myslimanët u bënë të fuqishëm e pasi kishin pushtet, e edhe feja islame u përhap në Medinë, atëherë u manifestua fenomeni i hipokrizisë dhe paraqitja e mynafikëve.

Masa nuk është e të njëjtit nivel dijeje dhe feje

Është e padiskutueshme se njerëzit që ftohen, nuk përgjigjen të gjithë njëllë, nuk kuptojnë njëllë, nuk kanë të njëjtin nivel dijeje dhe feje..., andaj t'u ligjërosh të gjithëve njëllë, nuk është aspak e urtë. Qëllon që njerëzit të jetojnë në një kohë të tillë, ku disa ndalesa fetare të jenë përhapur në masë aq të madhe, saqë janë kthyer në zakon dhe ata nuk e dinë se janë të ndaluar, si për shembull çështja e mbulesës së gruas dhe disa

marrëdhënie financiare të ndaluara, të përhapura në shumë vende. Këshillimi i këtyre njerëzve nuk është i njëjtë me ata që e dinë se çka është e ndaluar dhe janë të vetëdijshëm kur bien në veprime të ndaluara fetarisht. Historia tregon se Muhamedi a.s., u drejtohej të gjitha shtresave të njerëzve sipas nivelit të besimit, dijes, pranimi dhe sipas mundësisë së tyre. Mjafton të përmendim si argument fjalën e Allahut xh.sh., “Allahu nuk e ngarkon askënd përtej fuqisë që ka.” (El-Bekare, 286).

Te fuqia futet ajo mendore, trupore, materiale etj.. Profeti ynë, por edhe profetët e tjerë a.s. para tij ishin të kujdesshëm ndaj gjendjes së njerëzve dhe i trajtonin ata me urtësi dhe me metoda efikase.⁵

Kultivoni mirësjelljen

Mbi të gjitha, nëse dëshironi të keni një karakter magnetik e tërheqës, atëherë kultivoni shprehinë e të qenit të sjellshëm, e të takuarit të gjendjes me një përshëndetje të ngrohtë e të çiltër, me zemër të hapur, kështu do të bëni mrekulli. Pastaj, do ta shikoni se ngurtësia, mosbesimi dhe moskokëçarja, mungesa e interesit lidhur me gjithkënd, që tani ju turbullojnë kaq shumë, do të zhduken krejt. Njerëzit do ta shohin se ju ushqeni vërtet interes për ta dhe se vërtet doni t'i njihni, t'i kënaqni dhe

t'i grishni. Praktika e të qenit të sjellshëm ka për ta revolucionarizuar fuqinë tuaj shpirtërore. Do të zhvilloni cilësi tërheqëse që nuk i keni ende. Ndonjëherë se do t'i zotëronit. Nëse doni të jeni popullorë, atëherë nevojitet të kultivoni mirësjelljen. Nevojitet t'i hapni dyert e zemrës tuaj dhe jo siç bëjnë shumë njerëz që i lënë veç paksa të hapura, sikur të donit t'u thoshin njerëzve që takojnë: “Mund të përvidheni pakëz, por nuk mund të hyni gjersa të jem i bindur se jeni të dobishëm.”⁶

Sikur edhe në të kaluarën, edhe sot detyrë urgjente është urdhërimi për në punë të mira, ndalimi nga gjërat e shëmtuara. Posaçërisht në një kohë kur është duke vluar situata nga të shëmtuarat, nga sherri, turbullirat dhe djallëzitë, duhet të kthehemi te përgjegjësitë tona shoqërore, duke mos e kufizuar veten me adhurime individuale, duke e realizuar këtë urdhër, duhet krijuar hapësirë të mirës, të bukurës dhe të drejtës. Për të pasur një shoqëri (xhemat) që do të jetë garanci e njerëzimit, është nevojë e synimit tonë. Në të kundërtën si do ta gjej njeriu Zotin e tij dhe si do ta përcaktojë orientimin e vet?⁷

Myslimanët, siç shprehet Ridzuan Abdullah Vu, kanë tendencë të lundrojnë në nostalgji prapa në kohë, në ditët e Pejgamberit a.s., kur shoqëria islame u themelua në qytetin e

Medinës. Myslimanët i referohen kësaj si një model i shoqërisë mysli mane, në njëfarë mënyre kjo është fatkeqësi, ngase nuk ekziston një model bashkëkohor i cili do të mund të merrej si shembull. Por, në anën tjetër, modeli historik dëshmon se modeli i shoqërisë islame është i mundur. Ka ndodhur në jetën e Islamit. Nuk është sikurse në konceptin marksist të një shoqërie komuniste; pas tezës dhe anti-tezës, sintezës, përfundimisht evoluon në një shoqëri komuniste, porse ky proces asnjëherë nuk është përmbushur në histori. Por, në rastin e Islamit, ishte një model i shoqërisë islame që njerëzit mund t'i referohen dhe të pohojnë: “Kjo është një shoqëri drejtë së cilës do të dëshironim të ecnim. Jo në terma të teknologjisë, por në terma të vlerave të njerëzve, në mendësinë psikologjike të njerëzve, në etnosin e njerëzve.”⁸

Pra, në këtë kuadër të shkallëzimit në misionin e daves është me rëndësi që përparësi t'i jepet formimit, ngritjes së të rinjve që të kenë një personalitet islamë që lufton drejt synimeve madhore të Islamit. Nevojë themelore është ndërtimi i besimtarit, para ndërtimit të xhamive, edukimi i besimtarit në mendjen, shpirtin e tij dhe në trupin e tij, para interesimit për ndërtimin me gurë dhe ngritjen e kupolave, sepse ai që i shërben punës kolektive është besimtari që ka



njohuri, që është i ndërgjegjshëm. Nga këtu del në pah rëndësia e përqendrimit të kualifikimi i elementit njerëzor, ndërtimi i shpirtave dhe mendjeve njerëzore, dhe realizimi i përsosmërisë në ndërtimin e personalitetit besimtar. Është e domosdoshme që aktiviteti i thirrjes islame të dalë nga brenda mureve të sallave të mësimi dhe të adhurimit, dhe energjitë e tij të çlirohen në ajër të pastër, në ndonjë dobi të madhe. Gjithashtu, ky aktivitet duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe të ndërveprojë me të gjithë, nëpërmjet të cilit besim-tarët të rendin drejt mbushjes së boshllëqeve, të kompensojnë mangësitë, ta largojnë dëmin dhe përfitimi të bëhet i lehtë dhe i qasshëm. Roli i vërtetë konstruktiv dhe produktiv i xhamive është të aktivizojë rolin e tyre në shoqëri, jo në arkitekturën e tyre materiale.⁹

Kjo çështje e shkallës dhe mënyrës së përngjitjes së myslimanëve ndaj Islamit është në vetvete vendimtare në diskutimin e rolit të Islamit. Para kohës moderne, shkalla e depërtimit të Islamit brenda një rajoni ose grupi etnik të caktuar varej kryesisht nga kohëzgjatja e procesit të islamizimit. Për shembull, një pjesë të Indonezisë apo Afrikës së Zezë, ku Islami kishte vetëm një ose dy shekuj që kishte depërtuar, procesi i islamizimit nuk kishte qenë i plotë sa në zona të tjera ku ai kishte nisur të themi, katër

Një shumicë myslimanësh nuk lënë namaz pa falur dhe jetojnë sa munden sipas Sheriatit, disa nga të cilët për më tepër e konsiderojnë mënyrën e tyre të ndjekjes së Islamit si të vetmen.

shekuj më parë, pa përmendur njëmijë vjet më herët. Një pjesë të botës islame, ku Islami kishte pasur kohë të lëshonte rrënjë dhe të ngrinte institucionet e tij, përngjijtja e myslimanëve ndaj praktikave islame kishte intensitet të tillë sa të mos ishte e lehtë të thuhej nëse, për shembull, egjiptianët, sirianët, persët ose punxhabitë ishin më fortë të lidhur me Islamin, ndonëse disa bashkësi theksonin aspektet formale.

Dallimet ekzistojnë vetëm në çështje si qëndrimet e përzotshme, theksi mbi forma dytësore të adhurimit, spekulimet teologjike, shprehje të artit sakral e kështu me radhë, të cilat shpesh demonstrojnë larmi lokale të ardhur nga dallime në gjuhë, etni ose kulturë mes kolektivave islame të ndryshme. Në të njëjtën kohë, dallime të tilla pasqyrojnë elementet pozitive të gjeniut etnik të grupeve të ndryshme, të cilat Islami nuk i shkatërroi, por i lejoi të lulëzonin brenda matricës së universit islam. Mirëpo, në kohën moderne forca si nacionalizmi i stilit perëndimor, ringjallja e tribalizmit dhe e afrive gjuhësore, dhe mënyrat e larmishme në të cilat pjesë të ndryshme të botës islame e kanë përjetuar botën moderne duke hasur forca si kolonializmi, nacionalizmi sekular, racizimi e humanizmi sekular perëndimor, kanë shkaktuar larmi domethënëse në mënyrën dhe shkallën e përngjitjes së shumë myslimanëve ndaj Islamit.

Një shumicë myslimanësh nuk lënë namaz pa falur dhe jetojnë sa munden sipas Sheriatit, disa nga të cilët për më tepër e konsiderojnë mënyrën e tyre të ndjekjes së Islamit si të vetmen. Por, ndryshe nga dikur, ka edhe të tjerë, që nuk i ndjekin të gjitha porositë e Sheriatit apo falen rregullisht, porse prapë e konsiderojnë veten patjetër myslimanë. Ka të tjerë akoma, të cilët nuk bëjnë asgjë specifike islame pos ndjekjes së njëfarë etike "humaniste" islame, por prapë e quajnë veten myslimanë dhe do të protestonin po të thërriteshin ndryshe. Ekziston edhe një grup, i cili i kryen ritet islame përpikërisht, porse i shkel shumë nga porositë morale të Sheriatit (përfshirë, për shembull, ndershmërinë në tregti), duke pohuar ndërkaq të jetë i devotshëm.¹⁰

Rezime

Këto kategori njerëzish me të cilat duhet ballafaquar në misionin e predikimit të thirrjes islame (dave), si dhe tipat e ndikimit në individët duhet vepruar me shumë maturi e urtësi e pa nxitim, dhe duhet t'i kuptojmë mbi dritën e shpjegimit të burimeve islame. Po ashtu thirrësi me maturinë dhe gjeturinë e tij duhet të zhvillojë frymën e komunikimit me ta, e mos t'i kaloj kufijtë e caktuar, por duhet të veprojë me metodat dhe mjetet që janë më të lehta për ta penguar dëmin prej tyre, duke pasur synimin për t'i udhëzuar dhe për t'i përmirësuar ata.

1 Adnan al-Araur, *Menhexhu eddaveti fi dav'il kitab ve essune, pa vit botimi*, f. 90. 2 Imam Hafidh ibil Fida Ismail ibën Kethir el-Kureshi *Ed-dimeshki, Essiretu en-nebevijje, nën recensimin e Mustafa Abulvahid, Daru'l Marije, Bejrut, 1976, 1/434, f. 120. 3 Teyfik el-Vai, Ed-da'vetu ilallah, Darul Jekin, Mensure, Egjipt, botim i dytë, 1995, f.256. 4 Abdulkrim Zejdani, Usulu Edda'Ve, Muesesetu errisale, botimi IX, Bejrut, 1999, f. 483. 5 Adnan al-Araur, *Menhexhu eddaveti fi dav'il kitab ve essune, pa vit botimi*, f. 92. 6 Dale Carnegie, *Si të krijojmë marrëdhënie të dobishme dhe të fitojmë besimin e njerëzve*, Pema, f. 15. 7 Ramazan Kayan, *Thirrja islam akt profetik, Fleta, Prizren, 2017, f. 39. 8 Ziauddin Sardar, Fytyra e Islamit, Logos-A, Shkup, 2017, f. 154-156. 9 Ahmet Tutunxhi, *Mësime nga jeta ime, Logos-A, Shkup, 2020, f. 59-60. 10 Sejjid Husein Nasr, Islami në botën moderne, Shkup, Logos-A, 2019, f. 48-49.***



Haki Sahitaj

Sfida për t'i kuptuar sfidat e myslimanëve


Një lexim i veprës së Nexhat Ibrahimit*

Për Islamin dhe myslimanët është folur për katërmbëdhjetë shekuj. Por ajo që është thënë gjatë dy shekujve të fundit është një qasje e ndryshme nga ajo që është thënë dhe menduar më parë. Kjo sepse periudha koloniale që përjetuan myslimanët shkaktoi lëkundje duke filluar nga pikëpamjet e besimit, moralit, mënyrës së të menduarit, arsimit, industrisë, zakoneve, traditave, e cila më në fund arriti kulmin e saj me një poshtërim politiko-ushtarak në shek. XIX.¹ Dukej se diçka kishte shkuar keq me botën², kështu që u bë e qartë se mënyrat tona të perceptimit të historisë, fesë dhe botës në përgjithësi duhej të rishikoheshin.³ Prandaj, nga kjo kohë e tutje, shumë figura dhe lëvizje filluan të shfaqeshin në skenë që kërkonin ixhtihad të ri dhe reforma në shkallë të gjerë. Shekulli i njëzetë solli gjithashtu sfida të njëpasnjëshme që ndryshuan si Lindjen ashtu edhe Perëndimin. Por problemet që ndodhën në botë, kryesisht pas përfundimit të Luftës së Ftohtë deri më sot, janë të lidhura ngushtë me elementët islame.⁴ Ngjarjet terroriste në emër të fesë, luftërat e vazhdueshme në Lindjen e Mesme e kanë bërë fillimin e shekullit XXI një kohë të vështirë për botën islame. Bota islame sot po përballet me sfida nga brenda dhe nga bota e gjerë përreth saj. Por problemet kritike janë tensionet themelore brenda myslimanëve. Qëndrimet dhe kritikën e përbashkëta në botën e jashtme mund të injorohen si të gabuara ose armiqësore, por tensionet brenda myslimanëve në të gjithë botën duhet të ballafaqohen.

Sfidat ndaj myslimanëve në shek. XXI

Deri më tani nuk mund të gjeja një fillim më të mirë dhe ndoshta një arsye më të qartë pse duhet të fillonte një diskutim tjetër, një artikull tjetër ose analizë në lidhje me problemet e myslimanëve, sesa ai i shprehur nga Ali Sheriati se: “Viteve të fundit, shumica e intelektualëve kanë filluar të mendojnë se nuk ka kurrfarë dobie nga përmendja e halleve dhe nga diskutimi. Deri më tani pa bërë asgjë, pa ndërmarrë asnjë aksion, vazhdimisht kemi folur dhe diskutuar për hallet dhe brengat tona. Për këtë arsye duhet ta lëmë më të folurit. Gjithsecili duhet t’ia fillojë punën për të përmirësuar familjen, ambientin dhe vendin ku jeton. Qëndrimi im është se këto mendime bazohen në supozime të gabuara. Sepse me të vërtetë deri më tani nuk kemi folur shumë, nuk kemi diskutuar për hallet tona dhe asnjëherë nuk i kemi shikuar nga aspekti shkencor. E tërë ajo që e kemi bërë deri më tani nuk ka qenë asgjë tjetër përpos ankimi dhe rënimit dhe qartë dihej se askush nuk do të ketë dobi nga një gjë e tillë. Problemet sociale dhe psikologjike nuk i kemi diskutuar deri më tani ashtu si duhet.”⁵

Krahas shumë intelektualëve, akademike, instituteve të cilat flasin në emër të Islamit dhe myslimanëve, edhe te ne ndihen zëra të cilët bëjnë thirrje për të reflektuar për natyrën e sfidave në shek. XXI. Nexhat Ibra-



himi është një nga figurat më të shquara ndër ne sa i përket këtyre çështjeve. Në përgjithësi, punimet e tij gjithmonë përqendrohen në këto aspekte, dhe puna e tij e fundit “Sfidat ndaj myslimanëve në fillim të shekullit XXI” e bëri këtë aktivitet më të plotë. Aq komplekse është koha jonë sa pak kush mund të shpreh me bindje të plotë se tashmë kemi një rrugë të qartë se si duhet të sillemi dhe përgjigjemi kohës tonë.⁶ Prandaj, kjo vepër e botuar së fundmi është më shumë një përpjekje ose një thirrje për meditim, analizë, autokritikë të marrëdhënies sonë me fenë, historinë dhe asaj çfarë na ofron kultura aktuale.

Bazuar në titull, libri i Nexhat Ibrahimit zbulon disa nga sfidat që vazhdojnë të jenë të rëndësishme edhe sot. Siç shkruan edhe vetë Ibrahim në fjalën hyrëse se shek. XXI pritej të ishte një shekull i paqes botërore, por që këto parashikime

nuk dolën të jenë kështu edhe për botën myslimane (fq. 7). Edhe pse i referohet shek. XXI nga përmbajtja e librit mund të shohim se për aq sa kemi sfida të reja shumë prej tyre në fakt janë nga e kaluara e largët. Imazhi i deformuar që të krishterët e hershëm patën karshi Islamit dhe myslimanëve dhe më vonë institucionalizimi i këtyre paragjytimeve me anë të studimeve orientale dhe shumë shkencave që u zhvilluan në Perëndim si etnologjia, antropologjia dhe biologjia që ngritën këto paragjytime në nivel të së vërtetave shkencore, me çka legjitimohej e drejta e kolonializmit të popujve myslimanë dhe të tjerë.⁷ Ibrahim i përshkruan kështu këtë situatë: “Myslimanët po kalojnë një etapë të vështirë të ekzistencës së tyre, madje të mbijetesës së tyre biologjike, kulturore, fetare e të tjera. Qeveritë në euro-perëndim ndërroheshin, herë të majtët herë të djathtë, por politika e jashtme ndaj myslimanëve mbeti paragjyquese, tendencioze, vrasëse (fq. 7).”

Përkundër fakteve që Ibrahim i sjell në lidhje me mënyrën se si myslimanët propagandohen, përdoren dhe shantazhohen nga politika e jashtme dhe e brendshme, ai përsëri fillon librin e tij të sfidave duke folur për natyrën e fesë Islame. Ai na lë një mesazh se pavarësisht nga rrethanat, sfida jonë e parë fillon me kuptimin tonë të rrugës, besimit dhe filozofisë sonë, në emër të së cilës ne flasim dhe veprojmë, përkatësisht Islamit. Tre kapitujt e parë (fq. 11-40) flasin pikërisht për natyrën, kuptimin dhe nevojën që bartë njeriu brenda vetës për të kuptuarit e realitetit dhe ekzistencës sonë në këtë botë. Ndërsa katër kapitujt pasues (fq. 43-74) tregojnë për katër rezultate negative – dhuna, individualizmi, besëtytnitë, padija dhe konflikte ndër mysliman – se çfarë ndodh kur nuk arrijmë ta kuptojmë natyrën e vërtetë të fesë dhe urtësive që mësimet Hyjnore na shpalosin. Me një gjuhë ofensive në një poshtë shënim shprehet kështu:

“Shpesh akuzojmë të tjerët që nuk shkruajnë mirë dhe objektivist për



Islamit. Shqetësimi ynë është i drejtë, sepse gjendja në terren tregon se flasim të vërtetën. Por, shpesh ndodh të mos kemi të drejtë edhe ne ‘engjëjt’, punëtorët fetarë, me laps në dorë, sepse shkruajmë keq, mbrapsht, zyrtarë, me shumë sens për të panevojshmen, jokohorentë me kohën dhe hapësirën, jokohorentë me palën së cilës i drejtohem. Po t’i dëgjojmë televizionet dhe ta lexojmë literaturën autoriale apo të përkthyer te ne, do të bindemi që një pjesë e teologëve islamë shkollohen për shekujt 7-15 e jo për shekujt 21 e tutje. Preokupimi për tema tashmë të bluara, mbizotërimi i folklorizmit në ibadete, aktivitete, ligjëratë, programe, selfija si trend maniakizmi, pastaj materializimi i tmerrshëm i punës profesionale, gjuha tejet jo përkatëse në komunikim me masën, ngatërimi me politikën ditore, paafërsia profesionale dhe mos përgatitja e nevojshme, mungesa e identitetit mysliman dhe manifestimi i disa identiteteve ‘bogdanië’, vrapim pas titujve shkencorë dhe theksimi i tyre (në çdo) vend e pavend, përdorimi i frazave fetare në çdo cep të ecejakeve tona, na bën të na ‘gudulisë’ lukthi sepse nuk përpunon çdo gjë që ia hedhim, por kërkon vetëm ushqim të shëndetshëm (fq. 11).”

Kur flasim për interpretim dhe kuptim të drejtë të fesë kjo ka qenë një sfidë që pas vdekjes së Muhamedit a.s e deri më sot. Individë dhe grupe

të caktuara kanë dalë që në periudhat e para ku mundoheshin të paraqisnin një të kuptuar sa më të drejtë, por krahas tyre kemi dhe shumë të tjerë që për synim kanë pasur të kundërtën (fq. 18).⁸ Pavarësisht kësaj, Nexhat Ibrahim shkruan se nuk guxojmë të mbyllemi, nuk guxojmë të ndërtojmë zonë komforti, dhe se duhet përpjekje për ripërtëritje, ndaj dhe na kujton se “ngecja është vdekje për së gjalli, kurse lëvizja është transformim i fizikës dhe shpirtërores (fq. 21)”. Kjo lëvizje apo ndryshim nuk është një modifikim i burimeve, por një transformim i mendjes dhe syve që i lexojnë ato, të cilat me të vërtetë ndikohen natyrshëm nga mjedisi i ri shoqëror, politik dhe shkencor në të cilin jetojmë.⁹

Natyrë e pushteteve politike historikisht ndikon dhe luan rol në formatin dhe drejtimin e ripërtëritjes myslimane. Andaj edhe sot është e vështirë të mendosh për ripërtëritje e të mos kesh parasysh natyrën e politikës dhe pushteteve në botën islame. Pas disa shqyrtimeve që jep Ibrahim për atë që sot njihet si Islami Politik, ai në fund e përmbyll duke thënë se për dallim nga e kaluara, ulematë po heshtin në mashtrimet, shfrytëzimet dhe korrupsionin e elitave politike. Madje shkruan se fatkeqësitë koloniale, ndër shkaqet e tyre ka qenë edhe heshtja e ulemave. Interpretimi dhe ndarja e fesë në sfera si individuale dhe shoqërore, apo klasifikimet si fetare dhe jofetare kanë çuar në një shkëputje dhe interesim për të qenë aktiv dhe reformuar padrejtësitë sociale. Paradoksi i gjithë kësaj është se edhe pse në interpretime duken se i kanë ndarë, elitat e ulemave në shumë vende janë aq afër pushteteve sa që nga larg duket gjoja si një “strategji” (fq. 40).¹⁰

Thellë-thellë, çdo krizë nuk është thjesht politike, ekonomike ose sociale. Kriza në parim është një krizë e identitetit, vlerës ose botëkuptimit. Megjithatë Islami na mëson për vetë-llogaridhënien së pari me veten tonë dhe pastaj na bën thirrje për të ndryshuar të

Islami i mëson njeriut identitetin e tij dhe kuptimin që merr që para formimit e deri edhe pas varrit.

këqijat që hasim sa më shumë që të mundemi, kjo do të thotë se nuk ka thjesht një person apo institucion të vetëm përgjegjës për këtë gjendje. Sidoqoftë, kjo nuk na ka penguar të organizohemi, të vendosim dikë në krye që të na mësojë, të na drejtojë dhe të jemi në gjendje të ecim drejt së mirës më të madhe se vetja. Kësisoj ne kemi mbështetur dhe vazhdojmë të mbështesim institucionin e Bashkësisë Islame me tërë anatominë e saj, si fakulteti, medresetë, xhamitë, vakëfet etj. Ne mund të vazhdojmë të flasim e shkruajmë për shumë e shumë sfida, por ajo që e sfidon njeriun në nivel individual është identifikimi i duhur i përgjegjësisë dhe aktivitetit që duhet ndërmarr. Kësisoj, institucionet fetare kanë një përparësi dhe mundësi për të qenë alternativa më e mirë për të filluar një ndryshim afatgjatë, jo emocional, në përputhje me kohën dhe hapësirën. Me një fjalë, institucionet ku marrin pjesë njerëz me formime të ndryshme, me mundësi hulumtimi e studimi, mund që dalëngadalë të riformulojnë vlerat dhe identitetin e myslimanit të sotëm. Edhe Nexhat Ibrahimit e adreson këtë çështje pikërisht në nivel institucional (fq. 5-54). Por këto qendra tradicionale, të cilat kanë përcaktuar rrjedhën e mendimit gjeo-politik ose fetar në të gjithë botën islame, po humbin ngadalë ndikimin e tyre si në ymet ashtu edhe në nivelin lokal. Për shkak të fuqisë së tyre ekonomike ose respektit dhe vlerës historike, këto qendra tradicionale po shkelin shumë nga parimet e fesë për të cilat qëndrojnë. Qendrat politike thjesht

shohin që interesat ekonomike dhe investimet janë përqendruar tërësisht në mjete ushtarake ose në ekonominë jashtë botës myslimane. Ndërkohë, qendrat tradicionale të dijes kanë marginalizuar shumë qasje, shumë intelektualë, kanë copëtuar traditën e mendimit dhe nuk zbatojnë pothuajse asnjë nga parimet themelore siç janë konsultimi, afërsia me traditat e tjera etj. Zbehja e ndikimit të tyre që sipas disa analizave¹¹ shumë shpejtë do të pësojë zhvendosje, do të shkaktojë tensione të reja.

Nëse një popull me një histori dhe kulturë të ngjyer në botëkuptimin islam nuk arrin t'i perceptojë dhe mbrojë këto vlera, ku sot shumë popujt të botës përpiqen të zbulojnë vlerat dhe vetën e tyre, duke mos iu nënshtruar besimeve e shijeve koloniale, atëherë ne hiç nuk jemi me më pak vlera dhe histori, aq sa të marrim çdo që na servohet (shih fq. 131-38 si dhe 213-219). Madje pa një identitet të qartë ne do ta kemi të pamundur të dallojmë miq e armiq, siç ndodh në rastin e Perandorisë Osmane (fq. 147-60). Po aq sa nuk do ta kemi të mundur të zbulojmë vlerat, mendimin, poezinë, artin dhe muzikën në nivel global, si në rastin që Ibrahimit na ka prezantuar me poezinë e Pushkinin e cila ishte frymëzuar nga Kurani, apo veprat madhore të Viktor Hygos. Apo edhe muzikën Gnava të Afrikës Veriore, një muzikë dhe vallëzim ritual e shoqëruar me fjalë e cila synonte të shprehte gjenezën e universit. Veshmbathja e valltarëve e ndihmon mozaikun e vallëzimit estetik, duke lidhur kontributet kulturore të Afrikës si hapësirë gjeografike dhe islamit si fe monoteiste në një njësi specifike dhe harmonike (fq. 211). Islami i mëson njeriut identitetin e tij dhe kuptimin që merr që para formimit e deri edhe pas varrit. E thërret të njoh të vërtetën e para krijimit, të krijimit, të historisë dhe të realitetit pas saj. Të gjitha këto janë manifestime të fuqisë, vullnetit dhe urtësisë së Allahut ndaj dhe njohja me to ka bërë që myslimanët e parë të ishin kërkues, dinamik e kurioz për të kuptuar çdo hapësirë ku mund të

arrinin kapacitetet tona intelektuale e imagjinare. Nëse nuk kemi vullnet për ta bërë këtë, atëherë ne jemi duke u tretur dhe do të zhdukemi në valët e globalizmit (fq. 55). Pafuqia dhe ngecja për ta përmbushur këtë mision do t'ju jap akoma më tepër mundësi mediave për të keqinterpretuar imazhin e fesë dhe prezencën e myslimanëve dhe islamofobia do ushqehet edhe më tej (fq. 115).

Të gjitha këto sfida kanë dimensione të tjera, madje mund të thuhet se secila tashmë është bërë çështje në vete. Por duhet një përpjekje për të dalluar se çfarë është shkak e çfarë pasojë. Izetbegoviqi shumë mirë do ta shprehte këtë teksa përpiket të kuptonte sekretin e rënies së popujve; se është thuar se pamundur të nxirren të gjithat shkaqet objektive të rënies apo ngritjes. Kjo pasi që analizat jo gjithmonë arrijnë të kapin disa të fshehta që gjenden në vullnetin dhe zemrat e njerëzve.¹² Por, në syrin e Nexhat Ibrahimit kjo çështje merr një përkufizim në një kuadër më të qartë, duke përcaktuar qartë qëllimin, mjetet dhe rezultatin që mund të presim: "Platforma e ringjalljes duhet të përfshijë botën islame dhe specifikat e saj. Ringjallja dhe ndryshimi nuk bëhet me injorancë dhe emocione, as me intelektualizëm pa Zot, as me shpirtëroret pa racionalizëm. Thjesht, dëshirën dhe zjarrin për ndryshim e gjejmë në shumë vende myslimane, kemi xhemat, kemi dëshirë fetare, kemi vullnet emocional, por këtu mungon përmbajtja intelektuale. Atëherë kur do t'i bashkojmë këto tri komponentë, mund të ndërtojmë institucione ekonomike, politike dhe kulturore (fq. 144)."

Përfundim

Kjo përmbledhje e disa ideve të Nexhat Ibrahimit të shprehur në veprën e tij ishte një përpjekje për të prezantuar disa nga sfidat sa të vjetra po aq edhe aktuale me të cilat vazhdon të rrethohet bota islame anekënd globit. Kjo vepër nuk mbulon tërë sfidat, por diskuton për disa që janë prezentë dhe të

dhimbshme në çdo aspekt. Disa prej të cilave janë specifike për myslimanët e Ballkanit, qoftë në nivel individual apo shoqëror. Ne më tepër e shohim këtë vepër, apo më mirë me thënë veprimtarinë e Nexhat Ibrahimit si koncept se si duhet qasur sfidave dhe rilindjes në kushtet e sotme. Duke besuar edhe në atë që ka thënë Suhreverdi se urtarët dhe urtësia nuk janë vetëm e atyre në të kaluarën, por ajo do ekzistojë për sa kohë do rrojnë toka e qielli.¹³ Zoti nuk i ka mbyllur rrugët e suksesit, urtësisë dhe vullnetit asnjëherë, thjesht na mbetet të shohim, të mësojmë dhe të përdorim vullnetin për ta realizuar të vërtetën kudo. Si një vepër e cila na “shëtit” sa në dimensionet metakozmike (ku na flet për Zotin), makrokozme (ku na shpalos gjendjen e natyrës së universit dhe nevojës për të arritur paqe me të), e më pas zbret në botën mikrokozme të njeriut (në botën komplekse mes vullnetit, moralit, dijës dhe politikës së përditshme)¹⁴, kjo vepër mbetet një thirrje për të ripërcaktuar kriterin hyjnor në jetën tonë të mendimit dhe veprimit dhe në anën tjetër të ripërcaktohen kushtet apo gjendjet në të cilën myslimanët kanë rënë tani për tani. Kjo është e mundur vetëm nëse arrihet një integritet dhe lexim më i qartë midis normave hyjnore, suksesit historik dhe duke ripërcaktuar gjendjen aktuale të botës islame, psikologjinë dhe idealet e saj, pa lënë pas dore kushtet që e kanë shkaktuar këtë gjendje, siç është botëkuptimi perëndimor dhe manifestimet e tij politike, ekonomike dhe kulturore.

Krejt në fund mund të themi se veprimtaria dhe personaliteti i Nexhat Ibrahimit mund të përcaktohen në kategorinë e atyre intelektualëve myslimanë, që Fazlur Rrahman do t'i përkufizonte si koka të klasit: “të parë që mund të interpretojnë të vjetrën në terma të së resë në lidhje me përmbajtjen dhe ta kthejnë të renë në shërbim të së vjetrës në lidhje me idealet”¹⁵, për të cilët Islami sot ka kaq shumë nevojë.

*Nexhat Ibrahimit, *Sfidat ndaj myslimanëve në fillim të shekullit XXI*, ALSAR, Tiranë, 2020 234 faqe.

1. Shiko studimin e S.V.R. Nasr, *European Colonialism and the Emergence of Modern Muslim States* në librin *The Oxford History of Islam*, (ed) John L. Esposito, Oxford University Press, New York, 1999, fq. 551. Një studim i cili i shikon sfidat e tanishme nga ndikimet koloniale që kanë mbizotëruar edhe pas “pavarësimi” politik dhe ushtarak të vendeve myslimane. 2. Shprehje të cilën e përdorë Husein Nasr për interpretimet mesianike rreth gjendjes së myslimanëve. Shiko Sejjid Husein Nasr, *Islami në botën moderne / I sfiduar nga Perëndimi*, i kërcënuar nga fundamentalizmi, besnik ndaj traditës, Logos-A, Shkup, 2019, fq. 54 e tutje. 3. Mahmoud M. Ayoub, *Islam/Faith and History*, Oneworld, Oxford, 2004, fq. 200-1. 4. Për një prezantim më të plotë se si Islami dhe myslimanët në kohën bashkëkohore janë portretizuar si të lig dhe kërcënues nga Perëndimi shikoni librin e Akbar S. Ahmed, *Islam Today: A short Introduction to the Muslim World*, I.B. Tauris, London, Ribotuar me material shtesë në 2002 nga I.B.Tauris & Co Ltd. 5. Dr. Ali Sheriati, *Sociologjia Islame*, fq. 17. Libri në formatin elektronik PDF në www.dielli.net. 6. Madje është e dhimbshme të thuhet se ndonjëherë shumë alternativa dhe interpretime janë kundër njëra tjetrës, disa prej të cilave edhe kundër vetës natyrës së fesë. Për një pasqyrë më të gjerë rreth këtyre ideve dhe platformave që janë dhënë nga intelektualët dhe dijetarët myslimanë anekënd globit mund t'i referoheni veprës *Reformist Voices of Islam: Mediating Islam and Modernity*, (ed) Shireen T. Hunter, M.E. Sharpe, New York, 2009. 7. Ibrahim Kalin, *Barbarë, Modernë, Të Qytetëruar*, Logos-A, Shkup, 2020, fq. 42-45; 117. 8. Francis Robinson e ka analizuar mjaft mirë këtë pikë, aq sa leksionin e tij e ka titulluar në formën pyetëse se mos vallë kriza e autoritetit është vetë kriza e shteteve islamit. Shiko Francis Robinson, *Crisis of Authority: Crisis of Islam?*, JRAS, Series 3, 19, 3 (2009), fq. 339-354. Po ashtu një libër i cili na sjell analiza të zgjeruara sa i përket autoritetit se kush duhet ta interpretojë Islamin mund t'i referoheni edhe librit *Speaking for Islam* të edituar nga Gudrun Krämer dhe Sabine Schmidtke. Siç tregojnë dhe punimet e ndryshme aty se nga periudhat më të hershme autoriteti ka qenë sfidë e cila nuk ka njohur asnjëherë një individ të vetëm, por natyra bashkëkohore e autoritetit ka elemente të reja të cilat nuk i gjen në të kaluarën: E para është se interpretimet e ndryshme në të kaluarën kanë qenë përpjekje për të ofruar mësim dhe interpretime sa më afër të vërtetës. Shprehja e përdorur kaherë nga ulematë “wa'll-llahu a'lem- Zoti e di më mirë” tregon këtë qasje. Ndërsa në kohën tonë interpretimet nuk janë tanimë vetëm perspektiva, por përpjekje për të fituar një autoritet dhe legjitimitet për të fituar të drejtën ekskluzive për interpretim, duke mohuar të tjerët. Mundësitë teknologjike thuajse kanë marginalizuar çdo autoritet dhe kriter “klasik”. Sfidat e dytë se tashmë në këtë betejë nuk janë vetëm ata që e pandehin vetën myslimanë, por tashmë kemi edhe autoritetet laike siç janë parlamentet dhe gjykatat e larta kushtetuese të shtatë me avokatë sekularë të cilat ndërhyjnë në interpretime. Për më tepër shih në *Speaking For Islam/ Religious Authorities in Muslim Societies*. (ed. Gudrun Krämer dhe Sabine Schmidtke), Brill

NV, LEIDEN • BOSTON, 2006, fq. 12-13 e tutje. 9. Tariq Ramadan, *Western Muslims and the Future of Islam*, Oxford University Press, New York, 2004, fq. 38. 10. Abdu'l Hamid Sulejman e ka analizuar rolin e ulemasë me pushtetin dhe tregon se si despotizmi politik ka një raport të drejtë me atë intelektual të shoqëritë myslimane. Kur ulematë largohen nga çështje që lidhen me shoqërinë, atëherë shteren burimet intelektuale të udhëheqjes shoqërore e politike. Udhëheqja e tillë filloi të pajiset me paafësi intelektuale dhe me injorancë politike. E gjithë kjo e detyroi ymetin që të mbyllet në kafazin e imitimit dhe të stagnimit intelektual, ngaqë më dijetarët nuk frymëzoheshin nga burime praktike shoqërore e politike në njërën anë, e në anën tjetër populli ra në kthetrat e tiranisë, shkatërrimit dhe dekadencës politike e shoqërore. Shih për më tepër A. Ebu Sulejman, Kriza e të menduarit mysliman, Logos A, Shkup, 2012, fq. 43 e tutje. 11. Për shembull, ne kemi rastin e Arabisë Saudite, e cila mbetet ende si një qendër fetare me dy vende të shenjta, por edhe si një qendër e ndikimit politik. Megjithatë, politikat e saj janë të përqendruara plotësisht në interesat mbretërore për shkak të fuqisë ekonomike. Ajo ndjek një qasje thuajse kundër vendeve të tjera në Lindjen e Mesme që i sheh si rivalë politik, ideologjik dhe ekonomik. Investimet e saj janë përqendruar pothuajse tërësisht në teknologjinë ushtarake. Rasti i El-Azhar është një shembull i një qendre tradicionale të mendimit dhe mësimi islam qasjet e së cilës kanë ndikim anë e mbanë botës islame. Por siç mund ta shohim nga analiza e dr. I. Bruce Watson se fuqia relative e qendrave të ndryshme po zhvendoset. Me kalimin e kohës pretendimet mbi dhe kundër zemrës nga dhe nga komunitetet periferike myslimane do të përkëqësojnë tensionet ekzistuese. Qendra konservatore do të jetë nën një presion më të madh nga shoqëritë myslimane më të fuqishme, pjellore dhe liberale që tani për tani mund të konsiderohen si vende periferike. Shih Dr. I. Bruce Watson, *Islam and its challenges in the modern world*, Insight, vëll. 12, issue 1 May 1997, nr. 33, në <https://www.iium.edu.my/deed/articles/challenge.html>. Kjo zhvendosje po ndihet edhe në nivel lokal te ne, ku qendrat tradicionale të organizimit fetare po humbin ndikimin e tyre për shkak të qëndrimeve të tyre të ngushta, dhe përjashtimin e atyre që janë kritikë ndaj tyre. Disa nga pikat më karakteristike të pakënaqësisë të shprehura nga komuniteti i gjerë ndaj elitës fetare mund të lexohen në trajtesën e Nexhat Ibrahimit “Imami dhe Xhemati”, Logos-A, Shkup, 2005. 12. “Shkaqet e ngritjes dhe të shkatërrimit të një populli vazhdimisht janë të komplikuar dhe të shumëfishta. Vetëm një pjesë e këtyre shkaqeve janë objektive, dhe si të tilla janë të arritshme për analizë dhe për t'u mësuar, pjesa tjetër janë të pakapshme dhe shkaqe të pashpjegueshme, sepse ndodhet në zemrat dhe vullnetin e njerëzve.” Alija Ietbegović, *Vepra 2*, Logos A, Shkup, 2013, fq. 317. 13. Cituar nga Ibrahim Kalin në *Barbarë, Modernë, Të Qytetëruar*, po aty, fq. 259. 14. Kjo ndarje paraqet hierarkinë e krijimit dhe shtatet e realitetit nga Zoti suprem deri te njeriu sipas Farabiut. Shih Ibrahim Kalin, po aty, fq. 186. 15. Fazlur Rahman, *Islam and Modernity: Transformation of an Intellectual tradition*, Chicago, Univ. of Chicago Press, 1982, fq. 139.

Intervistë me kryetarin e Kuvendit të Bashkësisë Islame të Kosovës, dr. Ajni ef. Sinanin

S'duhet të lejohet krijimi i bashkësive të tjera fetare me prefiks islam

Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka vlerësuar se krijimi i bashkësive të tjera fetare me prefiks islam mund të ketë pasoja të rrezikshme për unitetin e besimtarëve të besimit islam.

Kryetari i Kuvendit të Bashkësisë Islame të Kosovës, Ajni Sinani, ka thënë se nuk duhet të lejohet krijimi i bashkësive të tjera fetare me prefiks islam. Ai ka thënë se BIK-u i ka dhënë vërejtjet dhe sugjerimet e saj rreth draft-ligjit mbi bashkësitë fetare, i cili parasheh themelimin edhe të Bashkësisë së Tarikateve të Kosovës.

Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka vlerësuar se krijimi i bashkësive të tjera fetare me prefiks islam mund të ketë pasoja të rrezikshme për unitetin e besimtarëve të besimit islam.

"Bashkësia Islame e Republikës së Kosovës është bashkësia e vetme dhe unike islame e të gjithë pjesëtarëve të besimit islam të rajonit të Prishtinës, të Gjilanit, të Mitrovicës, të Prizrenit, të Pejës, të Ferizajt, të Preshevës dhe të Gjakovës, si dhe e pjesëtarëve të Bashkësisë Islame që gjenden me punë dhe qëndrim në botën e jashtme. Asnjë institucion apo institut tjetër nuk duhet të tentojë të cenojë këtë të drejtë të BIK-ut. Nuk duhet të lejohet të krijohen bashkësi të tjera fetare me prefiks islam. Përndryshe do të kishte pasoja të rrezikshme për unitetin e besimtarëve të besimit islam", ka thënë ai.

Sinani ka treguar kërkesat e BIK-ut për institucionet e reja të Kosovës. "Kërkesa është t'i kthehen BIK-ut pronat e uzurpuara nga sistemi i kaluar monist. Të procedohet me

draft-ligjin për bashkësitë fetare me sugjerimet e dhëna nga BIK-u. Gjithashtu të mundësohet futja e edukatës fetare në shkollat tona publike, veçanërisht pas shfaqjeve së shumë delikteve e vrasjeve dhe dukurive të tjera negative. Prandaj mendojmë se duhet të ketë një pajtim mes liderëve politikë që edhe përmes futjes së edukatës fetare në shkollat të kontribuohet në minimizimin e këtyre dukurive të shëmtuara", është shprehur Sinani.

"Epoka e re": Sot besimtarët islamë festojnë Kurban-Bajramin. Cili është kuptimi i kësaj feste për besimtarët?

Sinani: Adhurimet dhe festat në Islam përmbajnë urtësi dhe porosi. Urtësia themelore e institucionit të haxhit dhe e therjes së kurbanit është fitimi i kënaqësisë së Zotit dhe pasimi i praktikës së Muhamedit a.s.. Festat islame janë të lidhura me ndodhi të rëndësishme dhe shprehin gëzimin e besimtarëve pas kryerjes së obligimeve të veçanta ndaj Zotit. Pas përfundimit të agjërimit të Ramazanit, muajin kur ka filluar shpallja e Kuranit, pason festa e Fitër-Bajramit, gjithashtu pas kryerjes së haxhit, në muajin kur ka përfunduar shpallja e Kuranit, pason festa e Kurban-Bajramit.

Tri ngjarje me rëndësi fetare kanë të bëjnë me Kurban-Bajramin: përfundimi i shpalljes së Kuranit,

haxhi dhe prerja e kurbanit. Secila prej këtyre ngjarjeve paraqet simbolikisht idetë sublimë islame, Kurani – devotshmërinë dhe arsimin e përgjithshëm, haxhi – solidaritetin e ndërsjellë dhe kurbanin – fljimin për të tjerët.

Kurani meriton konsideratën e të gjithëve. Të nxitur nga fryma e tij, myslimanët dhanë kontributin e tyre shkencor të jashtëzakonshëm në periudhën më të errët të njerëzimit. Ai është burim i pashtershëm drejt prosperitetit shpirtëror e material dhe udhërrëfyesi më i mirë për të jetuar fisshëm në këtë botë dhe për të arritur lumturinë në botën tjetër. Këto ditë kanë të bëjnë edhe me kryerjen e haxhit, si kushti i pestë islam. Ai është manifestim i barazisë, i paqes dhe i vëllazërimit të vërtetë islam. Në ato vende të bekuara, të gjithë haxhitë gjatë kohës së haxhit, pavarësisht nacionalitetit, ngjyrës, vendit, profesionit dhe pozitës, të veshur me një petk të bardhë (ihram), kryejnë të njëjtat adhurime.

Gjatë ditëve të Bajramit bëhet edhe therja e kurbanit me emrin e Zotit. Myslimani ua ndan mishin e kurbanit edhe të tjerëve, posaçërisht të varfërve. Ky është një shembull i humanizmit. Institucioni i kurbanit na mëson se duhet të sakrifikojmë në emrin e Zotit, jo vetëm të mirat materiale, por edhe rehatinë, kohën dhe dijen në të mirë të shoqërisë, të vendit dhe të gjithë atyre që kanë

nevojë, që të mund t'ia dalim në provimin e jetës.

“Epoka e re”: A do ta vazhdojë Bashkësia Islame traditën e therjes së kurbaneve edhe këtë vit dhe, nëse po, cili është çmimi i vendosur për një kurban?

Sinani: Po, sikurse edhe viteve të shkuara, edhe këtë vit vazhdon tradita e therjes së kurbanit. Bashkësia Islame e Kosovës, për sa i takon therjes së kurbaneve, tashmë ka një përvojë dhe eksperiencë mbi 50-vjeçare. Kryerjen e këtij obligimi e sheh si amanet dhe e realizon me shumë përgjegjësi. Numri i porositve për kurbanë në adresë të Kryesisë së BIK-ut çdo vit është në rritje, si nga brenda edhe nga jashtë. BIK-u bën therjen e më shumë se 1000 krerë lopëve për kurban. I tërë ky kontingjent i mishit të kurbanit iu shpërndahet të varfërve, jetimëve, familjeve të dëshmorëve, invalidëve të luftës, medresesë, dhe shumë institucioneve të tjera meritore në vend. Çmimi është sikurse i viteve të shkuara, 120 euro.

“Epoka e re”: Edhe kjo festë do të pritët në pandemi, ndonëse në rrethana më të mira së vitin e kaluar. Qe disa muaj ka filluar vaksinimi i qytetarëve kundër Covidit, por ka shumë qytetarë që po hezitojnë ta marrin vaksinën. Cili është qëndrimi i BIK-ut për këtë çështje?

Sinani: Bashkësia Islame e Kosovës ka kërkuar në vazhdimësi respektimin e rregullave dhe të masave mbrojtëse për parandalimin e përhapjes së Covid19-, si dhe domosdoshmërinë për kujdes dhe vëmendje të shtuar në ruajtjen e shëndetit publik. Qëndrimi i BIK-ut është se duhet të vazhdohet me vaksinimin. Tashmë një numër jo i vogël i nëpunësve dhe i hoxhallarëve tanë kanë filluar të vaksinohen. Rreth kësaj është biseduar edhe me qeverinë tonë. Urojmë që sa më shpejt, inshallah, të kalojë kjo pandemi.

“Epoka e re”: Myftiu Naim Tërnavë, së fundi ka takuar disa liderë institucionalë dhe politikë. Çka është



diskutuar në këto takime dhe a ka pasur Myftiu ndonjë kërkesë specifike ndaj liderëve institucionalë e politikë?

Sinani: Kërkesa është t'i kthehen BIK-ut pronat e uzurpuara nga sistemi i kaluar monist. Të procedohet me draft-ligjin për bashkësitë fetare me sugjerimet e dhëna nga BIK-u. Gjithashtu të mundësohet futja e edukatës fetare në shkollat tona publike, veçanërisht pas shfaqjeve të shumë delikteve e vrasjeve dhe dukurive të tjera negative. Prandaj mendojmë se duhet të këtë një pajtim mes liderëve politikë që edhe përmes futjes së edukatës fetare në shkolla të kontribuohet në minimizimin e këtyre dukurive të shëmtuara.

“Epoka e re”: Bashkësisë Islame, sikurse edhe bashkësive të tjera fetare në vend, mungesa e ligjit që përcakton pozitën juridike të bashkësive fetare po i shkakton vështirësi në funksionim normal. A e keni adresuar këtë çështje tek institucionet e reja?

Sinani: Bashkësia Islame e Republikës së Kosovës është për përcaktimin e pozitës juridike të bashkësive fetare. BIK-u ka dhënë edhe vërejtjet dhe sugjerimet rreth draft-ligjit mbi bashkësitë fetare. Bashkësia Islame e Republikës së Kosovës është bashkësia e vetme dhe unike islame e të gjithë pjesëtarëve të

besimit islam të rajonit të Prishtinës, të Gjilanit, të Mitrovicës, të Prizrenit, të Pejës, të Ferizajt, të Preshevës dhe të Gjakovës, si dhe e pjesëtarëve të Bashkësisë Islame që gjenden me punë dhe qëndrim në botën e jashtme. Asnjë institucion apo institut tjetër nuk duhet të tentojë të cenojë këtë të drejtë të BIK-ut. Nuk duhet të lejohet të krijohen bashkësi të tjera fetare me prefiks islam. Përndryshe do të kishte pasoja të rrezikshme për unitetin e besimtarëve të besimit islam.

“Epoka e re”: Cili është mesazhi juaj për festën e Kurban-Bajramit?

Sinani: Sigurisht, të lëmë inatet, urrejtjet, përçarjet, shpifjet e gënjeshtërën. Të bëjmë kthesë drejt vlerave hyjnore. Në këto ditë Bajrami të ofrojmë falje, pajtim, paqe, harmoni, respekt ndaj familjarëve dhe të afërmeve. T'i vizitojmë edhe ata që nuk na vizitojnë. Të tregojmë solidaritet ndaj atyre që janë të varfër e të ngratë, sikurse na mëson Kurani fisnik. Të pranojmë në këto ditë të bekuara fajet dhe gabimet tona dhe t'i përmirësojmë raportet tona me Krijuesin dhe krijesat e Tij. Të punojmë si individë, si shoqëri dhe si shtet për një Kosovë ku do të këtë të ardhme të ndritur për rininë tonë.

Intervistoi: Muhamet Koci
(<https://www.epokaere.com/2-470595/>)

LL.M. Argjent Xheladini

Pengesat martesore (2)

Pengesat martesore nuk duhet të ekzistojnë në momentin e lidhjes së martesës, por nëse nuk janë konstatuar në momentin e lidhjes së martesës, martesë mund të lidhet. Ndërsa, konstatimi i mëvonshëm i tyre shpie në anulimin e martesës.

Pengesat e përkohshme martesore

Në qoftë se personat që dëshirojnë të lidhin martesë, kanë ndonjë pengesë, nga ato që do t'i përmendim më poshtë, ata nuk mund të martohen përderisa të mos evitohet ajo pengesë.

Në të drejtën e Sheriatit, pengesa të përkohshme konsiderohen rastet:

1. Bashkimi i dy motrave në një martesë;
2. Gruaja në idet;
3. Gratë idhujtare;
4. Martesa e myslimanës me jomyslimanin;
5. Martesa e përkohshme (afatizuar);
6. Me më shumë se katër gra;

7. E lëshuara me tre lëshime;
8. Martesa me gruan imorale.

Bashkimi i dy motrave në një martesë

E drejta e Sheriatit ndalon që dy motra të martohen njëkohësisht me një burrë. Mirëpo, në qoftë se gruaja vdes ose shkurorëzohet dhe i kalon afati i pritjes - ideti, atëherë burri e ka të lejuar të marrë motrën e saj. Argument për këtë është fjala e Zotit të Madhëruar: "... (ju është ndaluar juve të martoheni edhe me) dy motra duke i bashkuar (në një kurorë, në të njëjtën kohë)..."¹

Ndërsa i Dërguari i Zotit (paqja dhe bekimi i Zotit qofshin mbi të!) ka thënë: "Nuk lejohet bashkimi (në

martesë) i një gruaje dhe hallës së saj, apo i një gruaje dhe tezes së saj."² Kjo pengesë ka të bëjë edhe me të afërmet e tjera të gruas, si me tezen ose me mbesën e saj prej vëllait ose prej motrës. Ndërkaq, nëse i vdes gruaja ose shkurorëzohet dhe i kalon afati i pritjes - ideti, atëherë i lejohet që të martohet me tezen e gruas ose me mbesat e saj.³

Gruaja në idet⁴

Gruaja me të cilën dëshirojmë të martohemi, duhet të jetë e aftë për martesë në çdo aspekt, pra të mos ketë ndalesa për martesë. Ajo nuk bën të jetë në idet nga martesa e saj e mëparshme, pa marrë parasysh nëse idetin e ka pasur për shkak të vdekjes së burrit ose për shkak të prishjes së martesës së vlefshme a të pa vlefshme. Zoti i Madhëruar thotë: "E gratë e



lëshuara janë të obliguara të presin tri të përmuajshme...”⁵

Gruas së lëshuar i lejohet lidhja e martesës vetëm pasi t’i kalojnë tri të përmuajshme pas shkurorëzimit, asaj i lejohet martesë pas lindjes së fëmijës, e nëse nuk ka të përmuajshme, ideti i saj është tre muaj nga shkurorëzimi. Zoti i Madhëruar thotë: “E ato nga gratë tuaja, të cilave u janë ndërprerë të përmuajshmet nëse nuk e keni ditur, koha e pritjes së tyre është tre muaj e ashtu edhe ato që ende nuk kanë pasur të përmuajshme, ndërkaq për gratë shtatzëna afati i pritjes së tyre është derisa të lindin.”⁶

Zoti i Lartësuar, duke e sqaruar periudhën e pritjes së gruas, burri i së cilës ka vdekur ka thënë: “Gratë janë të detyruara të presin katër muaj e dhjetë ditë pas vdekjes së burrave të tyre...”⁷

Gratë idhujtare

Besimtari mysliman, sipas rregullave të Sheriatit e ka të ndaluar të martohet me një vajzë idhujtarë, qoftë ajo budiste, ateiste etj. Pra i ndalohet martesë me çdo vajzë që i mohon fetë qiellore. Zoti i Lartësuar thotë: “Mos u martoni me idhujtare derisa ato të besojnë (Zotin)...”⁸

Në këtë ajet kuranor, Zoti i Lartësuar i urdhëron të gjithë meshkujt myslimanë që të mos martohen me idhujtare derisa të besojnë Zotin.

Ajeti kuranor tregon se myslimanit i ndalohet martesë me idhujtaren, ashtu siç i ndalohet myslimanes të martohet me idhujtarin për shkak të dallimit të madh në fe. Këta thërrasin në parajsë e ata në zjarr, këta besojnë Zotin, profetin e botën tjetër, kurse ato i bëjnë ortak Zotit në adhurim, mohojnë profetin dhe refuzojnë

botën tjetër. Meqë në martesë ka qetësi e dashuri, atëherë si të afrohen këto dy palë të kundërta njëra me tjetrën?!

Martesa e myslimanes me jomyslimanin

Dispozitat e të drejtës së Sheriatit, e ndalojnë rreptësisht që vajza myslimane të martohet me një jomysliman, dhe nëse arrihet një martesë e tillë, konsiderohet martesë e kotë. Sipas mendimit të të gjithë juristëve islamë, kjo martesë është e ndaluar dhe këtë e vërtetojnë me ajetin kuranor: “Mos u martoni as me idhujtarë derisa që ata të besojnë (Zotin)...”⁹

Pastaj në ajetin tjetër: “nëse vërtetoni se ato janë besimtare, atëherë mos i ktheni ato te jobesimtarët...”¹⁰

Urtësia e ndalimit të kësaj martesë është për shkak se ajo mund të shndërrohet prej myslimanes në jomyslimane. Në shumicën e rasteve burri ia imponon gruas fenë e tij. Ndalesë e martesës së myslimanes me jomyslimanin është prej ndalesave të përkohshme për shkak të besimit të tij, në qoftë se një burrë jomysliman e pranon fenë islame, atij i lejohet martesë me grë myslimane, pra me kalimin e shkakut largohet edhe pengesa në martesë.¹¹

Martesa e përkohshme (afatizuar)

– Në të drejtën e Sheriatit, nuk ka martesë legjitime nëse është kufizuar në kohë, qoftë kjo kohë edhe e pacaktuar dhe shumë e gjatë, si kur mashkulli martohet për njëqind vjetët e ardhshme, ose gjersa të mos largohet prej saj. Nëse në marrëveshjen martesore përmendët një kohë e caktuar, kjo marrëveshje është e pavlefshme për këtë kanë



rënë dakord të gjithë juristët e të drejtës së Sheriatit.¹² Kjo është për faktin se me martesat e përkohshme nuk mund të arrihet qëllimi i jetës së përbashkët. Në këtë martesë nuk ekzistojnë të drejtat e kurorës së rregullt, si trashëgimia, pagesa e kurorës, periudha e pritjes, etj. Nisur nga kjo, gruaja e kurorëzuar me martesë të përkohshme, nuk është as bashkëshorte, as shërbëtoare. Sipas juristëve të Sheriatit, martesat e përkohshme është pranuar njëzëri si martesë e ndaluar (kurvëri).

Martesa me më tepër se katër gra

Është e ndaluar që në martesë burri të ketë më shumë se katër gra, megjithëse, parimisht dhe me plotësimin e disa kushteve të vështira, lejohet martesat me më së shumti me katër gra.¹³ Martesa me më shumë se katër gra në një kurorë është e ndaluar. Nëse një burrë i cili dëshiron të martohet me një vajzë, e në anën tjetër ka katër gra në kurorë, atij i ndalohet martesat me të pestën përderisa ta shkurorëzojë njërin, dhe t'i kalojë afati i pritjes (ideti).¹⁴ Pra nuk lejohet që një burrë të martohet në të njëjtën kohë me më shumë se katër gra, sepse ajo konsiderohet shkelje e dispozitave të përcaktuara nga Zoti i Madhëruar për mbarëvajtjen e jetës bashkëshortore. Zoti i Lartësuar thotë: "...martohuni me ato gra që ju pëlqejnë: me dy, me tri apo me katër; e nëse frikësoheni se nuk do të jeni të drejtë ndaj të gjithave njësoj, atëherë mjaftohuni me një grua..."¹⁵

E drejta e Sheriatit, siç mund të kuptohet nga ajeti i lartcekur, ka urdhëruar burrin, i cili ka më shumë gra, të jetë i drejtë ndaj tyre. Kjo drejtësi duhet të shprehet në të gjitha gjërat që njeriu është në gjendje t'i arrijë.

E lëshuara me tri lëshime

Gruaja e lëshuar tri herë nga burri është e ndaluar të martohet me atë burrë derisa nuk martohet me një burrë tjetër. Zoti i Lartësuar thotë: "E në qoftë se ai (burri) e lëshon atë (për herë të tretë) pas atij (lëshimi) nuk i lejohet më derisa të martohet ajo për një burrë tjetër. E nëse ai (burri i dytë) e lëshon atë, atëherë për ata të dy, po qe se mendojnë t'i zbatojnë dispozitat e Zotit, nuk ka pengesë të rikthehen (në bashkëjetesë)..."¹⁶

Pra nëse burri është shkurorëzuar me gruan e tij tri herë, ai nuk mund ta rikthejë atë përderisa të plotësohen këto kushte:

- që ajo të jetë martuar me një burrë tjetër;

- që të kenë pasur marrëdhënie intime me të;

- që të shkurorëzohet me (burrin e dytë), dhe t'i kalojë afati i pritjes (ideti).¹⁷

Martesa me gruan imorale

Nuk lejohet që një burrë të martohet me një grua imorale dhe as një grua e ndershme të martohet me një burrë imoral, derisa ata të pendohen për imoralitetin e tyre. Zoti i Madhëruar ka kushtëzuar që secili prej bashkëshortëve ta ruaj nderin. Ai në Kuran thotë: "... të lejuara për ju janë femrat e ndershme besimtare..."¹⁸

Vetëm me këtë kusht martesat konsiderohet të rregullta. Dhe martesat që s'e përmban këtë kusht, është e pamundur.

Përfundimi

Sipas të drejtës së Sheriatit, martesat karakterizohet me disa kufizime, nga të cilat nuk mund të kryhet martesat në mes kategorive të lidhjeve të caktuara shoqërore. Në kufizimin e martesës bëjnë pjesë pengesat të cilët si të tilla nuk lejojnë të kryhet martesat. Pengesat martesore janë dy lloje: të përhershme dhe të përkohshme.

Pengesat e përhershme janë gjithsejtë tri lloje: pengesat sipas afërsisë së gjakut (gjinisë), pengesat sipas gjirit dhe pengesat sipas krushqisë (miqësisë). Ndërsa pengesat e përkohshme martesore janë kur personave iu ndalohet për një kohë të caktuar lidhja e martesës për një shkak apo arsye dhe me eliminimin e atij shkakut eliminohen edhe pengesat martesore.

Efekti juridik i pengesave martesore është erga omnes, çka do të thotë se efekti i tyre është ndaj çdo personi të i cili ekzistojnë këto pengesa. Në praktikë ka raste kur me plotësimin e kushteve themelore të lidhet martesat, por nëse ekzistojnë pengesat martesore ato janë shkak për të kërkuar anulimin e martesës. Pengesat martesore nuk duhet të ekzistojnë në momentin e lidhjes së martesës, por nëse nuk janë konstatuar në momentin e lidhjes së martesës, martesat mund të lidhet. Ndërsa, konstatimi i mëvonshëm i tyre shpie në anulimin e martesës.

LITERATURA

1. Kurani – përkthim me komentim në gjuhën shqipe (përktheu dhe komentoi H. Sherif Ahmeti), Prishtinë, 1988.
2. Fahrudin Ebibi, Irfan Abazi, Taxhedin Bislimi, Jusuf Zimeri "E Drejta Familjare në Islam", Shkup, 2004.
3. Abdulhamid Mahmud Tuhmazi "Fikhu Hanefi vëll. II E drejta Familjare", Zurich, 2011.
4. Jusuf El-Kardavi "Hallalli dhe Harami në Islam", Prishtinë, 2005.
5. Resul Rexhepi "E drejta Martesore Islame", Prishtinë, 2010.
6. Sejid Sabik "Legjislacioni i Traditës së Profetit A.S", Tiranë, 2007.

1. En-Nisa, 23.2. Hadithin e transmeton Tirmidhiu, 3/433, nr.1126. 3. Resul Rexhepi, op. cit., fq. 41. 4. Shprehja "idet", sipas normave islame, do të thotë kohë e kufizuar, e cila pas shkurorëzimit, ndërpret gjurmët e ngelura nga kurorëzimi. E drejta islame femrën, të cilës i ka vdekur burri apo që është shkurorëzuar, e obligon me pritje (idet). Femrës e cila është në afatin e pritjes - idetit, i ndalohet martesat me ndonjë burrë tjetër, kurse pas kalimit të pritjes - idetit i ndalohet martesat edhe me burrin i cili e ka lëshuar, nëse kjo pritje - idet është pas shkurorëzimit të trefishtë të parevokueshëm (Talak bain bejnune kubra). Ndërsa gjatë afatit të pritjes - idetit, pas shkurorëzimit të revokueshëm (Talak reh'ij), burrit i lejohet ta rikthejë gruan pa kurrfarë kushti, ndërsa të shkurorëzimi i dyfishtë i revokueshëm (bain bejnune sugra) e rikthen me kontratë të re. 5. El-Bekare, 228. 6. Et-Talak, 4. 7. El-Bekare, 234. 8. El-Bekare, 221. 9. El-Bekare, 221. 10. Em-Mumtehine, 10. 11. Jusuf el-Kardavi "Hallalli dhe harami në Islam", Prishtinë, 2005, fq. 250. 12. Abdulhamid Mahmud Tuhmazi, "Fikhu Hanefi vëll. II E drejta Familjare", Zurich 2011, fq. 101. 13. Resul Rexhepi, op. cit., fq. 40. 14. Grup autorësh, op. cit., fq. 86. 15. En-Nisa, 3. 16. El-Bekare, 230. 17. Resul Rexhepi, op. cit., fq. 42. 18. El-Maide, 5.

Mr. Jasir Krasniqi

Qasje kuranore mbi raportin prindër-fëmijë

Kurani i kushtoi rëndësi prindërve dhe porositi fëmijët të kujdesen për ta në mënyrë të vazhdueshme, si dhe i qortoi ata që të mos i hidhërojnë prindërit; premtoi Xhenetin për atë që kujdeset për prindërit, ndërsa për atë që sillet keq Xhehenemin.

Zoti xh.sh. në Kuran ka thënë: “Zoti yt ka dhënë urdhër të prerë që të mos adhuronit tjetër pos Tij, që të silleni në mënyrë bamirëse ndaj prindërve...”. (El-Isra, 23).

Barazoi mes adhurimit ndaj Tij dhe mirësisë ndaj prindërve, ngase ka vlerë të madhe respekti ndaj tyre, ndërsa është rrezik i madh mosrespektimi i tyre. Pak nga njerëzit flasin për të drejtat e fëmijëve në Islam, ose më mirë të themi, nuk i kushtohet rëndësi ndikimit të edukimit të mirëfilltë për të gjetur rini të avancuar, të pjekur si duhet, rini e cila mban përgjegjësi shpërndarjen e kësaj feje, ngritjen e fjalë së Allahut xh.sh. dhe dërgimin e saj në çdo qoshe të dynjasë.

Medituesi në kontekstet kuranore dhe mrekullitë e tij, gjen shumë raste kur prindi ka respektuar fëmijën e tij, gjë që si kundërshtërim, fëmija respektoi prindin e tij. Allahu xh.sh. thotë: “Allahu ju urdhëron dhe u porositi për fëmijët tuaj...” (En-Nisa, 11). Ashtu siç porositi Kurani fëmijët për prindërit e tyre, gjithashtu porositi prindërit ndaj fëmijëve.

Ibrahimi a.s. dhe djali i tij Ismaili a.s.

Nëse dëshirojmë që me një fjalë të përshkruajmë lidhjen e Ibrahimit a.s. me djalin e tij, themi se ai ishte si “fjala e mirë” që ndikon te tjetri. Allahu xh.sh. e quajti një kaptinë të

Fëmija që konsultohet nga prindi i tij për çështjet e rëndësishme, ai në vetvete ndërton vetëbesim.

tërë me emrin Ibrahim dhe nëse dëshirojmë të notojmë në kuptimet e kësaj kaptine dhe ajeteve që ka, nuk do të ndalet lapsi së shkruari duke nxjerrë xhevahirë të shumtë nga ajetet dhe preciziteti i përdorimit të fjalëve nëpër ajete. Do të ndalemi vetëm te butësia e Ibrahimit a.s. dhe mirësia e sjelljes së tij ndaj fëmijës të tij. Zoti xh.sh. thotë: “Dhe kur arriti ai (djali) që së bashku me të (me Ibrahimin) të angazhohet në punë, ai (Ibrahimi) tha: “O djali im, unë po shoh (jam urdhëruar) në ëndërr të të pres ty. Shiko pra, çka mendon ti?” Ai tha: “O babai im, punojë atë që urdhëroresh, e ti do të më gjeshe mua, nëse do Allahu, prej të durueshmëve!” (Es-Safat, 102).

Bëhet fjalë për një ëndërr, por, jo e zakonshme, sepse fjala “po shoh” që në gjuhën arabe është folje e tashme e vazhdueshme, që aludon në shikimin e ëndrrës disa herë me radhë, ndërsa po ta shihet vetëm një herë ëndërrën nuk do ta dërgonte birin e tij në





vendin e caktuar e t'i rrëfente për një ëndërr që vetëm një herë e ka parë dhe do të vinte në Kuran folja e kohë së kaluar "e kam parë".

Të fjala "o biri im", kemi një pikë shumë interesante. Kjo ngase fëmija që konsultohet nga prindi i tij në çështjet e rëndësishme, kjo do të mbjellë vetëbesim te fëmija, e kjo është një nga shtyllat e formimit të një gjenerate të të rinjve që kanë vetëbesim dhe personalitet të çmuar. "O biri im" përmban në vete kuptime të dashurisë, urtësisë, afërsisë, butësisë, ëmbëlsisë shpirtërore së prindit ndaj fëmijës.

Fjala "në ëndërr", nxjerr në pah një realitet, ngase Ibrahim a.s., deshi t'i tregonte të birit të tij për një ëndërr që duhet të realizohet. "Të të pres ty", në këtë ajet kanë ardhur dy përforcues në një fjalë, sikur që do të thotë (vërtet unë shoh në ëndërr duke të të prerë ty), përforcimi i parë aludon në shikimin e ëndrrës shumë herë, ndërsa përforcimi i dytë, në formën duke e prerë djalin.

"Çka mendon ti?", këtu është një çështje me rendësi, atë të bashkë-bisedimit prind-fëmijë, dialog ky, që për qëllim ka dashurinë e të birit ndaj babait, që pastaj të vjen deri te dëgjueshmëria, respekti dhe pajtueshmëria. Biri është një nga njerëzit më të dashur për babanë dhe nënën.

Ibrahimi a.s. i tha birit të tij: "O biri im, unë po shoh në ëndërr, vërtet duke të të prerë ty...", pasi që i përdori këto fjalë, pastaj i tha: "Çka mendon ti?"

Ibrahimi a.s. e mësoi fëmijën e tij që të jetë i kënaqur me caktimin e Zotit dhe ia mësoi atij mirësitë që të sjellin deri te shpërblimet e mëdha dhe dorëzimin e plotë ndaj Allahut xh.sh.

Fëmija që konsultohet nga prindi i tij për çështjet e rëndësishme, ai në vetvete ndërton vetëbesim, ai ndjen se mendimi i tij qenka i vlerësuar, përfiton përvojë dhe mençuri, e kjo është nga shtyllat e formimit të një gjenerate e të rinjve që kanë vetëbesim dhe personalitet të çmuar, të përgatitur që të planifikojë të ardhmen në mënyrën më të mirë e më të matur. Ndërsa nëse prindi nuk i jep fëmijës shansin për të folur fjalën e tij, atëherë kjo sjellë rezultate jo të mira, siç janë: dobësimi i personalitetit të fëmijës, paqëndrueshmëria në një gjendje, pra ai bëhet jo stabil dhe i luhatsëm etj.; zhvillon urrejtje ndaj prindit, në këtë mentalitet të mbyllur rriten farat e rebelimit dhe kjo çon deri te mos-respektimi i prindërve; bën që fëmija ta pasojë atë që është më i lartë se prindi i tij, ndaj edhe shfaqen

problemet psikike të ndryshme, të cilat sjellin edhe disfata në personalitet, nuk di të bashkëveprojë me të tjerët etj.

Këto parathënie na sjellin te një rezultat i dobët, ku mund të gjendet një gjeneratë dembele, përtace, që nuk ka vizion, nuk di të planifikojë të ardhmen e vet etj.

Ibrahimi a.s. e mësoi fëmijën e tij që të jetë i kënaqur me caktimin e Zotit dhe ia mësoi atij mirësitë që të sjellin deri te shpërblimet e mëdha dhe dorëzimin e plotë ndaj Allahut xh.sh.. Allahu e lavdëroi Ismailin a.s., në kaptinën Merjem ku tha: "Përkujtoje në këtë libër Ismailin! Ai ka qenë shumë besnik në premtim (premtoi të bëhej kurban) dhe i dërguar, peygamber." (Merjem, 54).

Ismaili a.s. e realizoi premtimin e tij atëherë kur i tha babait të vet: "O babai im, punojë atë që urdhërohes, e ti do të më gjesh mua, nëse do Allahu, prej të durueshmëve."

Si përfundim, Ibrahim a.s. e thirri birin e tij me dashuri, e konsultoi atë, mori nga ai mendimin e tij, u qetësua me të... Kështu le të bëhemi edhe ne, prindër dhe edukatorë.

Literatura e shfrytëzuar:

1. Kurani fisnik.
2. Tefsir Ibni Kethir; Dar ibn Hazm, 2000.
3. Etta 'bir el-Kurani – Dr.Fadil Essamerrai 2006, .
4. Meusuatu Ettefsir el-Meudui - grup autorësh, 2018.
5. Ettefsir el-Munir - Dr. Wehbe Ezzuhejli, 0102.
6. Fi Dhilal el-Kuran - Sejjid Kutb 2005.

Nexhmi Hoxha

Madhështia e durimit në Kuranin fisnik (1)

Durimi është një moral i veçantë dhe prej dobive të shumta të tij është edhe ajo se e shumëfishon shpërblimin derisa ta bëjë atë të pallogaritshëm, pasi që çdo pune përveç durimit i dihet shpërblimi.

Allahu xh.sh. në shumë vende në Kuranin fisnik, si në kapitulat mekase ashtu edhe në ato medinase, na flet dhe na porositë për durimin, duke i dhënë kështu një rëndësi dhe një kujdes të veçantë.

Dijetarët islamë janë të ndarë në mendime rreth numrit të përmendjes së durimit në Kuran. Sipas mendimit të Imam Gazaliut, i cituar në veprën “Ihja ulumu ed-din”, durimi në Kuran është përmendur në më shumë se shtatëdhjetë e disa herë.¹

Në veprën “Mudearixhu es-salikhin”, Ibën el-Kajjimi transmeton fjalët e Imam Ahmedit duke thënë se durimi në Kuran është përmendur në nëntëdhjetë vende.²

Ndërkaq, Jusuf Kardavi është i mendimit se nuk ka kundërshtime

ndërmjet dijetarëve rreth përmendjes së durimit në Kuran.³ Ai i sjellë si shembull ajetet kuranore 126-127 të sures En-Nahl, ku fjala durim përmendet në katër vende, që në një kontekst tjetër, dijetarët e kanë konsideruar si dy herë i përmendur: “Në qoftë se doni të merrni hak, atëherë ndëshkoni në atë masë sa jeni ndëshkuar ju; e nëse duroni, padyshim se ai është më i mirë për ata që durojnë. Pra, të jesh i durueshëm! Durimi yt është vetëm me ndihmën e Allahut. Ti mos u pikëllo për ata, as mos u brengos për dredhitë që bëjnë ata.”⁴

Fjala durim në aspektin gjuhësor do të thotë abstenim nga diçka dhe të detyruarit e vetes në diçka tjetër.⁵

Xheneti ka kërkesat e tij që duhen plotësuar. Ai ka një çmim, e çmimi i tij është durimi në fatkeqësitë e ndryshme, durimi gjatë sëmundjeve të ndryshme, durimi në varfëri, durimi në shumë prova që e godasin njeriun gjatë gjithë jetës së tij.

Sa i përket kontekstit të fjalës durim nga aspekti gjuhësor, Allahu i Madhëruar na i sjellë argumentet e qarta përmes ajetit kuranor: “Përkufizojë veten tënde me ata që lusin Zotin e tyre mëngjes e mbrëmje, e që kanë për qëllim kënaqësinë e Tij, dhe mos i hiq sytë e tu prej tyre e të kërkossh bukurinë e kësaj bote dhe mos iu bind atij që ia kemi shmangur zemrën e tij prej rikujtimit ndaj Nesh dhe i është dhënë epshit të vet, pse puna e tij ka mbaruar.”⁶

Ndërkaq, sa i përket fjalës durim, të përmendur në Kuran, ajo e ka domethënien e përballimit të fatkeqësive, duke kërkuar kështu kënaqësinë e Allahut.⁷ Për këtë, Allahu në një ajet kuranor thotë: “Edhe ata që patën durim (ndaj të këqijave) për të fituar kënaqësinë e Zotit të tyre...”⁸



Durimi është një moral i veçantë dhe prej dobive të shumta të tij është edhe ajo se e shumëfishon shpërblimin derisa ta bëjë atë të pallogaritshëm, pasi që çdo pune përveç durimit i dihet shpërblimi. Allahu xh.sh. në një ajet kuranor ka thënë: "... ndërsa durimtarëve u jepet shpërblimi i tyre pa masë."⁹

Imam Gazaliu e ndan durimin në dy kategori¹⁰:

E para, ka të bëjë me durimin në trupin e njeriut, siç është përballimi ndaj sëmundjeve të ndryshme apo edhe përballimi i mundimeve fizike, qoftë gjatë punës apo edhe gjatë kryerjes së ibadeteve të caktuara.

E dyta, ka të bëjë me llojin e durimit i cili është edhe më i lavdëruar. Në një rast, Pejgamberi a.s. është pyetur për imanin, e ai është përgjigjur: "Ai është durimi." Të gjitha këto lloje të durimit, Allahu i përmend në ajetin kuranor të sures El-Bekare: "... dhe të durueshmit në skamje, në sëmundje dhe në flakën e luftës. Të tillët janë ata të sinqertit dhe të tillët janë ata të devotshmit."¹¹

Njerëzit në këtë botë janë të sprovuar me sprova të ndryshme, varësisht nga besimi që ata kanë, andaj edhe për këtë thuhet se pas pejgamberëve më të sprovuarit janë besimtarët. Për këtë, të kuptuarit e asaj që Allahu i sprovon besimtarët ishte në mendjet dhe në shpirtrat e besimtarëve edhe gjatë periudhës mekase, kur ata po përjetonin dhunën dhe terrorin nga jobesimtarët, por edhe gjatë periudhës medinase.¹² Për këtë, Allahu zbriti ajetet: "Elif, Lam, Mim. A menduan njerëzit të thonë: 'Ne kemi besuar, e të mos vihen në sprovë? Ne i sprovuam ata që ishin para tyre, ashtu që Allahu gjithqysh do t'i dallojë ata që e thanë të vërtetën, e do t'i dallojë edhe gënjeshtarët.'"¹³

Në këtë kontekst zbritën edhe shumë ajete në periudhën medinase, ndër to përmendim: "A mos menduat ju se do të hyni në xhenetet e Allahut pa e ditur (pa u vërtetuar në praktikë) se cilët prej jush kanë luftuar dhe pa e ditur cilët prej jush ishin të durueshëm."¹⁴

Vështruar nga kuptimi i këtij ajeti, na del se xheneti ka kërkesat e tij që duhen plotësuar. Ai ka një çmim, e çmimi i tij është durimi në fatkeqësitë e ndryshme, durimi gjatë sëmundjeve të ndryshme, durimi në varfëri, durimi në shumë sprova që e godasin njeriun gjatë gjithë jetës së tij. Ky ajet zbriti pas betejës së Uhudit, kur myslimanët pësuan goditje të rënda dhe patën humbje të mëdha të njerëzve, e ndër ta ishte edhe axha i Pejgamberit a.s., Hamza.

Përmes Kuranit fisnik, Allahu i Madhëruar i urdhëron njerëzit që me çfarëdo që ata ballafaqohen, të forcohen dhe të kapen pas dy gjërave, e ato janë durimi dhe namazi. Në ajetin 153 të sures El-Bekare, Ai urdhëron e thotë: "O ju që keni besuar, kërkonin ndihmë me durim e me të falur, se vërtet Allahu është me durimtarët..."¹⁵

Në vazhdimin e këtij ajeti, Allahu i qetëson zemrat e besimtarëve kur ata humbasin të afërmit e tyre, por edhe ua tërheq vërejtjen për fatkeqësitë që do të pasojnë, e që në përmendjen e tyre në këtë ajet ato janë të formave dhe kategorive të ndryshme, siç janë goditja e zemrës me frikë, goditja e barkut me uri, pasurisë me pakësim, e deri te vdekja.¹⁶

Nga shumë emra të bukur të Allahut, njëri ndër ta është edhe emrin "Es-Sabur", që do të thotë "Durimtari". Është Ai që nuk shpejton me dënim, po shikon, pret dhe vonon, e megjithatë, ndëshkimit të Tij nuk mund t'i shmanget askush që e ka mohuar dritën dhe udhëzimin hyjnor të Tij.

Ibën el-Kajjimi është i mendimit se durimi është vaxhib, e për këtë janë pajtuar edhe dijetarët e tjerë. Në veprën e tij "Medarixhu el-Salikin", ai sjellë argumentet për këtë, e që thotë se durimi është urdhër i Allahut në shumë ajete, që me këtë nënkuptohet obligimi, vaxhibi. Shembull për këtë kemi ajetin: "O ju besimtarë, bëni durim, bëhuni të qëndrueshëm kundër armikut, rrini të përgatitur dhe, që të shpëtoni, ruajuni dënimet të Allahut."¹⁷

"E ata që besuan dhe bënë vepra të mira, atyre do t'u bëjmë vend të lartë në Xhenet, në të cilin rrjedhin lumenj, aty janë përgjithmonë; sa i mirë është shpërblimi për atë që vepruan. Të cilët bënë durim dhe vetëm Zotit të tyre iu mbështetën."

(El-Ankebut, 58-59)

Por, vaxhibi nënkupton edhe ndalesën për ta kryer të kundërtën. Për këtë, Allahu xh.sh. thotë: "E mos u dobësoni (fizikisht) dhe mos u dëshpëroni (shpirtërisht), derisa ju jeni më të lartit, po që se jeni besimtarë të sinqertë."¹⁸

Nëpërmjet Kuranin fisnik arrihet e mira në këtë botë dhe në botën tjetër. Njeriu nuk mund të ketë sukses në atë që dëshiron dhe të largohet prej asaj që e urren përveç se me durim, për këtë arsye durimi bëhet vaxhib.¹⁹

Vlerat e lartësuar shpirtërore të Islamit dhe lidhja e tyre me durimin

Bindja, falënderimi, mbështetja, lartësimi, devotshmëria, mëshira etj., janë vetëm disa nga vlerat e lartësuar shpirtërore të fesë islame. Allahu i Madhëruar në Kuranin fisnik ka bërë ndërlidhjen e këtyre vlerave me ajetet e durimit, duke dhënë kështu shembuj për secilën prej tyre. Sa i përket bindjes, Ai thotë: "Dhe prej tyre Ne bëmë prijës, që me urdhrin Tonë udhëzojnë, pasi që ata (që i bëmë



prijës) ishin të durueshëm dhe ndaj argumenteve Tona ishin të bindur.”²⁰

Imam Gazaliu në lidhje me këtë ajet pohon dhe thotë se për qëllim është njohja e plotë e arritur përmes udhëzimit nga Allahu i Madhëruar.²¹

Vlerën e falënderimit dhe lidhjen me durimin, Allahu xh.sh. e përmend në katër vende, saktësisht në suret, Ibrahim, 5; Llukman, 31, Sebe, 19, Esh-Shura, 33,²² e që këto kaptina i takojnë periudhës mekase.

Allahu xh.sh. thotë: “... se vërtet në ato (rikujtime) ka argumente për secilin që është shumë i durueshëm dhe shumë falënderues.”²³

Në mbështetjen tek Allahu xh.sh.: “E ata që besuan dhe bënë vepra të mira, atyre do t’u bëjmë vend të lartë në Xhenet, në të cilin rrjedhin lumenj, aty janë përgjithmonë; sa i mirë është shpërblimi për atë që vepruan. Të cilët bënë durim dhe vetëm Zotit të tyre iu mbështetën.”²⁴

Në namaz (në durimin gjatë namazit): “O ju që keni besuar, kërkonin ndihmë me durim e me të falur, se vërtet Allahu është me durimtarët.”²⁵

Të lartësuarit e Allahut dhe të kërkuarit falje Atij lidhet ngushtë me durimin, ashtu siç e përmend Allahu xh.sh. në suren Gafir: “Ti bën durim, se premtimi i Allahut është i vërtetë, kërko falje për mëkatin tënd, lartësoje me falënderim Zotin tënd mëngjes e mbrëmje.”²⁶

Në luftën, ashtu siç thotë Allahu xh.sh. në Kuran: “Ne do t’u sprovijmë juve, derisa t’i njohim (të dihen konkretisht) luftëtarët dhe ata që ishin të qëndrueshëm nga mesi juaj, po edhe do t’i sprovijmë veprat tuaja.”²⁷

Në kryerjen e veprave të mira: “Përveç atyre, të cilët kishin durim dhe bënë vepra të mira, të tillët kanë falje (të gabimeve) dhe shpërblim të madh.”²⁸

Devotshmëria është njëra ndër vlera e larta të Islamit, e cila sipas Ebu Talib el-Mekkiut, është tejet e lidhur ngushtë me durimin, sa që asnjëra pa tjetrën nuk mund të realizohen.²⁹ “... po, në qoftë se ju bëheni të durueshëm dhe ruheni (mëkateve), dinakëria e tyre nuk do t’u dëmtojë aspak...”³⁰

Në suren El Asr, Allahu i Madhëruar e bëri durimin një nga katër themelet, pa të cilat njeriu nuk do të ketë sukses as në këtë botë, e as në botën tjetër, e ato janë besimi, kryerja e veprave të mira, rekomandimi i së vërtetës dhe rekomandimi në durim.³¹ Krahës rekomandimit për durim kemi edhe rekomandimin për deri tek e vërteta, ngase rruga për të arritur tek ajo ka vështirësitë e shumta, e pa durim nuk do të ketë sukses dhe as nuk do të fitojë e vërteta.

Në mëshirën: “E pastaj të bëhej prej atyre që besuan, që këshilluan njëri-tjetrin për durim dhe që këshilluan për mëshirë (për ndihmë).”³²

1. Ebu Hamid el Gazali, *Ihja ulumu ed-din*, 4/61.
2. Medarixhu es-salikin, 2. 3. Jusuf Kardavi, *Durimi në Kuranin fisnik*, 2002, fq.6. 4. *En-Nahl*, 126-127 5. Jusuf Kardavi, op. cit., fq.6. 6. *El-Kehf*, 28 7. Jusuf Kardavi, op. cit., fq.7. 8. *Er-Rrad*, 22 9. *Ez-Zumer*, 10 10. *Ihja ulumu ed-din*, 4/66-67. 11. *El-Bekare*, 177 12. Jusuf Kardavi, op. cit., fq.15. 13. *El-Ankebut*, 1-3 14. Ali Imran, 142 15. *El-Bekare*, 153 16. Jusuf Kardavi, op. cit., fq.17. 17. Ali Imran, 200 18. Ali Imran, 139 19. *Ibën el-Kajjimi*, *Medarixhu es-Salikin*. 20. *Es-Sexhde*, 24 21. *Ihja ulumu ed-din*, 4/66. 22. Jusuf Kardavi, op. cit., fq. 69 23. Ibrahim, 5 24. *El-Ankebut*, 58-59 25. *El-Bekare*, 153 26. *Gafir*, 55 27. Muhamed, 31 28. Hud, 11 29. Ebu Talib el-Mekki, *Kutul-Kulub*, 1/197 30. Ali Imran, 120 31. Jusuf Kardavi, op. cit., fq. 73 32. *El-Beled*, 17

Mr. Artan Musliu

Roli ynë karshi thirrjes

Muhamedi a.s., me gjithë pozitën e lartë që e ka tek Allahu xh.sh dhe te besimtarët, ai mbi të gjitha ishte njeri dhe roli i tij ishte si i shumë të dërguarve para tij. Ai kishte për detyrë që njerëzve t'ua kumtojë shpalljen dhe atë që ia mësonte Allahu xh.sh., ashtu siç kishin bërë edhe profetët e tjerë.

Njeriu si një qenie shoqërore mundohet që çdoherë të jetë dominues dhe të jetë autoritar ndaj të tjerëve, andaj ai mundohet që qëllimet, idetë, mendimet, bindjet dhe çdo gjë tjetër çdoherë t'ua imponojë edhe të tjerëve.

Arsyeja e tërë kësaj është se njeriu duke qenë i bindur në këto gjëra dhe duke i menduar si gjërat më të mira që ekzistojnë rrëmbehet nga epshet dhe egoja e tij duke tejkuluar kufijtë e tij dhe kështu shndërrohet në një tiran të dhunshëm, i cili mundohet që me çdo kusht të imponojë idetë dhe qëndrimet e tij te të tjerët. Një gjë e tillë mund të vërehet që nga niveli më i ulët e deri tek instancat më të larta shtetërore dhe shoqërore.

Brenda tërë kësaj tendence përfshihet edhe ideologjia fetare apo edhe kauzat e ndryshme fetare të cilat përgjatë historisë kanë dëshmuar se jo rrallëherë kanë ditë të përdorin autoritetin shtetërorë dhe të shtrijnë ndikimin e tyre nën presionin dhe masat më të mundshme të dhunës. E tërë kjo bëhet për shkak të mungesës së argumentit apo dëshmive dhe fakteve që ta bind mendjen njerëzore për të pasuar atë ideologji.

Kur një mendimi të caktuar i kundërvihesh me forcë apo me ndonjë mënyrë tjetër përveç mendimit, atëherë kjo do të thotë se ti ke ushtruar dhunë dhe ke bërë padrejtësi karshi palës që ke përballë. Kjo ngase debati i përgjigjet debati, mendimit-mendimi, ndjenjës-

-ndjenja, emocionit-emocioni, dhe forcës-forca, e kështu me radhë. Islami si një religjion i ngritur mbi gjuhën e argumentit, nuk e ka pas asnjëherë këtë problem dhe asnjëherë nuk ka tentuar që të imponojë mendimin e tij, por mos zotërimi i argumenteve dhe moskuptimi i duhur i parimeve islame ka bërë që disa predikues dhe besimtarë myslimanë të tejkalojnë kompetencat e tyre.

Kjo është edhe arsyeja se përse sot po sulmohet Islami dhe myslimanët. Me apo pa qëllim disa prej predikuesve islamë kanë tejkuluar suazat e rolit të tyre në shoqëri, duke tentuar të marrin rolin e gjykatësit dhe kjo u ka dhënë shkas të tjerëve që të ngrenë paragjykime dhe teori

të paqëndrueshme ndaj Islamit, duke e etiketuar me etiketime nga më të ndryshmet. Lirisht mund të themi se një gjë e tillë bëhet shumë padrejtësisht, ngase askush nuk bartë përgjegjësinë e askujt tjetër. E aq më pak një doktrinë fetare apo ideologjike të bartë përgjegjësinë e veprimeve të pasuesve të tyre, të cilët ndoshta nuk janë mirë të informuar apo kanë keqkuptuar këto mësimë. Një padrejtësi e tillë shfaqet në dy pika kryesore:

Të gjykuarit e një besimi, ideologjie apo një doktrine, duke u bazuar në veprimet e pasuesve të saj është padrejtësi, e kjo ngase pasuesit apo besimtarët e caktuar të asaj feje mund të kenë keqkuptuar apo keqinterpretuar doktrinat dhe



parimet e asaj feje. Prandaj për të bërë një vlerësim real duhet studiuar dhe duhet referuar burimeve të asaj feje dhe jo veprimeve të pasuesve të caktuar të saj.

Është e padrejtë të gjykosësh apo të akuzosh një besim apo ideologji duke u bazuar vetëm në shpifjet dhe akuzat që janë ngritur ndaj saj, pa u përpjekur t'i njohësh parimet dhe bazat mbi të cilat është ngrit ai besim apo ajo ideologji.

Nëse ndokush dëshiron të gjykojë apo kritikojë Islamin sa i përket asaj se ai thërret në ushtrim dhune dhe tenton të përhapet me forcë, atëherë duhet që medoemos t'i referohet burimeve autentike të Islamit dhe shëmbëlltyrës më të lartë të proklamimit dhe praktikimit të tij. Pra, ata duhet që t'i referohen vetë jetës së Muhamedit a.s., ngase ai ishte shëmbëlltyra e vetë Islamit apo ishte vetë praktikimi i Kuranit.

Prandaj, nëse ne ndalemi dhe shikojmë se si e përshkruan Kurani rolin e Muhamedit a.s., të cilit edhe i është shpallur Islami, do të shohim se atij nuk i jepet asnjë e drejtë të ushtrojë dhunë për të bindur njerëzit të pranojnë fenë islame. E kjo ngase Allahu xh.sh. shumë mirë e sqaron se ndërmjet Krijuesit dhe krijesës nuk mund të ketë ndërmjetësues dhe se një gjë e tillë është një e drejtë fundamentale e çdo njeriut dhe se çdo shfaqje e besimit nën presionin apo dhunën e ushtruar është e papranuar. Këtë gjë shumë qartë na e thotë Kurani në citatin ku Allahu xh.sh. thotë: "Në fe nuk ka dhunë. Është sqaruar e vërteta nga e kota." (2:256).

Ndërsa tani, le t'i kthehemi edhe një herë rolit që kishte Muhamedi a.s. në shpalljen e fundit dhe e drejta që i ishte dhënë nga ana e Allahut xh.sh. në predikimin e tij dhe thirrjen e njerëzve për të përqafuar dhe për të pranuar Islamin.

Kur është fjala për rolin e Muhamedit a.s. karshi predikimit, Allahu xh.sh. thotë: "Nëse ata (idhujtarët) refuzojnë, Ne nuk të kemi dërguar ty rojë të tyre, ti ke për obligim vetëm kumtimin" (42:48), po ashtu në një citat tjetër, Allahu

Sot, fatkeqësisht, shumë prej besimtarëve, predikuesve dhe udhëheqësve fetarë e kanë keqkuptuar rolin e tyre karshi fesë dhe besimit që ata ndjekin, andaj edhe mundohen ta marrin rolin e gjykatësve dhe të tejkalojnë të drejtat dhe autoritetin e tyre karshi këtij besimi dhe njerëzve në përgjithësi.

xh.sh. thotë: "Thuaj: "Respektojeni Allahun dhe respektojeni të dërguarin!" Nëse ata refuzojnë, atëherë atij i takon përgjegjësia me çka është i ngarkuar ndërsa juve përgjegjësia me çka jeni të ngarkuar, nëse i bindeni atij, atëherë keni gjetur të vërtetën. I dërguari ka obligim vetëm komunikimin e qartë." (24:54), po ashtu Allahu xh.sh. thotë "Është e vërtetë se ti nuk mund ta udhëzosh atë që do ti, por Allahu udhëzon kë të dojë dhe Ai është që di më së miri për të udhëzuarit." (28:56).

Nga këto citate, si dhe citate të tjera, por edhe nga vetë jeta e Muhamedit a.s. shohim se roli i tij ka qenë kumtimi i shpalljes Hyjnore dhe nuk ka qenë imponimi i saj te njerëzit. Këtë më së miri mund ta kuptojmë nga vetë fjala e Allahut xh.sh. ku thotë: "Muhamedi nuk është tjetër vetëm se i dërguar. Edhe përpara tij pati të dërguar (që vdiqën ose u vranë). E nëse ai vdes ose mbytet, a do të ktheheshit ju prapa (nga feja ose lufta)? E kushdo që kthehet prapa, ai nuk i bën dëm Allahut aspak, kurse Allahu do t'i shpërblejë mirënjohësit." (3:144).

Pra, Muhamedi a.s., me gjithë pozitën e lartë që e ka tek Allahu xh.sh dhe te besimtarët, ai mbi të gjitha ishte njeri dhe roli i tij ishte si i shumë të dërguarve para tij. Ai kishte për detyrë që njerëzve t'ua kumtojë shpalljen dhe atë që ia mësonte Allahu xh.sh., ashtu siç kishin bërë edhe profetët e tjerë.

Një gjë e tillë ka qenë e njohur edhe te brezat e parë dhe gjeneratat e para të historikut të shtetit islam, prandaj edhe gjejmë shembuj të përkryer të tolerancës dhe bashkëjetesës ndër-fetare. E ndërsa nëse dikush mundohet të dëshmojë të kundërtën, duke u bazuar në luftërat dhe betejat që janë zhvilluar përgjatë historisë islame, atëherë u themi se betejat dhe luftërat që janë bërë nuk janë bërë me qëllim të imponimit të besimit, por me qëllim të largimit të pengesave që i kishte në rrugë kumtimi i kësaj feje për te popujt anembanë botës. E tërë kjo është bërë me arsyetimin se është e drejtë esenciale e çdokujt, që nga vetë myslimanët ta njoh Islamin dhe jo ta njoh atë nga interpretimet e jashtme, propagandat, dhe tentativat për ta paraqitur atë në çfarëdo forme jo reale.

Sot, fatkeqësisht, shumë prej besimtarëve, predikuesve dhe udhëheqësve fetarë e kanë keqkuptuar rolin e tyre karshi fesë dhe besimit që ata ndjekin, andaj edhe mundohen ta marrin rolin e gjykatësve dhe të tejkalojnë të drejtat dhe autoritetin e tyre karshi këtij besimi dhe njerëzve në përgjithësi. Ne, duhet t'i rikthehemi rolit tonë esencial dhe ta kryejmë detyrën tonë karshi thirrjes dhe predikimit të Islamit duke pasur parasysh se predikimi më i mirë dhe më i suksesshëm është predikimi i shëmbëlltyrës dhe zbatimit të mësimave fetare. Pra, roli ynë është predikues dhe jo gjygues ndaj njerëzve, e ndërsa këtë na e dëshmon edhe vetë Allahu xh.sh. kur thotë: "Është e vërtetë se ti nuk mund ta udhëzosh atë që do ti, por Allahu udhëzon kë të dojë dhe Ai është që di më së miri për të udhëzuarit." (28:56).

Edehem Sherkwawi

Mospajtimet ndërmjet bashkëshortëve

Gazetarja pyeti me kujdes: “Si vazhdoi jeta juaj martesore për 60 vjet?”

Bashkëshortja iu përgjigj: “Ne jemi nga ajo gjeneratë, e cila nëse është thyer diçka e kemi rregulluar, por asesi nuk e kemi hedhur.”

Mospajtimet ndërmjet bashkëshortëve janë çështje të natyrshme në jetën e çdo qifti bashkëshortor. Ato i imponojnë brengat e jetës së përditshme, vështirësitë e saj, kërkesat e saj, e kjo aspak nuk ka lidhje me dashurinë ndërmjet bashkëshortëve.

Ndoshta nuk e ekzagjeroj kur them se marrëdhëniet bashkëshortore janë si kripa në ushqim, një sasi e vogël prej saj i jep shije dhe e ndreq atë, por sasia e tepërt e kripës e prish ushqimin dhe e bën atë një ushqim të dëmshëm dhe helmues.

Gruaja është krijesë e cila ndryshon nga burri, jo vetëm nga konstrukti i krijimit të trupit, por edhe nga ana psikologjike emocionale, dhe për shuarjen e problemeve dhe të keqkuptimeve, burri duhet që ta kuptojë natyrën e gruas, e po ashtu edhe gruaja duhet ta kuptojë natyrën e burrit.

Burri është fëmija i madh, me butësi dhe mirësjellje bëhet unaza e gruas, ndërsa me inat bëhet xhelati i saj. Nga të qenët grabitqar, me përkujdesje, luanët shndërrohet në lojtar cirku.

Nuk ekziston gjë e quajtur krenari në jetën martesore, një dërrhem falje është më e mirë se një kilogram inati. Bëhu robëresha e tij, ai bëhet robi yt, bëhu zonja e tij, e ai bëhet xhelati yt. Butësia jote është gjëja më e shtrenjtë në ty, kështu që mos zbrit asnjëherë nga kjo vlerë.

Kjo botë nuk ka nevojë për më shumë burra, i mjaftojnë këta që i ka, i mjaftojnë inxhinierët e saj, luftëtarët e saj, politikanët e saj, por kjo botë ka nevojë për butësinë në brendësinë tënde, shfaqe që ta lumturosh atë, dhe ti të jesh e lumtur me të.

Allahu e krijoi Havanë nga brinjët e Ademit, e nëse Havaja është pjesë prej Ademit, atëherë Ademi është Hava krejt. Gruaja qysh në fillet e saj është krijuar që të bëjë botën e saj, kështu që mos e prish krijimin e saj.

Të ankuarit e shumë të natyrë e femrës, dhe kur të ankohet, në shumicën e rasteve jo se do aq shumë zgjidhje të problemeve, por më tepër dëshiron ta dëgjosh, kështu që bashkëshorti i mirë është dëgjues i mirë.

Nëse është mundësia që me butësi dhe urtësi ta zbusësh, atë mund ta posedosh me përkujdesje dhe butësi.

Kur të ndodh problemi, nxito ti këtu, por mos zbrit nga burrëria jote,

por vetëm përdore atë. Kur të thotë se është e lodhur, tregoj se kjo e bënë atë më me vlerë në syrin tënd, sepse ata të cilët kryejnë punët dhe obligimet e tyre gjithsesi se lodhen.

Kur të thotë se nuk dua të dëgjojë asnjë zë, ofroje te gjoksi yt, gjuha e gishtërinjve tu në flokët e saj është gjuha e vetme për të. Kur koha të ketë ndryshuar shenjat e fytyrës së saj, qetësoje atë, koha (mosha) është armik i grave. Tregoj asaj se nuk është më pak e bukur, por është më me shumë vlerë.

Dhuratat pa ndonjë festë, përqafimi i papritur, argëtimi edhe jashtë kohës së tij, lëvdatat në prezencën e të tjerëve, janë tërheqje (joshje) që e bëjnë gruan të sillet në “planetin” tënd. Tërheqja është sekreti i universit të vogël, i cili e bënë atë të ndërlidhur dhe unik.

*Përktheu nga gjuha anabe:
Florentina Tërmkolli*



Agron M. Rexhepi, MD, PhD

Morfologjia e kokës (1)

Me qëllim të hulumtimit të morfologjisë së kokës së popullatës kosovare në Institutin e Antropologjisë Sportive në Prishtinë janë bërë matjet e kokës në 787 entitete, të moshës 23–55 vjeçare. Prej tyre 594 meshkuj dhe 193 femra.

Të dhënat e fituara nga matjet e kokës kanë rëndësi prioritare në hulumtimet antropologjike, pasi që janë të dhënat më të besueshme që mundësojnë një studim të statusit antropologjik të popujve në kuptimin kronologjik, si dhe mundësojnë krahasimin e vetive morfologjike të popujve të sotëm dhe të popujve të më hershëm.^{3,13,14}

Matjet e kokës mund të bëhen në njerëz të gjallë (cefalometria), por edhe në skeletin e kokës (kranio-metria). Këto dy metoda morfometrike e plotësojnë njëra tjetrën dhe mundësojnë studimin antropologjik (morfologjik) të një popullate në kuptimin kronologjik.

Në përgjithësi, koka (kafka) ka formë vezake me mbizotërim të dimensionit gjatësor ndaj dimensionit gjerësor, ndahet në pjesën kafkore (cerebrale) dhe në pjesën fytyrore (faciale). Për qëllime të klasifikimit të popullatave në bazë të formës së kokës, më tepër ka ndikim pjesa kafkore (cerebrale) e kokës se sa pjesa fytyrore (faciale).^{3,14,16} Nga të gjitha krijesat që i krijoi Zoti ynë, njeriu është e vetmja krijesë që e ka pjesën kafkore (cerebrale) të kokës më të madhe se sa pjesën fytyrore (faciale). Rritja dhe ndryshimi i formës së kokës bëhet që nga lindja e deri në moshën 25 vjeçare. Gjatë tërë kësaj periudhe kohore intensiteti i rritjes dhe i ndryshimit të formës së kokës nuk është i njëjtë.

Periudha që nga lindja e deri në moshën 7 vjeçare karakterizohet me rritje të shpejtë dhe uniforme të



Fig. 1 Një instrument klasik antropometrik, i viteve të para të shekullit XX, i dizajnuar për matjen e dimensioneve të kokës gjatë hulumtimeve antropologjike

kokës. Kjo fazë është më e ndikuar nga faktorët e brendshëm dhe të jashtëm. Periudha e dytë e rritjes së kokës fillon nga fundi i periudhës së parë (mosha 7 vjeçare) dhe vazhdon deri në pubertet. Gjatë kësaj periudhe vërehet një intensitet më i ngadalshëm i rritjes dhe i ndryshimit të formës së kokës. Periudha e tretë fillon që nga puberteti dhe vazhdon deri në moshën 25 vjeçare. Kjo periudhë karakterizohet me një rritje të theksuar të kokës, e sidomos të regjionit frontal.¹⁰

Në formën dhe madhësinë përfundimtare të kokës ndikojnë faktorë të shumtë endo dhe ekzogjen (pozita e kokës gjatë gjumit të fëmijës, avitaminozat, mbajtja e kapelave të ngushta, bartja e peshave

të mëdha në kokë, ushqimi i fortë sjell ndryshime në mandibullë dhe në muret laterale të kokës, etj.).¹⁰

Po ashtu mendohet se edhe faktori endokrin ka ndikim në formën dhe madhësinë e kokës (zonat me strumë-endemike banohen kryesisht me njerëz që kanë kokë brakicefale).^(3,12,13,16)

Me qëllim të hulumtimit të morfologjisë së kokës së popullatës kosovare në Institutin e Antropologjisë Sportive në Prishtinë janë bërë matjet e kokës në 787 entitete, të moshës 23–55 vjeçare. Prej tyre 594 meshkuj dhe 193 femra. Entitetet i kanë takuar popullatës shqiptare kosovare, zgjedhja e tyre ka qenë e rastit, ndërkaq, kriteri i zgjedhjes ka qenë që gjendja psiko-fizike të jetë

normale, pa deformitete të kokës dhe fytyrës, si dhe të kenë dhëmbë natyral dhe formë normale të tyre. Matjet janë bërë në periudhën kohore 1997–2009. Në një entitet janë matur 17 ndryshore të kokës, ndërkaq matjet janë bërë me instrumente klasike antropometrike sipas Martininit.

Ndryshoret e matura të kokës:

1. Gjatkok – gjatësia e kokës apo diametri antero-posterior;
2. Gjerkok – gjerësia e kokës apo diametri transversal;
3. Lartkok – lartësia e kokës apo diametri vertikal;
4. Perikok – perimetri i kokës apo dimensionimi qarkor i kafkës;
5. Disgnop – distanca gnathio-opisthocraniale;
6. Dismast – distanca ndërmjet mastoideve;
7. Larmofy – lartësia morfologjike e fytyrës;
8. Gjeryft – gjerësia e fytyrës;
9. Gjerman – gjerësia e mandibullës;
10. Gjergor – gjerësia e zgavrës së orbitës;
11. Larzgor – lartësia e zgavrës së orbitës;
12. Diskjaor – distanca ndërmjet skajeve të jashtme të zgavrave orbitale;

13. Diskbror – distanca ndërmjet skajeve të brendshme të zgavrave orbitale;

14. Larthun – lartësia e hundës;

15. Gjerhun – gjerësia e hundës;

16. Trabuzë – trashësia e buzëve;

17. Gjebuzë – gjerësia e buzëve;

Me qëllim të një studimi të mirëfilltë të morfologjisë së kokës së shqiptarëve nga Kosova, të dhënat e fituara nga matjet e kokës janë përpunuar dhe interpretuar në mënyrë të veçantë për meshkuj dhe në mënyrë të veçantë për femra. Nga të dhënat e fituara janë llogaritur të dhënat përshkruese statistikore, indeksi i kokës, indeksi i fytyrës, indeksi i hundës, është bërë kategorizimi i entiteteve në bazë të ndryshoreve të matura, është hulumtuar aftësia predikuese e ndryshoreve të caktuara, si dhe është hulumtuar struktura latente e ndryshoreve dhe indekseve të kokës.

Indekset (treguesit) e kokës paraqesin raportin ndërmjet dy ndryshoreve të matura të kokës (p.sh. gjerësi dhe gjatësi, lartësi dhe gjatësi, apo lartësi dhe gjerësi), përmbajnë informata mjaft të rëndësishme dhe mund të jenë të ndryshme. Për herë të parë, indeksi cefalik është përdorur nga anatomi suedez Anders Retzius në vitin 1943. Vlera e indeksit cefalik është në vartësi nga ndryshoret e lartshënuara të kokës. Me të vlerësuar

të një indeksi të kokës, fjala vjen të indeksit cefalik, ne jemi në gjendje të parafytyrojmë morfometrinë, respektivisht tipin e kokës brenda çdo race apo nën race njerëzore.

Indeksi cefalik mund të jetë:


- Indeks cefalik horizontal – ICH (raporti i gjerësisë dhe gjatësisë së kokës);
- Indeks cefalik vertikal – ICV (raporti i lartësisë dhe gjatësisë së kokës);
- Indeks cefalik transversal – ICT (raporti i lartësisë dhe gjerësisë së kokës).
- Indeks cefalik horizontal (ICH) fitohet në bazë të formulës:

$$\text{Eu-Eu/Gl-Op} \times 100$$

Gjatësia e kokës

Gjatësia e kokës së njeriut rritet në mënyrë të rregullt, por jo edhe uniforme (raporti ndërmjet harkut parietal dhe harkut frontal) dhe korrespondon me gjatësinë e trurit të tij. Gjatësia e kokës është faktor i rëndësishëm në përcaktimin e indeksit cefalik horizontal (ICH) dhe formës së kokës.

Në tabelën nr. 1, është paraqitur shpërndarja e entiteteve të matura sipas vlerave të gjatësisë së kokës. Kategorizimi i entiteteve në bazë të gjatësisë së kokës tregon se pjesa dërmuese e meshkujve (50.1%)



Gjatësia e kokës	Meshkujt	Femrat
Vlera minimale	168 mm	164 mm
Vlera maksimale	209 mm	200 mm
Vlera mesatare	188.77 mm	180.14 mm

Tabela 1. Klasifikimi i popullatës së matur në bazë të gjatësisë së kokës sipas shkallës Lebzelter-Saller

Popujt	Meshkuj	Femra	Autorët
Kosova (shqiptarët)	188.79 mm	180.14 mm	A. Rexhepi
Shqipëria e Jugut	177 mm	-	Po Kun
Franca	184 mm	-	Po Kun
Gjermania	188.8 mm	-	Braig
Greqia	189 mm	-	Po Kun
Serbia	182 mm	-	Po Kun
Rumunia transilvane	182 mm	175	Reiner
Bullgaria	189.02 mm	180.29 mm	M. Popov
Maqedonia	187.46 mm	179 mm	M. Popov

Tabela 2. Përcaktimi i kufijve minimal dhe maksimal, si dhe përcaktimi i vlerës mesatare të gjatësisë së kokës

Gjatësia e kokës	Lebzelter-Saller	Meshkujt		Femrat	
Kokë shumë e shkurtër	169	1	0.2%	7	3.6%
Kokë e shkurtër	170 – 177	19	3.4%	54	28.0%
Kokë e mesme	178 – 185	146	26.0%	97	50.3%
Kokë e gjatë	186 – 193	281	50.1%	33	17.1%
Kokë shumë e gjatë	194	114	20.3%	2	1.0%

Tabela 3. Gjatësia e kokës ndër popuj të ndryshëm

përqendrohet në kategorinë me kokë të gjatë, pjesa tjetër është e shpërndarë më tepër në kategorinë me kokë mesatarisht të gjatë (26%) dhe diçka më pak në kategorinë me kokë shumë të gjatë (20.3%). Entitetet e gjinisë femërore karakterizohen kryesisht me kokë të mesme (50.3%),

në të shkurtë (28%), dhe diçka më pak në kategorinë me kokë të gjatë (17.1%).

Nga të dhënat e tabelës nr. 2, vërejmë se vlera mesatare e gjatësisë së kokës, e llogaritur në numrin e përgjithshëm të entiteteve (veçantë për meshkuj dhe veçantë për femra),

tregon se meshkujt kanë kokë të gjatë (188.77 mm me variacione 168–209 mm), ndërsa femrat kanë kokë të mesme (180.14 mm me variacione 164–200 mm).

Nga të dhënat e tabelës nr. 3, mund të konstatojmë se meshkujt shqiptarë kosovarë, në ndryshoren gjatësia e kokës, tregojnë ngjashmëri më të madhe me entitetet e matura nga Gjermania se sa me entitetet e popujve të tjerë të prezantuar në këtë tabelë.^{3,9,13}

1. Coon, C. S. *The races of Europe*. 2nd Edition. Macmillan, New York, 1939. p. 293. Coon CS. *The mountains of Giants. A Racial and Cultural Study of the North Albanian Mountain Ghegs*. Cambridge – Massachusetts. p 105. (New edition: New York, 1970). 1950. Dhima, D. H. A. *Gjurmime antropologjike për shqiptarët*. Tirana, 1985. pp. 28-9, 106-12, 126-8. Drontçilov K. *Prinos kām antropologijata na Albancite. Periodichesko spisanie na Balgarskoto Knizhovno Druzheshvo*. 21:111-137. Sofija. 1921. Gavrilović Ž. *Antropološki podaci o osobama iz Dečana*. Glasnik ADJ 6:13-23. Beograd. 1969. Glück L. *Zur physischen anthropologie der Albanesen*. 1897. Günter HFK. *The racial elements of European history. Chapter VI part two*. London: Methuen and Company. 1927. Haberlandt, A. and Lebzelter V. *Zur physischen Anthropologie der Albanen*. Archiv für Anthropologie 45:123-142. 1919. Ivanovic, MB. *Morphological properties of Yugoslav population groups*. Beograd, 1990. Martin, R., Ober, W., Garrison, C., Welch, K., Hutchings, R.T. 2001. *Fundamentals of Anatomy and Physiology*, 5th ed. Prentice Hall, New Jersey. p. 195. McCulloch R. *The nordish race*. Accessed 15.03.2008. Available from: <http://www.racialcompact.com/nordishrace.html>. 2007. Pittard E. *Les peuples des Balkans*. First edition. p 84-85. Paris. 1916. Rexhepi, A. & Meka, V. *Cephalofacial morphological characteristics of Albanian Kosova population*. Int. J. Morphol., 26(4):935-940, 2008. Rexhepi, A. & Breslovci, B. *Neurocranial morphology of the albanian kosovo population*. Në prirje për tu publikuar në International Journal of Morphology, 2013. Tildesley ML. *The Albanians of the north and south*. Biometrika. 25:21-51. 1933. Ylli, A. *Disa të dhëna kranimetrike*. (in Albanian) Tirana, 1975. p.64-97.



Konferenca e Gjashtë Ndërkombëtare e Sekretariatit të Përgjithshëm të Myftinive dhe Institucioneve të Fetvasë në Botë

Nën patronazhin e presidentit të Republikës Arabe të Egjiptit, Abdulfettah al-Sisi, dhe organizuar nga Myftinia e Egjiptit dhe Sekretariati i Përgjithshëm i Myftinive dhe Institucioneve të Fetvasë në Botë, më 2 dhe 3 gusht, në Kajro, zhvilloi punimet konferenca e gjashtë me temë "Institucionet e fetvasë në kohën digjitale-sfidat e zhvillimit dhe mekanizmat e bashkëpunimit".

Në këtë Konferencë morën pjesë mbi 85 delegacione të institucioneve fetare nga shtete të ndryshme të botës. Në ditën e parë të Konferencës, një pjesë e kryesuesve të delegacioneve u pritën edhe nga presidenti i Republikës Arabe të Egjiptit, Abdulfettah al-Sisi.

Me ftesë të myftiut të Egjiptit, në Konferencë mori pjesë edhe kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ku në ditën e dytë u paraqit me kumtesë.

Kjo Konferencë, e para në përmasat e saja që nga fillimi i hapjes pas pandemisë, mblodhi krerët e institucioneve fetare dhe institucioneve të fetvasë në botë për të diskutuar dhe siguruar çështjen e fetvasë në ballafaqimin me sfidat e kohës digjitale.

Në sesionet, hulumtimet, diskutimet dhe punëtoritë e saj, Konferenca prezantoi çështjen e transformimit dixhital në institucionet e fetvasë dhe rëndësinë e saj, duke diskutuar dhe analizuar çështjet e futjes së institucioneve të fetvasë në epokën dixhitale dhe sfidat e aplikimit të dixhitalizimit në to, dhe si të merren përparësia e teknologjive moderne në ndërtimin e urave të bashkëpunimit ndërmjet këtyre institucioneve dhe jurisprudencës kolektive, veçanërisht në kontekstin e përdorimit të jurisprudencës në kohërat e pandemisë, siç është pandemia "Korona", dhe aktivizimi i fetvave kolektive në trajtimin e kësaj krize.

Në margjinat e sesioneve të Konferencës, u mbajt një grup trajnimesh dhe punëtorish ndërveprimi. Punëtorja e parë ishte: "Fetvatë dhe epoka dixhitale, si të futemi në këtë fushë?" Ky seminar diskutoi se si institucionet e fetvasë mund të përfitojnë nga teknologjia e informacionit, dhe identifikoi softuerin më të rëndësishëm të nevojshëm për institucionet fetva për të zbatuar transformimin dixhital, si dhe prezantoi disa institucione të fetvasë që patën sukses në transformimin dixhital dhe si përfituan nga ky zhvillim në fetva dhe menaxhim të procesit këshillues brenda tij.

Sa i përket punëtorisë së dytë, ajo ishte për të paraqitur rezultatet të indeksit global të fetvasë në vitin 2020/2021. Në këtë punëtori u diskutuan rezultatet e analizës krahasuese për katër vitet e fundit, si dhe u rishikuan përmes studimeve krahasuese të çështjeve të fetvave, po ashtu u bë edhe ofrimi dhe diskutimi rreth vizioneve që avancojnë diskursin e fetvasë. U diskutua edhe faza e dytë e punës së motorit të kërkimit elektronik të indeksit dhe bazat e të dhënave të tij, dhe seminari doli me një sërë rezultatesh dhe rekomandimesh që, nëse zbatohen, kontribuojnë për përmirësimin dhe zhvillimin e punës në sistemin e fetvave.

Punëtorja e tretë u zhvillua me titullin: "Trajnimi i Myftinjve nga distanca, një rrugë për kualifikimin e fetvasë duke përdorur teknologjinë dixhitale". Në këtë punëtori, përvoja e faqes së internetit "Përgatitja e Myftinisë në distancë" të egjiptianit Dar Al-Iftaa u prezantua si profesionisti i parë i specializuar që punon në përgatitjen dhe kualifikimin e myftinjve, duke kombinuar mes trajnimit të specializuar shkencor dhe trajnimit praktik mbi fetvanë dhe aftësitë e saj.

Konferenca e Gjashtë Ndërkombëtare e Sekretariatit të Përgjithshëm të

Myftinjve dhe Institucioneve të Fetvasë në Botë përfundoi aktivitetet dhe sesionet e saja. Në përfundim të saj, konferenca doli me një sërë rekomandimesh dhe vendimesh të rëndësishme që përfunduan përmes sugjerimeve të pjesëmarrësve nga studiuesit dhe hulumtuesit. Rekomandimet u nxorën si më poshtë:

1. Konferenca vlerëson përpjekjet e Sekretariatit të Përgjithshëm të Institucioneve të Fetvasë për të mbështetur bashkëpunimin dhe integrimin midis institucioneve të fetvasë dhe vlerëson iniciativën e saj për të nxjerrë në pah rëndësinë e transformimit dixhital në institucionet e fetvasë.
2. Konferenca mbështet fuqishëm nismat e saj efektive duke nxjerrë "Dokumentin e Bashkëpunimit dhe Integritetit të Fetvasë", duke hapur Qendrën "Salam" për studimet e ekstremizmit dhe duke filluar aplikimin elektronik global të fetvave "FatwaPro". Konferenca u bën thirrje të gjitha palëve të interesuara që t'i aktivizojnë këto nisma nga të gjitha anët.
3. Konferenca përgëzon përpjekjet e bëra nga vendet dhe institucionet për bashkëpunim dhe integrim në fushën e fetvasë, si mënyra më e mirë për të shfrytëzuar mesazhin e fetvasë dhe fetvanë në dobi të njerëzimit. Ajo thekson se nuk ka asnjë mënyrë për të zhvilluar fetvanë dhe përhap mesazhin e saj global, që bën thirrje për unitet njerëzor përballë pandemisë dhe krizave globale, përveçse me bashkëpunim dhe integrim midis të gjitha spektrave, nën parimet, vlerat dhe qëllimet e përbashkëta: "Dhe bashkëpunoni në drejtësi dhe devotshmëri, dhe mos

- bashkëpunoni në mëkat dhe agresion" (El-Maide, 2).
4. Konferenca përgëzon të gjitha përpjekjet që janë bërë në nivelin e botës islame dhe në nivel kombëtar për të zbatuar jurisprudencën kolektive në një mënyrë realiste, dhe konfirmon se njohja dhe vetëdijesimi për vendimin mbi çështjet e mprehta dhe komplekse, të cilat shfaqen si rrjedhojë e jetës bashkëkohore, mund të arrihet vetëm me një këshillim të madh, reflektim dhe konsultim juridik. Këto gjëra nuk mund të arrihen siç duhet, përveçse përmes këtij lloji të ixhtihadit. Ajo thekson se përpjekjet e bëra për të zbatuar ixhtihadin kolektiv në nivelin e botës islame ende kanë nevojë për mbështetje të madhe.
 5. Konferenca bën thirrje për rolin e fetvasë, organet dhe institucionet e saj, që të kujdesen për komitetet kolektive të fetvave dhe të përfshijnë specialistë në të gjitha shkencat e tjera, secili në çështjet që lidhet me specializimin e tij.
 6. Konferenca u bën thirrje të gjitha shteteve anëtare të Sekretariatit të Përgjithshëm të Myftinive dhe Institucioneve të Fetvasë në Botë, këshillave të jurisprudencës dhe organeve fetare që të shkëmbejnë përvoja në fushën e fetvave dhe të konsiderojnë "Dokumentin e Bashkëpunimit dhe Integritetit të Fetvasë" si një hartë e rrugës për këtë.
 7. Konferenca bën thirrje për ruajtjen e pasurive, aftësive të vendeve dhe sigurisë së tyre kombëtare, dhe duke marrë parasysh se çdo kërcënim ndaj këtyre aftësive është një kërcënim për paqen botërore.
 8. Ne theksojmë rëndësinë e përdorimit të teknologjisë dixhitale në fetva dhe institucionet fetvasë, pasi zvogëlon dhe shkurton kohën, zvogëlon hapësirat e ruajtjes dhe kontrollojnë fetvatë në institucione.
 9. Sekretariati nxit rolin e fetvasë, organet dhe institucionet e tij që të përfitojnë nga mjetet teknologjike moderne dhe aplikimet e tyre të zgjuara, qoftë në dhënien e fetvave, menaxhimin e institucioneve të fetvasë, apo për përballjen me idetë ekstremiste.
 10. Konferenca thekson rëndësinë e ndërtimit të aftësive shkencore dhe dixhitale të atyre që lëshojnë fetva dhe nevojën për bashkëpunimin e institucioneve të ndryshme në këtë drejtim për shkak të rëndësisë së saj në botën pas Koronës.
 11. Konferenca rekomandon krijimin e një njësie të dedikuar për transformimin dixhital të lidhur me Sekretariatin të Përgjithshëm të Myftinive dhe Institucioneve të Fetvasë në Botë, roli i të cilëve është të sigurojë mbështetje teknologjike dhe dixhitale për institucionet fetva në të gjitha nivelet materiale dhe njerëzore, dhe përmirësimin e vazhdueshëm të mekanizmave dhe programeve elektronike që lidhen me fetvatë dhe dhënien e fetvasë, dhe rekomandon përcjelljen e zhvillimeve globale në këtë drejtim dhe përfitimin prej tyre.
 12. Konferenca u bën thirrje të gjithë kërkuesve të fetvasë të përfitojnë nga platformat elektronike të fetvasë të ofruara nga institucionet e fetvave si një alternativë e përshtatshme në kohën e kësaj pandemie.
 13. Konferenca konfirmon thirrjen e saj drejtuar autoriteteve dhe institucioneve në fjalë që të marrin parasysh seriozisht atë që po ndodh në zonat e konfliktit në botë dhe të përpiqen të çrrënjoshin rrënjët e konfliktit dhe luftës dhe t'i ndalojnë ato, veçanërisht ato që thirren nga argumente sektare që nuk kanë bazë në të vërtetën.
 14. Konferenca u rekomandon studiuesve dhe studentëve të diplomuar në studimet e Sheriatit, shoqërore dhe humanitare që t'i referohen botimeve cilësore të prodhuara nga Sekretariati i Përgjithshëm dhe të ndërveprojnë me to dhe t'i pasurojnë ato me konsideratë dhe studim.
 15. Sekretariati i Përgjithshëm i Myftinive dhe Institucioneve të Fetvasë në Botë u rekomandon të gjithë myslimanëve, veçanërisht rekomandon çdo person të arsyeshëm që të respektojë në këtë periudhë të vështirë masat paraprake të vendosura nga vendi i tij, në mënyrë që njerëzimi ta kapërcejë këtë pandemi në paqe dhe siguri.
 16. Konferenca u bën thirrje Kombeve të Bashkuara që ta konsiderojnë pesëmbëdhjetë tetorin si Ditën Ndërkombëtare të Fetvasë.
 17. Sekretariati i Përgjithshëm i Myftinive dhe Institucioneve të Fetvasë në Botë u bën thirrje të gjitha vendeve dhe organizatave të vendosin mekanizma për të menaxhuar botën pas Koronës; Të përfshijë zhvillimin e sistemeve tradicionale të punës bazuar në praninë e elementit njerëzor dhe zhvillimin e mjedisit të punës të lidhur me vendin sa më shumë që të jetë e mundur, duke përfituar nga zhvillimi masiv dixhital, ai përfshin gjithashtu parashikimin e problemeve të përgjithshme që kërcënojnë njerëzimin dhe përgatitjen për t'u përballur me to, rishikimin e secilit vend, organizatë dhe institucion të nevojave të tij dhe tepricën e burimeve njerëzore, dhe bashkëpunimin ndërmjet të gjithëve në plotësimin e nevojave kombëtare dhe mbështetjen e nevojave globale. E gjithë kjo brenda kuadrit të paqes, sigurisë, dashurisë dhe harmonisë. *(Besim Mehmeti)*

Myftiu Tërnavë priti në takim një delegacion nga Forumi Musliman Evropian

Më 6 korrik, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim një delegacion nga Forumi Musliman Evropian (EMF), i kryesuar nga presidenti i tij z. Abdulvahed Niyazov.

Në këtë takim njohës, Myftiu Tërnavë i uroi mirëseardhje mysafirëve dhe më pas i njohu me punët dhe aktivitetet që zhvillon institucioni i Bashkësisë Islame të Kosovës për mirëqenien e të gjithë qytetarëve pa dallim. Ai më pas e njohu z. Niyazov me punën dhe angazhimin permanent që po tregon BIK-u në përballje me pandeminë globale COVID-19, si dhe për bashkëpunimin që kanë pasur me institucionet shtetërore në luftimin e kësaj sëmundje ngjitëse, në mënyrë që të tejkalohet sa më lehtë dhe më me pak pasoja.

Nga ana e tij, presidenti i Forumit Musliman Evropian (EMF), z. Abdulvahed Niyazov e falënderoi Myftiun



Tërnavë për mikpritjen dhe u shpreh se janë të impresionuar nga të arriturat që ka shënuar Kosova në periudhën e pasluftës. Ai më pas çmoi kontributin e BIK-ut në ndërtimin e institucioneve, si dhe për frymën e tolerancës

dhe harmonisë fetare që ka Kosova. Ai më pas tha se janë të gatshëm të bashkëpunojmë edhe në të ardhmen.

Në fund, Myftiu Tërnavë ia dhuroi emblemën e Kryesisë së BIK-ut z. Abdulvahed Niyazov. (R.S.)

Myftiu Tërnavë priti një grup deputetësh të Parlamentit të Kosovës



Më 7 korrik, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim një grup deputetësh të Parlamentit të Kosovës i përbërë nga Eman Rrahmani, Gramos Agusholli, Nijazi Isaku dhe Visar Korenica. Myftiu Tërnavë iu dëshiroi mirëseardhje deputetëve dhe i njohu ata me punën,

angazhimin dhe funksionimin e institucionit të BIK-ut dhe jetës fetare në përgjithësi.

Edhe deputetët falënderuan Myftiun Tërnavë për pritjen dhe njëherësh shprehën mirënjohjen për kontributin e Myftiut Tërnavë dhe të BIK-ut që Kosova të jetë një shtet ku respektohet liria, harmonia

e toleranca fetare dhe që komunitetet fetare të jetojnë në paqe dhe siguri të plotë, si dhe që Kosova të jetë shembull për harmoni e tolerancë fetare.

Në këtë takim po ashtu u theksua edhe mundësia e bashkëpunimit të përgjithshëm për të mirën e qytetarëve në përgjithësi. (R.S.)

Myftiu Tërnavë takoi kryetarin e LDK-së z. Lumir Abdixhiku



Më 7 korrik, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, ka zhvilluar një takim me kryetarin e Lidhjes Demokratike të Kosovës, z. Lumir Abdixhikun. Myftiu Tërnavë e uroi z. Abdixhikun për marrjen e detyrës në krye të LDK-së, duke vlerësuar kështu rolin

e kësaj partie ndër vite.

Kryetari Abdixhiku vlerësoi lart rolin e Bashkësisë Islame të Kosovës, duke falënderuar Myftiun Tërnavë për punën e tij dhe të institucionit të BIK-ut për promovimin e kulturës fetare dhe respektit të ndërsjellë ndërmjet besimeve dhe feve të ndryshme. Ai theksoi se Kosova

është një shembull i tolerancës etnike dhe fetare dhe ky mozaik është ndër pasuritë më të çmuara të popullit tonë.

Gjatë këtij takimi u diskutua edhe për mundësitë e bashkëpunimit ndërmjet Bashkësisë Islame të Kosovës dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës. (B.Z.)

Myftiu Tërnavë u prit në takim nga kryetari i Gjilanit z. Lufti Haziri

Më 7 korrik, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij dhe nga kryetari i Këshillit të BI-së së Gjilanit, ka zhvilluar një takim me kryetarin e komunës së Gjilanit, z. Lufti Hazirin.

Me këtë rast kryetari Haziri e falënderoi Myftiun Tërnavë për bashkëpunimin dhe realizimin e projekteve të përbashkëta për qytetarët, e sidomos në parandalimin e pandemisë Covid-19, kjo pasi që Kryesia e BIK-ut me KBI-në e Gjilanit në vijimësi kanë mbështetur komunitetin me projekte humanitare si dhe në infrastrukturë që lidhet me nevojat dhe kërkesat e qytetarëve, gjegjësisht besimtarëve.

"Specifikisht në fokus ishte çështja e Medresesë "Alaudin", paralelja fizike në Gjilan, ku biseduam rreth bashkëpunimit dhe integritetit të saj në përputhje me kërkesat e MASH-it, që të definohet statusi i saj. Komuna është e gatshme që t'i përmbush këto kërkesa dhe natyrisht që Kuvendi Komunal ka vendosur të ndaj një parcelë për nevojat e KBI të Gjilanit



dhe jemi në fazën finale të realizimit të saj. Po ashtu ju falënderoj për bashkëpunim dhe për pakot me ushqim të ndara për familjet me nevoja sociale"- tha kryetari Haziri.

Kurse nga ana e tij, Myftiu Tërnavë falënderoi kryetarin Haziri për pritjen dhe për bashkëpunimin e deritanishëm që kanë pasur.

"Dëshiroj të ritheksoj se BIK-u dhe Këshilli i BI-së në Gjilan i kanë pasur dyert e hapura gjithnjë për çdo kërkesë të besimtarëve që gravitojnë në këtë komunë. Gjilani është një shembull i mirë dhe model i

bashkëpunimit dhe ky shembull mund të ndiqet nga të tjerët. Ky bashkëpunim do të vazhdojë edhe më tutje dhe ne jemi gati që të bashkëpunojmë me Komunën në çdo fushë në të mirë të qytetarëve tanë që t'i zgjidhim problemet që kanë të bëjnë me besimtarët tanë dhe me ne. Sot me vete kam edhe drejtorin e Medresesë, kryeimamin e Kosovës, e bashkëpunëtorët e tjerë që jemi gjithnjë në shërbim të nevojave të qytetarëve tanë"- tha Myftiu Tërnavë. (R.S.)

Myftiu Tërnavë u prit në takim nga presidentja Osmani



Më 8 korrik, presidentja e Republikës së Kosovës, znj. Vjosa Osmani priti në takim kryetarin e Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiun Naim ef. Tërnavë. Presidentja Osmani theksoi rolin e rëndësishëm që BIK-u luan në promovimin e respektit të ndërsjellë

ndërmjet besimeve e feve të ndryshme në Republikën e Kosovës. Presidentja vlerësoi bashkëpunimin e mirë mes bashkësive fetare në promovimin e vlerave tradicionale të bashkëjetesës fetare. Presidentja Osmani potencoi në veçanti kontributin pozitiv të BIK-ut në përçimin e mesazheve tek

qytetarët e Kosovës në situatën e rëndë të përballjes me pandeminë. Myftiu Tërnavë e uroi Presidenten Osmani për marrjen e detyrës dhe i ofroi bashkëpunim dhe mbështetje në realizimin e projekteve në të mirë të qytetarëve të Republikës së Kosovës. (R.S.)

Myftiu Tërnavë takoi kryetarin e Prizrenit, z. Mytahir Haskuka



Më 8 korrik, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij dhe nga kryetari i Këshillit të BI-së së Prizrenit, ka zhvilluar një takim me kryetarin e Prizrenit, z. Mytahir Haskuka. Kryetari Haskuka vlerësoi lart rolin e Bashkësisë Islame të Kosovës, duke falënderuar Myftiun Tërnavë për

punën e tij dhe të institucionit të BIK-ut për promovimin e kulturës fetare dhe respektit të ndërsjellë ndërmjet besimeve dhe feve të ndryshme në veçanti për kontributin që Kosova të jetë një shembull i tolerancës etnike dhe fetare, që është një vlerë shumë e çmuar e popullit tonë. Kurse nga ana e tij, Myftiu Tërnavë falënderoi kryetarin Haskuka

për pritjen dhe për bashkëpunimin e deritanishëm që kanë pasur, duke nënvizuar se BIK-u dhe Këshilli i BI-së në Prizren kanë një bashkëpunim dhe rendim të mirë të aktiviteteve humanitare, sociale në interes të qytetarëve të komunës së Prizrenit dhe se ky bashkëpunim do të vazhdojë edhe më tutje. (R.S.)

Vendoset gurthemeli i xhamisë së re në Nikadin të Ferizajt

Më 10 korrik, nën këndimin e tekibireve dhe ajeteve kuranore në mënyrë solemne është vendosur gurthemeli i xhamisë së re në Nikadin të Ferizajt. Në këtë ceremoni mori pjesë kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, së bashku me Halid Abdullah nga "Qatar Charity". Me këtë rast Myftiu Tërnavë shprehu falënderime dhe mirënjohje për investitorin dhe shtetin e Katarit i cili po ndihmon vazhdimisht Kosovën në projekte që synojnë përmirësimin e jetës fetare në vend, duke mos anashkaluar edhe bamirësit e tjerë, qoftë nga vendi dhe diaspora që kanë ofruar ndihmë për përmirësimin e infrastrukturës së BIK-ut.

Myftiu Naim ef. Tërnavë, tha se Bashkësia Islame e Kosovës do të bëjë gjithçka çfarë mundet që të ndërtojë edhe xhami të tjera për të përmbushur kërkesat e besimtarëve dhe është e përkushtuar që të ndërtoj shumë e më shumë xhami sa herë që të jetë nevoja. BIK-u nuk është ndalur së ndërtuari xhami vetëm në Kosovë, por ka ndërtuar xhami edhe në Shqipëri dhe vende të tjera.

"Ky xhema kaq i mirë në Republikën tonë janë ata që kanë sakrifikuar dhe ndarë nga kafshata e tyre për ndërtimin e objekteve fetare. Nuk guxojmë të harrojmë dhe nuk do të ishim të drejtë t'i harrojmë vëllezërit tanë të cilët na kanë ndihmuar në ngritjen e infrastrukturës së BIK-ut, në ngritjen e xhamive, shtëpive, shkollave, spitaleve, ambulancave, e qendrave rehabilituese. Një prej atyre shteteve mike që s'kanë ngurruar asnjë herë është edhe shteti i Katarit" - tha Myftiu Tërnavë.

Nga ana e tij, Halid Abdullah nga "Qatar Charity" falënderoi BIK-un për bashkëpunimin, duke vënë në spikamë lumturinë e tij që po e fillojnë këtë projekt të ndërtimit të xhamisë. "Falënderoj BIK-un dhe Myftiun Tërnavë, i cili është gjithmonë i gatshëm për të bashkëpunuar si dhe të gjithë ata që kanë ndihmuar që të fillojmë këtë xhami.



Sot po ndjehem shumë i lumtur dhe njëherësh përcjell përshëndetjet nga Katari me këtë dhuratë modestë" - tha ai.

Edhe komuniteti i xhamisë së Nikadit u shprehën të lumtur dhe

falënderues që po fillon ndërtimi i xhamisë së re dhe me këtë rast në emër të tyre foli Ismet Idrizi ku falënderoi BIK-un dhe shtetin e Katarit. (R.S.)

Myftiu Tërnavë inspektoi punimet në xhaminë e Dushkajës së Kaçanikut

Më 10 korrik, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë me bashkëpunëtorë, inspektoi punimet që po zhvillohen në ndërtimin e xhamisë së re në Kaçanik. Me këtë rast, Myftiu Tërnavë pa nga afër punët që po kryhet dhe nga përgjegjësit u informua mbi ecurinë dhe mbarëvajtjen e punimeve. Ai nga kjo vizitë u nda i kënaqur dhe shprehu bindjen se ky objekt shumë shpejt do të finalizohet dhe se komuniteti i këtij vendi do të ndihet më mirë pasi që po ngrihet infrastruktura e objekteve fetare për të përmirësuar jetën dhe për të lehtësuar kryerjen e obligimeve fetare. Ai me këtë rast tha se BIK-u



do të vazhdojë edhe më tej me ofrimin e kushteve dhe me realizimin e projekteve, të cilat arrijnë nga këshillat e BI-së në mënyrë që xhemati ynë të ndihet mirë në kryerjen e obligimeve fetare.

Myftiu Tërnavë vizitoi kursin veror të mësim-besimit

Më 12 korrik, kryetari i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, vizituan kursin veror të mësim-besimit, i cili u mbajt në ambientet e medresesë së mesme “Alaudin” në Prishtinë.

Myftiu Tërnavë pa nga afër ecurinë dhe mbarëvajtjen e këtij kursi. Ai u njoh nga organizatorët me plan-programin dhe me zhvillimin e mësim-besimit në këtë kurs.

Myftiu Tërnavë përgëzoi të gjithë nxënësit pjesëmarrës në këtë kurs, duke ju dëshiruar atyre shëndet, suksese dhe mbarësi në jetën e tyre.

Fëmijët të cilët po marrin pjesë në këtë kurs u shprehën se, mësimi këtu u duket i lehtë për tu kuptuar.

Mësimi po u bëhet me atraktiv me aktivitetet shtesë dhe shujtën ditore që e marrin fëmijë brenda restorantit të shkollës



Myftiu Tërnavë priti në takim ambasadorin e BE-së në Kosovë, z. Tomas Szunyog

Më 13 korrik, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim ambasadorin e Bashkimit Evropian në Kosovë, z. Tomas Szunyog. Myftiu Tërnavë i uroi mirëseardhje ambasadorit, njëherësh e uroi për detyrën e re, duke i dëshiruar punë të mbarë dhe të suksesshme në këtë mision. Ai gjithashtu e falënderoi atë dhe nëpërmes tij edhe tërë Bashkimit Evropian për ndihmën dhënë Kosovës ndër vite. Myftiu Tërnavë më pas e njohu mysafirin me punët dhe angazhimin e institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës, si dhe me sfidat që ballafaqohet ky institucion. Nga ana e tij, ambasadori Szunyog, shprehu falënderime për pritjen dhe njëherësh përgëzoi



Myftiun Tërnavë dhe Bashkësinë Islame të Kosovës për kontributin e tyre që në Kosovë të mbretërojë paqja, respekti e toleranca ndërmjet

besimeve dhe etnive të ndryshme. Gjatë takimit u diskutua edhe për një sërë temash me rëndësi për qytetarët e Kosovës.

Myftiu Tërnavë vizitoi nxënësit në Akademinë e Hifzit



Më 13 korrik, Drejtoria Fetaro-Arsimore e Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, ka nisur projektin e ri për mësimin e Kuranit përmendsh për fëmijë. Në pritjen e organizuar për fëmijë, me rastin e regjistrimit të tyre në këtë akademi, qe i pranishëm edhe kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i cili uroi

dhe përgëzoi të gjithë nxënësit që kanë shprehur interesimin e tyre për t'u bërë pjesë e Akademisë së Hifzit, për ta mësuar përmendsh fjalën e Allahut. Ai para fëmijëve përmendi vlerën dhe rëndësinë që ka mësimi përmendsh i fjalës së Allahut. Kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, ka thënë se kjo iniciativë është një prioritet i

radhës i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës. Ai tha se mësimbesimi në përgjithësi dhe mësimi përmendsh i Kuranit, hifzi, mbeten përkushtimi i vazhdueshëm i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës. Ai përgëzoi të gjithë nxënësit për gatishmërinë e tyre për të qenë pjesëmarrës në këtë akademi.

Myftiu Tërnavë u prit në takim nga kryetari i Kuvendit të Kosovës z. Glauk Konjufca



Më 14 korrik, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, u prit në takim nga kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Glauk Konjufca. Myftiu Tërnavë

e përgëzoi kryekuvendarin Konjufca për detyrën e re, i uroi suksese dhe shprehu gatishmërinë për bashkëpunim e mbështetje. Kryekuvendari Konjufca e falënderoi Myftiun

Tërnavë për bashkëpunimin e ndërsjellë, duke vlerësuar sidomos kontributin e tij dhe të BIK-ut në parandalimin e përhapjes së COVID-19.

Myftiu Tërnavë priti në takim një delegacion nga Fondacioni i Dijanetit të Turqisë



Më 15 korrik, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim një delegacion nga Fondacioni i Dijanetit të Turqisë, i cili qëndroi për vizitë dy ditore në vendin tonë në vigjilje të festës së Kurban-Bajramit. Myftiu Tërnavë falënderoi Fondacionin e Dijanetit për ndihmat humanitare që kanë ofruar gjatë viteve, e sidomos për pakot

ushqimore që kanë dërguar gjatë Ramazanit të fundit, si dhe për ndihmat e tjera humanitare me të cilat janë mbështetur projekte të rëndësishme humanitare në vendin tonë përmes Bashkësisë Islame. Nga ana e tij, kryesuesi i delegacionit të fondacionit të Dijanetit, z. Jasin Dedesh, falënderoi Myftiun për mikpritjen dhe për bashkëpunimin e Bashkësisë Islame, në realizimin e

projekteve të përbashkëta humanitare, si dhe theksoi gatishmërinë e bashkëpunimit edhe në të ardhmen me projekte humanitare në Kosovë. Vlen të theksohet së Bashkësia Islame e Kosovës prej vitesh ka një bashkëpunim të ngushtë me Fondacionin e Dijanetit në mbështetje të projekteve të rëndësishme humanitare e fetare.

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës mbajti mbledhjen e rregullt të saj



Më 17 korrik, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, ka mbajtur mbledhjen e saj të rregullt, të kryesuar nga kryetari i saj, Myftiu Naim ef. Tërnavë. Rendi i ditës i kësaj mbledhje fokus

kryesor kishte përgatitjen për grumbullimin dhe prerjen e kurbaneve, si dhe për përgatitjet për manifestimin e festës së Kurban-Bajramit. Po ashtu në këtë mbledhje u shqyrtua edhe raporti

i aksionit “Sofra e Ramazanit”, i realizuar nga Shoqata Humanitare “Bereqeti”, si dhe u shqyrtuan dhe u morën vendime nga kompetencat e kësaj Kryesie.

Festohet Kurban-Bajrami

Më 20 korrik, besimtarët myslimanë kremtuan festën e Kurban-Bajramit, festë kjo e cila simbolizon sakrificën e besimtarëve ndaj Zotit dhe humanitetin ndërmjet njerëzve. Ceremonia kryesore e faljes së namazit të Kurban-Bajramit është mbajtur në Xhaminë e Madhe në Prishtinë, me mesazhe paqeje, solidariteti, harmonie dhe dashuri ndaj njëri-tjetrit. Para namazit të Bajramit, anëtari i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, Valon ef. Myrta mbajti një ligjëratë, ndërsa namazit të Kurban-Bajramit i priu kryeimami i Kosovës, Vedat ef. Sahiti, për të vazhduar më pas me hytben e Bajramit, të cilin e mbajti Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë. Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë nga hytbeja e Bajramit, këtë festë e quajti të veçantë për besimtarët. “Festa e Kurban Bajramit është një ndër momentet më të rëndësishme për besimtarët myslimanë, sepse vjen pas përfundimit të



haxhit në vendet e bekuara dhe therjes së kurbanit. Begati e rëndësishme e kësaj feste është edhe sofra e Bajramit, e cila na bashkon me më të dashurit tanë, na bën të reflektojmë për familjen e të afërmit tanë, dhe na ndërgjigjëson për ata që kanë nevojë për kujdesin dhe përkrahjen tonë. T’i shijojmë mirësitë e sofrës së Bajramit me dashuri e respekt, pranë familjeve tona, pranë farestit tonë, sepse s’ka

gjë më të rëndësishme në këtë botë sesa ruajtja e familjes dhe edukimi i saj i drejtë.”

Po ashtu, Myftiu Tërnavë në këtë hytbe foli edhe për rëndësinë e familjes, ku ndër të tjerash tha: “Për ne familja është e shenjtë, prej së cilës varet edhe vazhdimësia e jetës dhe e llojit njerëzor mbi tokë. Familje ose fole familjare është vetëm ajo e cila është ngritur nga martesë e një burri dhe një gruaje,

dhe kjo përbën një prej shtyllave më të rëndësishme të shoqërisë së shëndoshë islame dhe humane. Fortësia dhe qëndrueshmëria e saj është edhe fortësia dhe qëndrueshmëria e kombit dhe e shtetit. Si shoqëri kemi traditën shumë shekullore në kultivimin dhe ruajtjen e vlerave familjare që e kemi të trasuar nga të parët tanë. Mbështetja në familje na ka bërë të mundur që të përballemi me stuhi nga më të ndryshmet por ja kemi dalë gjithherë faqebardhë. Andaj, në këto kohë, nuk duhet tunduar pas nismave gjoja moderne për të dëmtuar familjen, aq më tepër kur gjatë historisë është dëshmuar se shoqëria jonë nuk



është shoqëri diskriminuese. Por, kur bëhet fjalë për të ardhmen e brezave, për familjen dhe për natyrshmërinë e njeriut, nuk

mund të heshtim e të tregohemi indiferent ndaj diçkaje që shkon kundër thelbit të jetës sonë dhe kundër vullnetit të Zotit.”


Pritje urimi për Kurban-Bajram

Në ditën e Kurban-Bajramit, në selinë e Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, për të uruar Myftiun Tërnavë dhe gjithë myslimanët për këtë festë, qenë në vizitë kryetari i Kuvendit të Kosovës, z. Glauk

Konjufca, ipeshkvi i Kishës Katolike, z. Dodë Gjergji, kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, z. Memli Krasniqi, kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, z. Lumir Abdixhiku, përfaqësuesi i Aleancës

për Ardhmërinë e Kosovës, z. Ahmet Isufi, ambasadori i Turqisë në Kosovë, z. Cagri Sakar, kryetari i Odës së Avokatëve të Kosovës, z. Behar Ejupi.





Myftiu Tërnavë priti në takim imamin Sabri ef. Jonuzi

Më 26 korrik, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga drejtori i Diasporës Ekrem ef. Simnica, pritën në takim imamin e Qendrës Shqiptare Fetare dhe Kulturore në Oslo të Norvegjisë, Sabri ef. Jonuzin. Me këtë rast, Myftiu Tërnavë shprehu falënderime për Sabri ef. Jonuzin dhe për Qendrën Shqiptare Fetare dhe Kulturore në Norvegji ne Oslo, por edhe për tërë diasporën që po ofrojnë ndihmë për Kosovën. Myftiu Tërnavë çmoi lart punën dhe angazhimin e kësaj Qendre. Ai edhe një herë përsëriti faktin se Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës vazhdimisht ka mbështetur dhe



mbështet mërgatën tonë kudo që gjenden ata. Nga ana e tij, Sabri ef. Jonuzi, falënderoi Myftiun Tërnavë

për pritjen, si dhe e njohu atë me aktivitetet dhe gjendjen e mërgatës sonë në Norvegji.

Myftiu Tërnavë priti në takim komandantin e KFOR-it, gjeneralmajorin Franco Federici



Më 27 korrik, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim komandantin e KFOR-it, gjeneralmajorin Franco Federici. Në këtë takim njohës, Myftiu Tërnavë i uroi mirëseardhje gjeneralmajorit Federici, duke i dëshiruar punë të mbarë dhe të suksesshme në misionin e tij. Ai më pas e njohu me punët dhe aktivitetet që zhvillon institucioni i Bashkësisë Islame të Kosovës për mirëqenien e të gjithë qytetarëve pa dallim. Myftiu Tërnavë

edhe njëherë shprehu mirënjohjen e tij për misionin dhe përkushtimin e forcave paqeruajtëse të KFOR-it, duke shprehur kështu vlerësimin dhe respektin e lartë që kanë qytetarët e Kosovës për ta.

Myftiu Tërnavë tha po ashtu se BIK-u ka një bashkëpunim shumë të ngushtë me KFOR-in, me të cilët kanë organizuar projekte humanitare të përbashkëta në të mirë të qytetarëve të Kosovës. Nga ana e tij, gjeneralmajori Franco Federici, falënderoi Myftiun Tërnavë për

pritjen dhe nëpërmes tij vlerësoi lart punën dhe angazhimin që ka Bashkësia Islame e Kosovës për mirëqenien e të gjithë qytetarëve, duke vlerësuar kështu harmoninë ndër-fetare, tolerancën dhe bashkëjetesën ndërmjet gjithë qytetarëve pa dallim. Ai shprehu gatishmërinë e tij dhe të KFOR-it për krijimin e sigurisë për të gjithë qytetarët dhe se bashkëpunimi mes BIK-ut dhe KFOR-it do të vazhdojë edhe më tej. (R.S.)

Myftiu Tërnavë vizitoi Luginën e Preshevës

Më 29 korrik, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka vizituar Luginën e Preshevës, ku u takua me personalitete fetare, politike e kulturore dhe qytetarë të shumtë të kësaj pjese. Fillimisht, Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, u prit nga kryetari i Këshillit të Bashkësisë Islame në Preshevë, Nexhmedin ef. Ademi dhe imamë të kësaj pjese, me të cilët diskutoi për sfidat dhe për mundësitë e përmirësimit të situatës në atë pjesë. Myftiu i Kosovës gjatë kësaj vizite u prit në takim edhe nga deputeti shqiptar në Kuvendin e Serbisë, z. Shaip Kamberi, ku rëndësi të veçantë iu kushtua unifikimit të shqiptarëve të kësaj pjese me qëllim të përmirësimit të jetës atje.



“Lugina duhet ta ketë një Bashkësi Fetare Islame. Të jetë ajo bashkësi e vetme që mbron interesin fetar islam në Luginë dhe të jetë ajo që vendos

për veten e saj. Në asnjë mënyrë nuk duhet të jetë në shërbim të askujt, përveç besimtarëve të kësaj pjese. Duhet ditur që të gjithë se Lugina

është pjesë e pandashme e gjymtyrëve të trupit tonë – pra duhet të ketë lidhje të vazhdueshme me Bashkësinë Islame të Kosovës”, tha Myftiu Tërnavë në konferencën për media pas takimit me deputetin shqiptar.

“Biseduam për problemet e shumta me të cilat përballen shqiptarët e Preshevës, për problemet politike, por edhe për ato të jetës së përditshme. Mes tjerash diskutuam edhe për një nevojë urgjente që përballlet Lugina e Preshevës, e që është unifikimi i spektrit fetar këtu në Luginë”, deklaroi deputeti Kamberi.

Vizitën më pas Myftiu Tërnavë e vazhdoi në Komunën e Preshevës, ku u prit nga kryetarja e kësaj komune, znj. Ardita Sinani. Ajo e quajti të domosdoshme vizitën e Myftiut Tërnavë në këtë kohë. “Unifikimi i spektrit politik dhe fetar është jashtëzakonisht i domosdoshëm dhe jetik në fazën dhe në situatën në të cilët gjendet Presheva. Andaj është domosdoshmëri e kohës që të jetësohet ky unifikim, kjo vizitë, e sidomos kur janë temat e rëndësishme”, deklaroi kryetarja Sinani pas takimit me Myftiun Tërnavë.

Në anën tjetër, Myftiu Tërnavë pas takimit me kryetaren e Komunës së Preshevës tha se besimtarët në Luginë të Preshevës çdoherë do ta kenë pranë Bashkësinë Islame të Kosovës.

“Shqiptarët e Luginës duhet të flasin me një zë që të mbrojnë interesat e shqiptarëve të kësaj zone, duke pasur parasysh specifikat që ka ky rajon. BIK-u asnjëherë nuk do të heq dorë nga kjo pjesë, pasi që e konsideron pjesë të trupit të saj, flas në aspektin fetar, ku gjithmonë do të jemi prezentë në mënyra të ndryshme”, u shpreh Myftiu Tërnavë pas takimit me kryetaren Sinani.

Pjesë e takimeve të Myftiut Tërnavë në Luginë të Preshevës ishte edhe diskutimi i frytshëm me kryetarin e Alternativës për Ndryshim, z. Shqiprim Arifi.

“Ka qenë kënaqësi të diskutojmë për zhvillimet pozitive të cilat kanë marrë një nismë dhe drejtim të mirë, e që është unifikimi i Bashkësisë



Islame në Luginë të Preshevës”, potencoi Shqiprim Arifi. Një vizitë tejet të këndshme, Myftiu Tërnavë e realizoi te familja e haxhi Alajdin Shemshedinit, familje kjo e cila në mënyra të ndryshme i ka kontribuar çështjes fetare dhe kombëtare në atë pjesë. Gjatë vizitës një ditore, Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, takoi edhe shumë qytetarë të tjerë nga të cilët u informua për problemet e

shumta dhe sfidat që janë instaluar për komunitetin shqiptar mysliman atje. Në fund të kësaj vizite, por që me rëndësi të madhe, Myftiu Tërnavë mori pjesë në ceremoninë e certifikimit të hafëzit Etem Etemi. Me këtë rast Myftiu Tërnavë po ashtu mbajti edhe një fjalë rasti ku mes tjerash tha se duhet që të jemi bashkë, të jemi unik e të kemi unitet.

Myftiu Tërnavë qëndroi në Kajro



Me ftesë të myftiut të Egjiptit, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, më 2 dhe 3 gusht, mori pjesë në Konferencën e organizuar nga Myftinia e Egjiptit dhe Sekretariati i Përgjithshëm i Myftinive dhe Institucioneve të Fetvasë në Botë me temën “Institucionet e fetvas në kohën digjitale-sfidat e zhvillimit dhe mekanizmat e bashkëpunimit” e cila u mbajt në Kajro. Myftiu Tërnavë në kumtesën e tij në Konferencë u fokusua dhe theksoi rëndësinë e ngritjes së kapaciteteve të institucioneve fetare me teknologjinë më moderne në kohën e digjitalizimit dhe sidomos përgatitjen dhe ngritjen e kapaciteteve të liderëve fetarë në përdorimin e teknologjisë informative dhe rrjeteve sociale, si dhe për përdorimin e platformave dhe aplikacioneve të reja për të përçuar mesazhin e vërtetë dhe mësimet e pastra islame, duke mos lënë hapësirën për grupet e ndryshme ekstreme, që të përhapin ideologjitë e tyre radikale përmes rrjeteve sociale.

Në këtë Konferencë morën pjesë mbi 85 delegacione të institucioneve fetare nga shtete të ndryshme të botës. Në ditën e parë të Konferencës, një pjesë e kryesuesve të delegacioneve u pritën edhe nga presidenti i Republikës Arabe të Egjiptit, Abdulfettah al-Sisi. Në këtë Konferencë, Myftiu Tërnavë u shoqërua nga kryeimami Vedat ef. Sahiti.

Po në këtë vazhde gjatë qëndrimit në Kajro, Myftiu i Kosovës Naim ef.

Tërnavë takoi ministrin algjerian për Çështje Fetare dhe Vakëfeve, prof. dr. Yusuf Belmahdi. Myftiu Tërnavë e njohu ministrin algjerian Belmahdi për organizimin e jetës fetare në Kosovë, për sfidat e vendit, e sidomos për zhvillimet pozitive që kanë ndodhur në Kosovë nga paslufta si dhe pas shpalljes së pavarësisë. Nga ana e tij, ministri Yusuf Belmahdi ofroi mundësinë e bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Çështjeve

Fetare të Algjerisë dhe Bashkësisë Islame të Kosovës, me theks të veçantë në fushën e arsimit, si dhe fusha të tjera të interesit të përbashkët.

Kurse më 5 gusht, Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, takoi ministrin sudanez të Çështjeve Fetare dhe Vakëfeve, prof. dr. Nasiruddin al Mufrihun. Myftiu Tërnavë e njohu ministrin sudanez për organizimin e jetës fetare në



Kosovë, për sfidat me të cilat ballafaqohet vendi, e sidomos për zhvillimet pozitive që kanë ndodhur në Kosovë nga paslufta dhe pas shpalljes së pavarësisë. Ministri Nasiruddin al Mufrihu, ftoi Myftiun Tërnavë që ta vizitojë Sudanin dhe të marrë pjesë në Konferencën e Ministrisë që ai drejton, e që do të mbahet në tetor të këtij viti në Khartoum të Sudanit. (R.S)



Myftiu Tërnavë priti në takim autorët e librit “Dijetarë shqiptarë në Perandorinë Osmane (1880-1912)”

Më 11 gusht, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim autorët e librit “Dijetarë shqiptarë në Perandorinë Osmane (1880-1912)”, z. Sadik Mehmeti, znj. Hatixhe Ahmedi dhe z. Ramadan Shkodra. Myftiu Tërnavë fillimisht i përgëzoi autorët për këtë vepër kaq të rëndësishme dhe domethënëse për historinë dhe kulturën tonë. Ai edhe njëherë ofroi përkrahjen e tij dhe të institucionit të Bashkësisë Islame për projektet e tilla për ndriçimin e të kaluarës



sonë. Ndërkaq, autorët e librit falënderuan edhe njëherë Myftiun Tërnavë për përkrahjen e

vazhdueshme dhënë për botimin e këtij libri, por edhe të librave të tjerë në përgjithësi.

Myftiu Tërnavë priti në takim dy mërgimtarë nga Gjermania

Më 12 gusht në Bashkësinë Islame të Kosovës, mysafirë ishin dy mërgimtarë nga diaspora.

Enver Bikliqi e Muharrem Berisha, ani pse në vitet e 70-ta, u larguan nga Kosova për në Gjermani, nuk e harruan kurrë vendlindjen.

Që nga ajo kohë, Bikliqi e Berisha u bënë donatorë të vazhdueshëm të Shoqatës “Bereqeti”. E të dy, në takim i priti i pari i Bashkësisë së Kosovës, Naim ef. Tërnavë. Pas takimit, u shprehën të lumtur për pritjen që iu bë në Bashkësinë Islame të Kosovës. Ndërkohë, Myftiu Naim Tërnavë përshëndeti dhe falënderoi të gjithë mërgimtarët



për kontributin e tyre. E për kontributin e tyre të vazhdueshëm gjatë gjithë këtyre viteve në ndërtimin e shtëpive për skamnorët

dhe ndihmën në format e tjera, për Bërishen e Bikliqin, Myftiu Tërnavë, ndau edhe nga një mirënjohje.

Urimi i Myftiut të Kosovës, Naim ef. Tërnavë, me rastin e Vitit të Ri Hixhri 1443

Të dashur vëllezër e motra,
Me rastin e Hixhretit- Vitit të Ri Hixhri, më lejoni që në emër të Bashkësisë Islame të Kosovës, institucioneve të saj dhe në emrin tim personal t'ju uroj e ta lus Zotin për mbarësinë, shëndetin, respektin e lumturinë tuaj.

Edhe sot e kësaj dite, myslimanët anekënd botës me krenari e urtësi kujtojnë Hixhretin e të Dërguarit të Allahut, nga Meka në Medinë, datë që shënoi një pikë kthese në historinë e Islamit dhe fillimin e kalendarit mysliman.

Hixhreti është dhe mbetet një frymëzim i fuqishëm në jetën e çdo myslimani, dhe mbart me vete mesazhin për sigurinë, lirinë dhe vlerën e atdheut.

Pejgamberi ynë i dashur Muhamedi a.s., na mësoi me shembullin e tij praktik se liria nuk i jepet askujt pa sakrificë dhe na mësoi se këto synime mund të arrihen vetëm



përmes sakrificës dhe forcës së besimit.

Kjo është arsyeja pse fillimi i vitit të ri hixhri është një mundësi për të rinovuar zotimin tonë ndaj Zotit dhe atdheut tonë.

Lus Allahun e Lartësuar që ky vit i ri hixhri 1443, të sjellë paqe e

mirësi mbi mbarë njerëzimin si dhe të sjellë harmoni në mesin tonë, duke na i bashkuar zemrat tona dhe duke nga forcuar në idealet për prosperitet e paqe.

Zoti na bekoftë të gjithëve!

*Myftiu i Kosovës
Naim ef. Tërnavë*

Myftiu Tërnavë ngushëlloi familjet e aksidentit të autobusit që ndodhi në Kroaci



Me dhimbje dhe ngashërim mora lajmin për aksidentin e një autobusi kosovar që ndodhi në Kroaci, e i cili po udhëtonte nga Frankfurti drejt Kosovës, në të cilin humbën jetën 10 persona dhe më shumë se 30 të tjerë u lënduan.

Në këto momente të rënda për popullin dhe vendin tonë, shpreh ngushëllimet më të sinqerta për

familjarët e viktimave, për të cilët lutem që Zoti t'ju japë durim në përballimin e dhimbjeve për humbjen e më të dashurve të tyre.

Bashkësia Islame e Kosovës me të gjitha institucionet e saja, do të jetë pranë familjeve të viktimave dhe të lënduarve, në shërbim të tyre dhe për të bashkëndjerë dhe bashkëndarë me ta dhimbjen.

Zoti i mëshiroftë shpirtat e atyre që pësuan në këtë aksident, Zoti i shëroftë të lënduarit sa më shpejtë, dhe dhashë Zoti që të mos ketë më tepër viktima!

*Me dhembshuri,
Myftiu i Kosovës
Naim ef. Tërnavë*

Kryeimami Sahiti u prit në takim nga Muhamed Mostafa Heider

Më 14 korrik, kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, u prit në takim nga ambasadori i Republikës Arabe të Egjiptit në Tiranë, shkëlqesia e tij, Muhamed Mostafa Heider. Kryeimami Sahiti e falënderoi ambasadorin Heider për pritjen, si dhe për gatishmërinë e tij për ta mbështetur avancimin në fushën e arsimit dhe të ngritjes profesionale të kuadrit fetar të Bashkësisë Islame të Kosovës nga ana e institucioneve të Egjiptit, siç janë Ministria e Vakëfeve, Myftinia e Egjiptit, si dhe nga Universiteti me renome botërore, Al-Az'har në Kajro.



Kryeimami Sahiti vizitoi Këshillin e Bl-së së Istogut

Më 16 korrik, kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, ka vizituar Këshillin e Bashkësisë Islame të Istogut, ku u prit nga kryetari Tahir ef. Bekaj dhe administrata e Këshillit. Kryeimami diskutoi me kryetarin Tahir ef. Bekaj mbi jetën fetare në komunën e Istogut në përgjithësi dhe mbi organizimin e mësim-besimit në veçanti. Kryeimami Sahiti pas vizitës së Këshillit të Istogut, mbajti hytben e xhumasë në fshatin Shushicë të Istogut dhe pas namazit bashkëbisedoi me këshillin e xhematit të xhamisë dhe me besimtarët e pranishëm.



Kryeimami Sahiti priti në takim znj. Vjollca Aliu dhe Sehadin Shok

Më 26 korrik, kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës Vedat ef. Sahiti, ka pritur në takim znj. Vjollca Aliu, drejtore të Departamentit të Trashëgimisë Kulturore pranë MKRS-së dhe Sehadin Shok nga UNDP-ja, me të cilët diskutoi mbi projektin "Trashëgimia kulturore si nxitëse e dialogut ndërmjet komuniteteve dhe kohezionit social" e cila financohet nga zyra e BE-së.

BIK në bashkëpunim me MKRS dhe UNDP/EU, pritet të realizojë disa projekte me rëndësi për trashëgiminë kulturore islame të Kosovës gjatë vitit 2021-2023.



Kryeimami Sahiti vizitoi disa këshilla të BI-së

Në vazhden e vizitave të rregullta nëpër këshillat e BI-së, më 24, 25 dhe 26 gusht, kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, i shoqëruar nga zëvendësi i tij, Fatmir ef. Iljazi dhe nga zyrtari për shërbime fetare dhe regjistrim të vakëfeve, Abedin ef. Sadriu, vizituan këshillat e Bashkësisë Islame të Deçanit, Istogut, Lipjanit, Gjilanit, Kamenicës dhe të Vitisë.

Në këto takime të ndara, kryeimami Sahiti u mirëprit nga kryetarët e këtyre këshillave, nga të cilët u informua rreth punës dhe aktiviteteve të këtyre këshillave. Ai edhe një herë rikonfirmoi mbështetjen dhe përkrahjen e Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës për punën dhe mbarëvajtjen e aktiviteteve të tyre.

Theks të veçantë kishte vizita në Këshillin e BI-së së Deçanit, ku kryeimami Sahiti e njohu kryetarin Rasim ef. Bytyqi, për zhvillimet e fundit në lidhje me realizimin e projektit të restaurimit të xhamisë në fshatin Drenoc. Ai tha se punimet e restaurimit dhe rikonstruimit të kësaj xhamie të djegur vite më parë, do të fillojnë shumë shpejt. Xhamia e Drenocit është në listën e përkohshme të monumenteve të trashëgimisë kulturore në Kosovë.



Kryeimami Sahiti takoi ambasadorin Kiçmari

Më 27 gusht, kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, u prit në takim nga drejtori i përgjithshëm i Akademisë Diplomatike të MPJD-së, ambasadori z. Sabri Kiçmari.

Gjatë takimit u diskutua për mundësinë e bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve, sidomos në fushën e promovimit të kulturës së bashkëjetesës dhe tolerancës ndërfetare të kombit, si dhe në fushën e promovimit të trashëgimisë kulturore të vendit tonë.

Ambasadori Kiçmari e falënderoi kryeimamin Sahiti për kontributin e Bashkësisë Islame të Kosovës në kultivimin e traditës së bashkëjetesës e tolerancës, si një nga vlerat më të çmuara të kombit tonë.



Në fund të takimit, kryeimami Sahiti i dhuroi ambasadorit Kiçmari librin e fundit të botuar nga Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës

“Dijetarët shqiptarë në Perandorinë Osmane (1880-1912)” sipas dokumenteve të Meshihatit të Lartë Osman.

Drejtori Simnica priti në takim z. Mentor Janovën

Më 16 korrik, drejtori i Diasporës në Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës, Ekrem ef. Simnica, ka pritur në takim anëtarin e Kryesisë së xhamisë “El-Furkan” në Duisburg të Gjermanisë, z. Mentor Janova. Drejtori Simnica e falënderoi z. Janova dhe nëpërmes tij tërë mërgatën tonë shqiptare që gjendet në diasporë për kontributin e tyre dhënë për mirëqenien dhe jetën e përgjithshme fetare të shqiptarëve atje. Ai shprehu gatishmërinë e tij, por edhe të institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës që bashkëpunimi i



mirë që ka mbretëruar deri më tani, ndërmjet BIK-ut dhe diasporës të vazhdojë edhe më tutje. Në këtë takim gjithashtu u

bisedua rreth shtimit të koordinimit me këtë qendër, por edhe me qendrat e tjera në Gjermani.

Drejtori Simnica priti në takim z. Lutfi Ejupin

Më 28 korrik, drejtori i Diasporës në Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës, Ekrem ef. Simnica, së bashku me kryeimamin e Kosovës, Vedat ef. Sahitin, kanë pritur në takim anëtarin dhe aktivistin e Xhamisë së Bardhë – “Veisse Moschee” të



Zvicrës, z. Lutfi Ejupin. Drejtori Siminca e falënderoi z. Ejupin dhe nëpërmes tij tërë mërgatën tonë shqiptare që gjendet në diasporë për kontributin e tyre dhënë për mirëqenien dhe jetën e përgjithshme fetare të shqiptarëve atje. Ai shprehu gatishmërinë e tij, por edhe të institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës që bashkëpunimi i mirë që ka mbretëruar deri më tani, ndërmjet BIK-ut dhe

diasporës të vazhdojë edhe më tutje. Në këtë takim gjithashtu u bisedua rreth shtimit të koordinimit me këtë qendër, por edhe me qendrat e tjera në Zvicër. Po ashtu, më 27 korrik, drejtori Simnica, ka pritur në takim ushtruesin e detyrës së kryetarit të xhamisë “Ikra” në Siegen të Gjermanisë, z. Faton Sallahun. Drejtori Siminca e falënderoi z. Sallahun dhe nëpërmes tij tërë

mërgatën tonë shqiptare që gjendet në diasporë për kontributin e tyre dhënë për mirëqenien dhe jetën e përgjithshme fetare të shqiptarëve atje. Ai shprehu gatishmërinë e tij, por edhe të institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës që bashkëpunimi i mirë që ka mbretëruar deri më tani, ndërmjet BIK-ut dhe diasporës të vazhdojë edhe më tutje.

Kryesia e BIRK-së takoi mërgimtarët

Më 3 gusht, Drejtoria për Diasporë në Kryesinë e Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës organizoi takim me mërgatën tonë në ambientet e medresesë së mesme “Alauddin” në Prishtinë. Në këtë takim përveç përfaqësuesve të xhamive dhe komuniteteve islame shqiptare nga diaspora, morën pjesë sekretari i përgjithshëm i Kryesisë së BIK-ut Ahmet ef. Sadriu, drejtori i Medresesë “Alauddin” Fadil ef. Hasani, drejtori për Diasporë mr. Ekrem ef. Simnica, drejtori i Institutit për Hulumtime dhe Studime Islame, Sabri ef. Bajgora etj.

Në emër të Kryesisë dhe Myftiut Tërnavë, të pranishmit i përshëndeti sekretari i përgjithshëm i Kryesisë së BIK-ut Ahmet ef. Sadriu. Ai përshëndeti këtë takim që tashmë është bërë tradicional dhe falënderoi mërgimtarët për gjithë kontributin dhe rolin para, gjatë dhe pas luftës, para dhe pas shpalljes së pavarësisë dhe sot e kësaj dite, si dhe shfaqti bindjen se këto takime tradicionale do të vazhdojnë dhe se lidhjet dhe bashkëpunimi e koordinimi do të shtohet edhe më tej, pasi që BIK-u tashmë ka edhe Drejtorinë e Diasporës që mban kontakte të vazhdueshme me qendrat islame nëpër Evropë edhe gjetiu dhe do të jenë të gatshëm t’i ndihmojnë me kuadro e literaturë.

Drejtori për diasporë mr. Ekrem ef. Simnica të pranishmëve iu dëshiroi mirëseardhje dhe iu



dëshiroi qëndrim të këndshëm në vendlindje. Ai i falënderoi të gjithë pjesëmarrësit në takim-dreke, të gjithë imamët, kryetarët e xhamive si dhe përfaqësuesit e aktivistët e tyre që na nderuan me pjesëmarrjen e tyre nga Diaspora. Ai veçoi punën, kontributin dhe sakrificën që ka bërë dhe po bënë mërgata për vendlindje para dhe pas luftës në Kosovë. Kontributi i mërgatës sonë është shumë i madh si në edukimin e fëmijëve, por edhe në udhëzimin e shumë vëllezërve tanë që jetojnë atje dhe themelimi i shumë qendrave islame në mërgatë që mundohen të ofrojnë popullatën tonë të jenë të lidhur me njëri tjetrin. Ai po ashtu tha se BIK-u ka vëmendje të veçantë për mërgatën duke premtuar se do të jetë në

shërbim të mërgatës sonë. Ai në fund ka ftuar mërgatën që të jenë më unik, bashkë, dhe të punojmë për një të ardhme sa më të mirë dhe se ata janë pjesë thelbësore të zhvillimit të qëndrueshëm të Kosovës.

Më pas nga një fjalë rasti në emër të mërgatës mbajtën nënkryetari i Komunitetit Mysliman Shqiptar të Zvicrës, Feim ef. Abazi, nga Unioni i xhamive shqiptare në Gjermani Besnik ef. Kadriolli, prof. Elez ef. Osmani nga Nju Jorku, Adnan ef. Bërbatovci imam nga Toronto e Kanadasë, Avni Dobra imam në Bruksel, të cilët njëzëri theksuan edhe njëherë nevojën dhe domosdoshmërinë që të ndih-mohet dhe përkrahët BIK-u me të gjitha institucionet e saj, dhe se këtë e



kanë borxh sepse në këtë medrese janë edukuar e shkolluar e formuar në aspektin fetar.

Në fund mërgimtarët shprehën falënderime për BIK-un që organizoi këtë tubim dhe shprehën

bindjen se në të ardhmen edhe më shumë do të koordinohen punët në të mirë të përbashkët. Drejtori për Diasporë Ekrem ef. Simnica në fund të këtij takimi shpërndau disa mirënjohje për kontributin që janë

duke dhënë xhamitë dhe qendrat shqiptare islame për BIK-un. Krejt në fund u shtrua një drekë në shenjë nderi dhe respekti për diasporën. (R.S.)

Departamenti i Gruas organizoi tryezë diskutimi

Më 28 korrik, Departamenti i Gruas në Kryesisë e Bashkësisë Islame të Kosovës organizoi një tryezë diskutimi me përfaqësuesit e Policisë së Kosovës, toger Ismet Koca, Myrvete Ribari dhe Qëndresa Ramadani. Në këtë tryezë u diskutua puna dhe kontributi i Departamentit të Gruas gjithandej Kosovës dhënë për paqe dhe siguri. Një fokus i veçantë iu dha koordinimit të aktiviteteve të Departamentit të Gruas dhe Policisë së Kosovës për parandalimin e dukurive negative në shoqëri, si dhe për krijimin e një ambienti më të qetë në familjet dhe shoqërinë tonë.



Hytbe për vaksinimin e popullatës

Më 23 korrik, në kuadër të ligjëratës së ditës së xhuma iu bë thirrje xhematit (dhe nëpërmes tyre familjarëve të tyre) që t'i përgjigjen thirrjes së Qeverisë së Kosovës për vaksinim kundër virusit Covid-19, si masë parandaluese kundër infektimit me variantin e ri të virusit Korona, të ashtuquajtur varianti indian Delta, i cili paraqet rrezikshmëri shumë më të lartë për shëndetin se sa ai aktual. Duhet theksuar se kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë është



vaksinuar me 16 korrik, duke u bërë pjesë e qytetarëve që po luftojnë Covid-19. Ai ka apeluar

njëkohësisht te të gjithë qytetarët e Kosovës që t'i bashkohen 'luftës' kundër këtij virusi.

Në të gjitha xhamitë e Kosovës u mbajt hytbe kundër dhunës ndaj femrës

Më 27 gusht, me rekomandim të kryetarit të Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiut Naim ef. Tërnavë, sot në të gjitha xhamitë e Kosovës u mbajt hytbe e përbashkët me temë: "Angazhimi familjar dhe kolektiv për luftimin e dhunës ndaj femrës". Në mesazhin e hytbesë së kësaj të premteje, u theksua dhe u shpjeguan argumentet fetare pse jemi të obliguar edhe fetarisht për kujdesin ndaj kësaj çështje. Më tej u theksua se vrasja e një vajze të re në Ferizaj nga bashkëshorti i saj ishte lajmi që tronditi shoqërinë tonë këtë javë që veç po e lëmë pas. Si institucion fetar që jemi, e dënojmë ashpër këtë krim të rëndë dhe kërkojmë nga autoritetet që të marrin masat e duhura, në mënyrë që rastet e tilla të mos përsëriten. Po kështu, kërkojmë nga shoqëria civile, që, bashkërisht, të punojmë për ngritjen e vetëdijes shoqërore dhe se kjo dhunë është e pajustificueshme. Dhuna, parimisht, është e refuzuar, sepse, duke se Allahu xh.sh., nuk ia ka lejuar as vetvetes, atëherë ajo askujt nuk i lejohet. Allahu xh.sh., thotë: "... mos tejkaloni kufirin! – Se, Allahu, nuk i do ata që e kalojnë kufirin." (El Bekare, 190). Kurse në një hadith kudsij thotë: "O robërit e Mi! Unë ia kam ndaluar Vetes Sime padrejtësinë dhe të tillë e kam caktuar në mesin tuaj, andaj mos i bëni njëri tjetrit padrejtësi!". Për këtë shkak, Pejgamberi a.s.thoshte: "O Allahu im, unë i deklaroj rreptësisht të paprekshme të drejtat e dy të dobëtëve: jetimit dhe gruas."

Se dhuna ndalohet flasin edhe shumë argumente tjera, të cilat parimore i shohin respektin, nderimin dhe vlerësimin femrës, jo dhunën ndaj saj. Allahun xh.sh., thotë: "Dhe një prej shenjave të Tij është që prej jush krijoi për ju bashkëshortet tuaja, që të qetësoheni pranë tyre, duke vënë ndërmjet jush dashuri dhe mëshirë. Me të vërtetë, në këtë ka shenja, për njerëzit që mendojnë." (Rrum, 21). Më tej në këtë hytbe u theksua se çështja tjetër që konsiderojmë se duhet të trajtohet



dhe të merret me seriozitet, edhe për faktin se vazhdimisht po listohet si një ndër shkaqet kryesore të shfaqjes së fenomeneve negative, veçmas tek të rinjtë, është roli në zbehje i prindërve në edukimin e fëmijëve të tyre. Kurani na urdhëron që të kujdesemi për familjen: "O ju që besuat, ruajeni veten dhe familjen tuaj prej një zjarri, lëndë djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët..." (Tahrim, 6)

Këtë përgjegjësi në edukimin e fëmijëve na e kujton edhe Muhamedi a.s., i cili thotë: "Të gjithë ju jeni kujdestarë dhe të gjithë ju do të përgjigjeni për ata që kanë qenë në përgjegjësinë tuaj."

Në fund të kësaj hytbeje u përçua mesazhi se duhet të ketë bashkëpunim ndërinstitutional për edukimin e fëmijëve. Edukimi i fëmijëve nuk është vetëm përgjegjësi e prindërve, por është përgjegjësi edhe e shoqërisë, respektivisht institucioneve tona edukativo-arsimore. Fakti se kohëve të fundit janë shfaqur kaq shumë dukuri negative në mesin e fëmijëve tanë, duhet të na alarmojë të gjithëve, dhe të na vë në lëvizje për të gjetur zgjidhjet më të mira për këto dhe

probleme të ngjashme që për bazë kanë edukimin. Prindërit, duhet të jenë në vijën e parë të frontit dhe për asnjë moment të mos ndalen së punuari me fëmijët e tyre, derisa shteti duhet të ndërtojë politika arsimore-edukative që në fokus kanë jo vetëm arsimimin, por mbi të gjitha edukimin e fëmijëve. E patjetër këtu një rol ta pazëvendësueshëm kanë prijësit fetarë të komuniteteve fetare në Kosovë, që me këshillat e tyre mund të asistojnë shumë në ruajtjen e karakterit dhe personalitetit të fëmijëve në secilën etapë të zhvillimit të tyre. E kemi thënë sa e sa herë dhe do ta përsërisim se zgjidhja më e mirë është edukimi fetar. Asgjë nuk mund ta zëvendësojë edukimin fetar. Çdo vonim në aprovimin e edukimit fetar në shkollë është me pasoja. Ndaj, le të jetë kjo një thirrje për institucionet tona qeverisëse që ta marrin në konsideratë futjen e edukatës fetare në shkollë, ashtu siç veprojnë një numër i madh i shteteve në perëndim. Le të jetë ky një mesazh i yni kundër këtyre dukurive negative që po prekin fëmijët tanë! (R.S)

Mbahet tryezë tematike për Hixhretin



Më 18 gusht, Këshilli i Bashkësisë Islame në Gjakovë, ka organizuar tryezë tematike për Hixhretin me temën "Hixhreti, rrethanat historike dhe frymëzimet civilizuese"

Në këtë tryezë morën pjesë prof. asoc. dr. Fahrush ef. Rexhepi, dekan i Fakultetit të Studimeve Islame, prof. Sabri ef. Bajgora, drejtor i Institutit për Hulumtime dhe Studime Islame si dhe dr. Valon ef. Myrta, kryetar i Këshillit të BI-së në Gjakovë. Në këtë tryezë u diskutua për zhvillimet e kësaj ngjarje, mësimet e nxjerra dhe frymëzimet nga ngjarja e Hixhretit.

Prof. Fahrush ef. Rexhepi, duke shpjeguar mesazhet që bartë në vete, ku ndryshim i rrjedhave të historisë, tha se ishte një paralajmërim për vuajtjet dhe sfidat që do t'i përjetojë përgjatë udhëtimit të tij

nga kundërshtimet dhe rekcionet e mushtrikve kurejsh. Andaj ajete të shumta flasin për Muhamedin a.s. që të tregohet i durueshëm përballë ndodhjeve që janë para tij, jo për shkak të satisfakcionit, por për hir të Zotit xh.sh. dhe për hir të së vërtetës. Andaj ishin sfida në vete që me një besim e përkushtueshmëri, mysli-manëtnëndheqjenë Muhamedit a.s. iu bënë ballë dhe kanë arritur që t'i tejkalojnë. Ndërkaq, prof. Sabri ef. Bajgora, duke potencuar mesazhin dhe ndikimin e Hixhretit në vetë rrjedhën e Islamit, tha se kjo ngjarje parë nga koncepti islamë duhet parë dhe kuptuar si një zgjim dhe lëvizje me plotë energji pozitive për të demonstruar gatishmërinë e sakrifikimit drejt të së vërtetës. Kjo ngjarje duhet regjistruar si një nxitje

që buron nga ndjenja e thellë e besimit dhe dashurisë ndaj të vërtetës. Hixhreti nuk ishte ikje nga beteja, por ecje e guximshme në arenën e betejës së jetës për ta sfiduar të pavërtetën, pavlerën dhe tiraninë. Valon Myrta thekoi se Hixhreti i Profetit na mëson se kudo që të shkojnë myslimanët, ata duhet të sjellin mirësi në atë vend, duhet të punojnë për mirësinë morale dhe materiale të shoqërisë. Islami kërkon që besimtarët të ndihmojnë dhe mbrojnë njerëzit e cenueshëm dhe ofron një numër mekanizmesh për kujdesin dhe mbështetjen e tyre. Për më tepër, është detyrë e myslimanëve të pranojnë dhe mbrojnë refugjatët për aq kohë sa ata kërkojnë mbrojtje. (R.S.)

Kryeimami Sahiti vizitoi për ngushëllime familjen Osmani

Më 25 gusht, kryeimami i Kosovës, Vedat ef. Sahiti, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij dhe nga kryetari i Këshillit të BI-së së Ferizajt, Fehmi ef. Mehmeti qëndruan për vizitë ngushëllimi në familjen Osmani në Ferizaj. Kryeimami Sahiti në emrin e Myftiut Tërnavë dhe në emër të institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës, shprehu ngushëllime për vrasjen e Marigona Osmanit, duke lutur Zotin që ky rast i dhunës të jetë i fundit dhe se ngjarjet e tilla të mos përsëriten asnjëherë në vendin tonë, si dhe bëri apel që



drejtësia të vihet në vend për këtë ngjarje.

Ai bëri lutje që të ndjerën ta ketë marrë Zoti në mëshirën e Tij

Shpërndahen dhurata për fëmijë në prag të Kurban-Bajramit

Më 17 korrik, Shoqata Humanitare “Bereqeti” dega në Prishtinë, për nder të festës së Kurban-Bajramit ka gëzuar mbi 200 fëmijë me dhurata. Një ditë para kësaj feste, fëmijët të cilët u bënë pjesë e kursit veror dhe fëmijët në disa çerdhe pranuan dhurata në prag të kësaj feste. Zëvendëskryeimami i Këshillit të BI-së në Prishtinë, Idriz ef. Xhigolli, tha se festa e Bajramit është veçantë për fëmijë, andaj me këto dhurata simbolike po synohet t’u zbukurohet edhe më shumë kjo festë. Në anën tjetër, koordinatori i “Bereqetit” në Prishtinë thotë se është në ndjenjë e veçantë kur sheh gëzimin në fytyrat e fëmijëve.



Përfundoi me sukses kursi veror i mësim-besimit në Prishtinë

Më 29 korrik, në objektin e medresës së mesme “Alauddin” në Prishtinë, u mbajt programi përmbyllës i kursit veror, i organizuar nga Këshilli i Bashkësisë Islame të Prishtinës. Së bashku me nxënësit, të pranishëm në këtë program ishin edhe prindërit e tyre. Këta të kënaqur, i dëgjuan disa pika recitimi, të përgatitura nga fëmijët e tyre. Ky program filloi me

këndimin e Kuranit, leximin e të cilit e mësuan për një muaj. Se kursi veror, u realizua me sukses, e thonë edhe organizatorët. Kryeimami i Këshillit të Bashkësisë Islame në Prishtinë, Burhan ef. Hashani, tha se ky kurs arriti t’i përmbush të gjitha pikat e parapara në plan program. Nxënësja Ruvejda Kaciu, tha se pjesëmarrja në këtë kurs ishte interesante dhe zbavitëse për të.

Nxënësit u shprehën se edhe në të ardhmen, mësimet e tyre do t’i ndjekin në këtë shkollë. E për të arriturat e tyre gjatë këtij muaji, nxënësit edhe u shpërblyen. Secili nga ta, në këtë ceremoni përmbyllëse mori dhuratë dhe u pajisë me certifikatë për përfundimin e kursit. Shpërblimet e tilla u shpërndanë nga vetë mësuesit si dhe nga aktori i dashur nga fëmijët Dardan Gashi.



Tradita e mësim-besimit në Opojë



Këshilli i Bashkësisë Islame Dragash, ka zhvilluar një mori aktivitete në mësim-besim, falë punës së palodhshme të imamëve në teren, duke i përmbyllur tri hatme të Kuranit në këto xhami.

Më 11 korrik 2021, Xhevat ef. Fetahi imam i xhamisë “Mehmet Kuklibegu”, në Bresanë nxori me sukses tri grupe me 36 nxënës që kanë bërë hatme Kuranin si vijon: Grupi i parë prej 18 nxënës kanë bërë hatme për herë të parë, grupi i dytë prej 13 nxënësve kanë bërë hatme për herë të dytë, dhe grupi i tretë 5 nxënës kanë bërë hatme për herë të tretë. Nxënësit që kanë bërë hatme janë: Amina Maliqi, Ajna Reshiti, Ajshe Shyqeriu, Blerina Iseni, Blerina Maliqi, Blerta Iseni, Endrit Hasani, Enes Rysheni, Erhona Ademi, Hamide Miftari, Lejla Jakupi, Pranvera Nuhiu, Reshit Reshiti, Sara Tosuni, Suada Aliu, Sumea Shabani, Shpetim Rexhepi, Xhenisa Sinani, Hafsa Fetahi, Melisa Milaimi, Semina Reshiti, Semra Tosuni, Ylli Nebiu, Admir Hasani, Anisa Kamberi, Eldin Sinani, Erina Nebiu, Ferdi Sinani, Rumejsa Misinaj, Semina Abdurrahmani, Suhejb Qazimi, Suhejb Reshiti, Suhejla Qazimi, Ylli Salihu, Yllza Rysheni, Yzer Hajdari. Këshilli i Bashkësisë Islame në Dragash, i ka pajisur të gjithë nxënësit me certifikata për përfundimin me sukses të hatmes.



Në këto solemnitete kanë prezantuar edhe stafi i Këshillit të Bashkësisë Islame në Dragash.

Më 16 korrik 2021, para namazit të xhumasë, imami i xhamisë në fshatin Zgatar, Urim ef. Jusufi përfundoi hatmen e Kuranit me 12 nxënës dhe me program të larmishëm, duke demonstruan mësimet e tyre mbi leximin e Kuranit fisnik. Nxënësit që kanë bërë hatme janë: Drenusha Asllani, Kanita Ajdini, Floriana Ibrahim, Erina Ferati, Esmë Mustafa, Fatima Ibrahim, Muela Ramadani, Diana Ramadani, Ela Asllani, Fatlinda Ibrahim, Learta Jusufi, Alea Asllani.

Me 17 korrik 2021, pas namazit të drekës në xhaminë e fshatit Blaç, nga nxënësit e imamit të kësaj xhamie Xhafer ef. Nebiu është dhënë një program me rastin e përfundimit të hatmes së Kuranit famëlartë nga 24 nxënës, prej tyre 12 vajza dhe 12 djem. Nxënësit që

kanë bërë hatme janë: Lejla Jusufi, Elona Jusufi, Erda Sylejmani, Alejna Miftari, Eljesa Hajredini, Figena Karimani, Hysnije Ramadani, Yllka Jusufi, Esra Shaniu, Esra Hyseni, Ylmiye Hyseni, Maida Iljazi, Suad Latifi, Erdi Ramadani, Adis Halimi, Dren Rakipi, Rajan Iljazi, Mehdi Meleqi, Jasin Isufi, Arjanit Meleqi, Besmir Isufi, Omar Jusufi, Amir Nebiu, Ardan Ejupi. (Xh. Fejziu)

Dhurohen 10 ari truall vakëf për KBI-Kaçanik

Më 13 korrik, Këshilli i Bashkësisë Islame të Kaçanikut ka pranuar një truall prej 10 ari vakëf për nevojat e këtij Këshilli. Kjo traditë e mirë e lënies së tokës vakëf për nevojat e Bashkësisë Islame është vazhduar edhe nga Imer Lama, i cili dhuroi vakëf 10 ari tokë në vlerën e 100.000 eurove. Shembujt e personave që po lënë tokën vakëf dita-ditës janë duke u shtuar, për çka Bashkësia Islame është tejet mirënjohëse dhe falënderuese. Lusim Allahun e Madhëruar që Imer Lamën dhe gjithë bamirësit t'i shpërblejë me mirësitë e Tij të pafundme!



Kaloi në amshim Remzi ef. Katrati (1953-2021)


Më 4 gusht, në moshën 68 vjeçare, ka ndërruar jetë Remzi ef. Hesat Kastrati. Ai lindi më 08.12.1953, në Karaçevë të Epërme. Shkollën fillore e kreu në vendlindje. Mësimet e para të fesë islame (një vit) i mori në Dobërçan te hfz. Jashar Poqinci, pastaj pesë vjet i vazhdoi mësimet në shkollën e mesme Ma'hedul Furkan në Damask, mandej në Daru-s-Selam, të cilat i ndërpreu për shkak të thirrjes për në shërbimin ushtarak. Kishte shërbyer disa vite si imam gjatë muajit Ramazan në Roganë. Pas shërbimit ushtarak inkadrohet në detyrën e imamit të xhamisë në vendlindje prej 01.06.1982. Këtë detyrë e kreu me përgjegjësi të madhe derisa doli në pension. Ai mbante mësimin e fesë islame në xhaminë e fshatit rregullisht. Në vitin 1995 ishte për herë të parë në



haxh. Në vitin 1986 është dënuar nga regjimi komunist i Beogradit me 200 DM, përkatësisht 15 ditë burgim për shkak të mbajtjes së mësimit fetar islam. Ishte edhe kryetar i Këshillit të Bashkësisë

Islame të Kosovës në Kamenicë.

Lusim Allahun xh.sh. ta shpërblejë me Xhenet mundin, fjalën, punën dhe veprën e hoxhës tonë të dashur që punoi mbi 40 vjet për fe e atdhe. Ai u varros në Karaçevë të Epërme.



Fakulteti i Studimeve Islame në Prishtinë botoi librin “Menaxhimi i diversitetit”, i autorit Abdulkerim Bekkar, përkthyer dhe përshtatur nga Vedat Shabani

Pak fjalë rreth përmbajtjes së librit:

Nuk ka dyshim se ekzistimi i mospajtimit apo diversitetit ndërmjet njerëzve në ide, ego, interesa dhe tradita përbënë një lloj sprove ose një test për njerëzit, me qëllim që të dalë në shesh mirësia e vepërimit dhe ligësia e keqbërësit. Së këndejmi themi se mospajtimi është nyja (komplekse) e sprovës në jetën tonë shoqërore, prandaj është me rëndësi që të ofrojmë idetë, botëkuptimet, direktivat dhe mekanizmat, të cilat do të na ndihmojnë për një pajtim dhe bashkëpunim që na

shpie drejt bashkëjetesës, me gjithë ekzistimin e polarizimeve dhe divergjencave ndërmjet nesh. Ky në fakt është edhe vetë qëllimi në të cilin është fokusuar ky libër.

Mospajtimi ndërmjet njerëzve në nivele të ndryshme është një ligj hyjnor i përcaktuar si i tillë deri në Ditën e Gjykimit. Për këtë arsye, përpjekjet për eliminimin e mospajtimeve në realitet janë angazhim që bie ndesh me ligjin hyjnor të vendosur nga Krijuesi Suprem. Në të njëjtën kohë, ky është një angazhim jo i pëlqyeshëm sepse një angazhim i tillë do të na shtyjë deri te problemi i konformitetit (unifikimit absolut) dhe pasojat negative që sjell kjo pikëpamje në jetën tonë individuale dhe shoqërore.

Prof. dr. Xhenana Efendiq - Semiz¹

Reforma dhe kolonizimi agrar serb në vitin 1918²

Rrallëherë në botë një popull ka arritur të zgjerojë territorin e tij shtetëror në 150 vjetët e fundit dhe të dëbojë popujt jo serbë, ashtu siç kanë arritur serbët. Është interesante të përmendet se suksesi i tyre nuk bazohet në fitoret luftarake, por në tryezat e negociatave, me mbështetjen e aleatëve të tyre të luftës.

Serbia, e cila përfshinte Pashallëkun e Beogradit, pas Luftërave Ballkanike të viteve 1912 dhe 1913, u zgjerua territorialisht në Kosovë, pjesë të Sanxhakut dhe të ashtuquajtur Maqedoninë Jugosllave. Gjatë luftës së parë ballkanike, trupat serbe kryen krimin e gjenocidit kundër shqiptarëve, boshnjakëve dhe maqedonasve në ato zona. Ata u vunë zjarrin vendbanimeve të tëra, duke vrarë popullsinë civile në mënyrën më primitive, me thika, sëpata dhe çekiqë të prerë prej druri. Një krim i tillë nuk është regjistruar në Evropë që nga migrimi i popujve. Përndjekja e popullatës jo serbe vazhdoi pas vendosjes së sundimit serb, duke çuar në emigracion

Gjatë luftës së parë ballkanike, trupat serbe kryen krimin e gjenocidit kundër shqiptarëve, boshnjakëve dhe maqedonasve në ato zona. Ata u vunë zjarrin vendbanimeve të tëra, duke vrarë popullsinë civile në mënyrën më primitive, me thika, sëpata dhe çekiqë të prerë prej druri.

masiv, i cili çoi në një ndryshim në strukturën demografike dhe zbatimin e kolonizimit serb në pronën e vjedhur e të përndjekurve.

Zgjerimi i parë i përmendur i territorit serb, mbi të cilin u krye kolonizimi, paraqet fillimin e realizimit të programit politik, i cili u përcaktua në “Naçertanje” e vitit 1844, nga Ilija Garashanin.

Ideologjia serbe e pushtimit të territoreve

Programi kombëtar serb në “Naçertanje” i vitit 1844 filloi nga rinovimi i perandorisë së Dushanit nga shek. XIV, me disa ndryshime që ishin pasojë e ngjarjeve politike në mesin e shekullit të kaluar. Në fakt, “Naçertanje” është bërë sinonim i hegjemonisë së madhe serbe në lidhje me popujt fqinjë.

Programi kombëtar bazohet në faktin se serbët nuk mund të jenë të kënaqur me fitimet nga Kryengritja e Parë dhe e Dytë Serbe dhe se ata do të vazhdojnë luftën për të marrë epërsinë në Ballkan. Në “Naçertanje” përmenden vendet në të cilat Serbia duhet të organizojë punë propagandistike dhe të inteligjencës, në mënyrë që të përgatitet për aneksimin e këtyre vendeve në shtetin e saj. Prandaj,



Reforma agrare u krye në një mënyrë gjenocidale kundër pronarëve myslimanë që jetonin në Maqedoni, Kosovë dhe Metohi, Sanxhak e Mal të Zi. Atyre iu konfiskuan gjithsej 231. 098 hektarë tokë, të cilat ishin ndarë në pronësi të 48,267 familjeve serbe.

ky program nuk u botua deri në vitin 1906. Programi kombëtar parashikon bashkimin e Bosnje dhe Hercegovinës, Bullgarisë, Malit të Zi, Shqipërisë së Veriut, Srijemit, Banatit dhe Baçkës. Për herë të parë në territorin kombëtar serb përshihen zonat e Bosnje-Hercegovinës dhe të Vojvodinës, të cilat nuk u përfshinë në perandorinë e Dushanit. Më vonë, “Naçertanje” do të bëhet ideologjia serbe jo vetëm e dinastive Obrenoviq dhe Karagjorgjeviq, por edhe e të gjitha programeve të Serbisë së Madhe me ato të çetnikëve gjenocidë Stevan Moleviq dhe Drazhe Mihailoviq, si dhe Memorandumin e ASSHA të vitit 1986.

Prandaj, politika hegemonike e “Serbisë së Madhe” nuk ka ndryshuar në 150 vitet e fundit, pasi qëllimi i saj kryesor është pushtimi i territoreve, depërtimi i Perëndimit përmes Drinës, përndjekja dhe shkatërrimi i popujve jo serbë për të krijuar një Serbi të Madhe dhe se “të gjithë serbët të jetojnë në një shtet”. Prandaj, struktura etnike po ndryshohet duke kolonizuar territoret e pushtuara. Në mënyrë që

të zbatojnë politikën e programit, ata bëjnë luftëra dhe kryejnë reforma agrare në zonat e pushtuara në mënyrë që të kolonizojnë strukturën etnike me kolonizimin e territoreve të çliruara. Në mënyrë që të zbatojnë politikën e programit, ata zhvilluan luftëra dhe kryen reforma agrare në zonat e pushtuara në mënyrë që ti kolonizojnë me popullsinë serbe. Në shqyrtimin tonë, do të shohim disa aspekte të reformës agrare dhe kolonizimit në vitin 1918.

Ndryshimet në pronësinë e tokës në vitin 1918

Për një pasqyrë më të mirë të gjendjes së pronësisë së tokës para reformës agrare të viteve 1918 dhe 1919 në Bosnjë dhe Hercegovinë, ku ajo u krye në mënyrën më drastike, ne do të përdorim regjistrimin e fundit të pronësisë së tokës dhe popullsisë sipas përkatësisë fetare, të kryer në vitin 1910 në Austro-Hungari.

Sipas këtij regjistrimi, myslimanët boshnjakë kishin 91.1 %, ortodoksët serbë 6.0 %, katolikët kroatë 2.6 % dhe “të tjerët” 0.3 % të pronësisë së tokës.

Pas themelimit të Mbretërisë Serbe, Kroate dhe Sllovene, populli boshnjak erdhi në një pozitë vartëse, sepse ata morën statusin e një pakice fetare, kështu që ata u privuan nga autonomia politike dhe kulturore. Reforma e parë agrare e viteve 1918 dhe 1919 kreu në mënyrë perfide gjenocidin ndaj boshnjakëve duke konfiskuar pronësi të tokës, me një kompensim simbolik, i cili nuk u pagua kurrë plotësisht. Brenda natës, shumë familje të pronarëve të pasur të tokave u bënë problem shoqëror, pa mjete jetese. Disa familje madje u privuan nga ndërtesat e ndërtuara dhe oborret e shtëpive. Filloi procesi i varfërimit masiv të popullit boshnjak dhe eksodi për në Turqi.

Toka e rrëmbyer e familjeve

boshnjake iu dha familjeve serbe nga Bosnja dhe Hercegovina, Krahina Kroate, Serbia dhe Mali i Zi. Ata u regjistruan në librat e tokës si pronarë që nuk paguanin asgjë për pronën e fituar. Ky ishte shpërblim për ata, sepse i përkisnin një kombi të privilegjuar. Gjëja kryesore ishte të kryhej një ndryshim i dhunshëm në strukturën demografike, me kolonizimin serb, në përputhje me programin nga “Naçertanje”. Gjegjësisht, me çdo kusht, ata përpiqen ta paraqesin Bosnjën dhe Hercegovinën si një vend serb, i cili duhet t’i bashkohet “Serbisë së Madhe” në një moment të favorshëm historik.

Raporti i gjenocidit ndaj boshnjakëve mund të ilustruhet nga treguesit e një ndryshimi në strukturën pronësore të pronësisë së tokës, e cila u mor nga reforma e parë agrare në vitin 1918 dhe 1919. Një total prej 1,175,305 hektarë tokë bujqësore dhe pyjore iu konfiskua boshnjakëve- myslimanëve. Nga shoqëritë aksionare, bankat dhe institucionet e tjera u konfiskua 110,922 hektarë tokë. Prandaj, u konfiskua gjithsej 1,286,227 hektarë tokë bujqësore dhe pyjore.

E gjithë toka e konfiskuar pas reformës së parë agrare në vitin 1918 dhe 1919 iu nda 249,518 familjeve serbe, duke përfshirë kolonët, kolonizuesit jashtë Bosnjës dhe Hercegovinës, dhe veçanërisht “Selanikasve”. Nëse kemi parasysh se secila familje kishte mesatarisht katër anëtarë, atëherë rrjedh se pothuajse një milionë banorë të kombësisë serbe u bënë pronarë dhe posedues të tokave dhe u bënë dukshëm më të pasur. Tehu i reformës agrare në vitin 1918 dhe 1919 u drejtua kryesisht kundër anëtarëve të besimit islam, në mënyrë që të ringjallet ideologjia e Savës së Shenjtë, sintagma së cilës është - një popull i një feje në një shtet. Prandaj, reforma agrare u krye në një mënyrë gjenocidale kundër pronarëve myslimanë që jetonin në Maqedoni, Kosovë dhe Metohi, Sanxhak e Mal të Zi. Atyre iu konfiskuan gjithsej 231. 098 hektarë tokë, të cilat ishin ndarë në pronësi të

48,267 familjeve serbe. Duke zbatuar metodologjinë e mësipërme, se secila familje kishte një mesatare prej katër anëtarësh, rrjedh se pothuajse 200 mijë anëtarë të familjeve serbe morën tokë, e cila ndryshoi ndjeshëm pronësinë dhe strukturën etnike të popullsisë. Procesi i emigrimit nga ajo zonë vazhdoi për në Turqi, paralelisht me kolonizimin e popullatës serbe, nga Mali i Zi, Bosnja dhe Hercegovina, Dalmacia, Lika, Banija dhe Korduni.

Në Mbretërinë e Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve, reforma agrare e viteve 1918 dhe 1919 u krye në një formë shumë më të butë në Kroaci dhe Slloveni, krahasuar me zonat e banuara nga myslimanët. Ajo u aplikua mbi pronarët e tokave dhe relativisht më pak tokë u konfiskua prej tyre, e që sipas treguesve statistikorë përfaqëson rreth 1/4 e tokës totale të konfiskuar në shtet. Kjo arrin në 406.981 hektarë tokë, e cila është e ndarë në 316.762 familje serbe, të cilat janë kryesisht të kolonizuara nga zonat pasive. Kështu, në atë zonë, pothuajse 1,200,000 anëtarë të familjes morën tokë në pronësi dhe posedim.

Reforma agrare e viteve 1918 dhe 1919 nuk u krye vetëm në Serbi, brenda kufijve të ish-Pashallëkut të Beogradit deri në vitin 1912, e që është provë e pozitës së privilegjuar të pronarëve serbë në Mbretërinë e Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve.

Analiza e mësipërme tregon se

reforma e parë agrare e viteve 1918 dhe 1919 konfiskoi 1,924,307 hektarë tokë nga ish-pronarët e tokave në Mbretërinë e Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve dhe e ndau atë në 614,603, kryesisht familje serbe. Duke zbatuar metodologjinë e aplikuar, se një familje ka një mesatare prej katër anëtarësh, rezulton se rreth 2,450,000 anëtarë të familjes morën pronësinë dhe posedimin e tokës pa paguar asgjë për të. Nga pikëpamja historike, reforma agrare kontribuoi në kolonizimin më të madh të popullit serb në zonat përtej Drinës në Mbretërinë e Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve. Ky ishte plan i konceptuar politikisht për zgjerimin territorial serb në kushtet e pasluftës. Viktimat më të mëdha ishin pasuesit e besimit islam, boshnjakët, shqiptarët, turqit dhe maqedonasit, sepse prej tokës totale të konfiskuar nën reformën agrare, 3/4 u konfiskua nga posedimi dhe pronësia e tyre.

Historikisht, Banja Luka nuk është qytet serb

Përveç reformës agrare të viteve 1918 dhe 1919, e cila u konfiskoi boshnjakëve toka në bazë të ligjit diskriminues, u përdorën edhe metoda terroriste, siç ishte i famshmi “Marshi i vdekjes” në vitin 1919

kundër boshnjakëve nga “Lijevce Polje” afër Banja Llukës. Pesëdhjetë mijë boshnjakë jetonin në zonat pjellore fushore të “Lijevce Polje”, prej të cilëve disa mijë pronarë tokash u vranë nga terroristët serbë me rastin e “Marshit të vdekjes”, dhe pjesa tjetër e popullsisë civile u dëbua nga vatrën shqulllore. Një kolonë e gjatë e viktimave marshoi në këmbë drejt kampeve të përqendrimit në Kosovë dhe Sanxhak, nga ku u transferuan për në Turqi dhe u vendosën në Anadoll. Në atë kohë, boshnjakët humbën tokën e tyre në komunën e Banja Llukës në mënyrën më brutale, me gjenocid. Familjet serbe, njerëzit pa tokë dhe selanikët u vendosën në shtëpitë e tyre dhe pushtuan tokën e konfiskuar të boshnjakëve. Erdhi deri te ndryshimi i papritur në strukturën demografike dhe të pronësisë në Mbretërinë e Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve. Si ilustrim, jepen indikatorë statistikorë se deri në vitin 1878, asnjë familje serbe nuk kishte pronësi të tokës në “Lijevce Polje” afër Banja Llukës.

Vetëm pas reformës agrare në vitet 1918 dhe 1919 bëhet intensifikimi i vendosjes dhe kolonizimit të popullsisë serbe në komunën e Banja Llukës. Sipas regjistrimit të parë të popullsisë në Bosnjë dhe Hercegovinë, gjatë kohës së Austro-Hungarisë, në vitin 1879, sipas përkatësisë fetare në qytetin e Banja



Llukës, myslimanët boshnjakë ishin shumica absolute e popullsisë prej 67,71 %; dhe nga viti 1895 deri në vitin 1991 përqindja e tyre ishte në rënie të vazhdueshme, kurse sot ajo ka rënë në 19.35 %. Numri i kroatëve katolikë në vitin 1879 ishte 10.52 %, i cili numër rritej gradualisht dhe në vitin 1931 arriti në 29.26 %. Në këtë nivel mbeti deri në vitin 1953, kur ishte 28.34 %. Më pas, pati një rënie të ndjeshme të numrit të kroatëve në popullsinë e përgjithshme, duke ulur numrin e tyre në 10.97 % në vitin 1991. Popullsia ortodokse përfshin serbë dhe malazezë, kështu që në kohën e regjistrimit të popullsisë në vitin 1879, kishte 19.80 %. Që nga ajo kohë, pjesa e tyre në numrin e përgjithshëm të popullsisë është rritur, dhe në vitin 1931 ky numër arriti në 30.53 %, dhe një rritje më intensive ndodhi në vitin 1948 kur arriti në 34.78 %, ashtu që në vitin 1991 arriti në 49.3 %.

Nga treguesit e mësipërm, mund të konkludohet se Banja Luka nuk është qyteti historik serb, siç pretendoi kriminel i luftës Radovan Karaxhiq, sepse popullata serbe filloi të vendoset në atë qytet në shekullin e XIX. Rritja e madhe e popullsisë serbe ndodhi pas reformës agrare të viteve 1918 dhe 1919, kur serbët morën tokën nga boshnjakët dhe pas tërmetit katastrofik në vitin 1969, kur shumica e tyre morën punë dhe apartamente të ndërtuara rishtas. Përveç kësaj, rritja e përqindjes së popullsisë serbe në qytetin e Banja Llukës u kontribua nga korpuset e JNA/UPJ-së prej 25 mijë ushtarësh dhe 700 oficerësh, nga togerë deri te gjeneralë, të cilët ishin përgjithësisht nga Serbia e Mali i Zi.

Historia përsëritet në një mënyrë. Gjatë agresionit serb, nga viti 1992 e deri më sot, agresori serb kryen gjenocid ndaj kroatëve dhe boshnjakëve në qytetin e Banja Llukës. Sipas statistikave nga regjistrimi i popullsisë i vitit 1991, kishte dymbëdhjetë vendbanime me një shumicë etnike të pastër kroate në afërsi të Banja Llukës, por

pothuajse të gjithë kroatët u dëbuan gjatë agresionit serb, kurse shtëpitë dhe toka e tyre u pushtua nga familjet serbe. Procesi i ndryshimit të dhunshëm të strukturës demografike dhe pronësisë së tokës është kryer në mënyrë sistematike që nga themelimi i Mbretërisë së Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve (MSKS), dhe zgjati për gati 80 vjet, por deri në vitin 1992 serbët nuk përbënin shumicën absolute të popullsisë në Banja Llukë.

Kompensim simbolik për tokën e rrëmbyer

Anëtar i Parlamentit - Asambleja Kombëtare e Mbretërisë së Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve dr. Stjepan Radiq, në fjalimet dhe shkrimet e tij, duke i rezistuar hegjemonisë, kritikoi, ndër të tjera, mënyrën në të cilën u krye reforma agrare në vitet 1918 dhe 1919, e cila ua rrëmbeu me forcë tokën myslimanëve (nga agallar dhe bejlerë). Kjo është arsyeja pse deputeti radikal Punisha Raçiç bëri krim duke qëlluar deputetët kroatë në vendet e tyre, duke vrarë Pavle Radiqin dhe Xhuro Basariçek dhe duke plagosur Stjepan Radiqin, Ivan Pernarin dhe Ivan Grangjin, kështu që dr. Stjepan Radiq vdiq nga plagët e rënda më 6 gusht 1928.

Më vonë u vendos që myslimanëve boshnjakë t'u kompensohet për pronën e konfiskuar, kështu që shteti pranoi se kishte pasur "parregullsi" në zbatimin e reformës agrare. Ligjet u miratuan për likuidimin financiar të kompensimit për tokën e konfiskuar pas vitit 1928, me të cilat filloi të rregullohet pagesa e tokës. Toka atëherë u vlerësua me 60 % më pak se vlera reale e tregut dhe pagesa u bë me para dhe obligacione për një periudhë 50 vjeçare me katër % interes në vit. Pagesa bëhej dy herë në vit duke filluar nga viti 1923 dhe zgjaste deri në vitin 1971. Myslimanëve boshnjakë iu pagua kompensimi për tokën e konfiskuar

në dy baza, për tokën e agallarëve (me marrëdhënie skllavërie) dhe tokën bejlerëve (me marrëdhënie qiraje). Deri në fillimin e Luftës së Dytë Botërore, ish-pronarët mblodhën 125 milionë dinarë në para të gatshme për tokën e agallarëve, ose 49 %, dhe 36 % në obligacion, që është 46.8 milionë dinarë e shprehur në terma monetarë. U mblodhën gjithsej 171 milion dinarë ose 67.4 %, dhe pjesa e mbetur e pa mbledhur 83.2 milionë dinarë ose 32.6 %. Ndryshe nga kompensimi i pronarit për tokën e agallarëve, kompensimi për tokën e rrëmbyer të bejlerëve ishte planifikuar ekskluzivisht në obligacione, me një periudhë pagese deri në 50 vjet. Nga gjithsej 650 milionë dinarë të planifikuar në 36 kështe gjashtëmujore, vetëm katër janë paguar në vlerë prej 139.5 milionë dinarë, ose më pak se 1/4, përkatësisht 21.5 %. Prandaj, 510.5 milionë dinarë, ose 78.5 %, nuk ishin paguar fare.

Nga treguesit e mësipërm, është e qartë se toka e konfiskuar kurrë nuk u ishte paguar plotësisht ish-pronarëve të tokave (agallarëve dhe bejlerëve), kështu që nuk mund të bëhej pronë e serbëve dhe as nuk mund t'u transferohej ligjërisht pasardhësve të tyre. Sipas ekspertëve ligjorë, e drejta për tokë të papaguar nuk vjetrohet kurrë dhe dokumentacioni i tokës mbi reformën agrare të zbatuar është ruajtur në arkivat e qytetit të Sarajevës dhe Vjenës.

Përktheu nga gjuha boshnjake:

Dr. Azmir Jusufi

1. Xhenana Efendiq-Semiz ishte një profesoreshë e njohur dhe e respektuar. Ajo ishte jo vetëm profesoreshë dhe shkencëtare e njohur, por edhe një humaniste e patriote e madhe boshnjake. Një nga gratë e para boshnjake që arriti kulmin në qarqet shkencore. Lindi më 2 qershor të vitit 1934 në Trebinje (Bosnje dhe Hercegovinë). Diplomoi në Fakultetin Filozofik në Universitetin e Zagrebit në vitin 1957, kurse doktoroi në vitin 1968. 2. Prof. dr. Dženana Efendić Semiz, „Srpska agrarna reforma i kolonizacija 1918. godine“, Međunarodni znanstveni skup (JUGOISTOČNA EUROPA 1918.-1995.), Botues: Hrvatska matica iseljenika i Hrvatski informativni centar, Boton: TARGA, Zagreb, 1996. Ose lexoni në mënyrë elektronike në ueb-faqe të internetit: <http://www.bic.hr/books/jugoistocna-europa/semiz.htm#srpska%20agrarna%20reforma>.